



VIJA E DREJTË DHE VIZAT E TJERA

Islami paraqet sistemin e vlerave më të përsosura. Allahu i madhëruar këtë përsosmëri e ka vulosur me ajetin kuranor: ***“Sot ua përsosa dispozitat e fesë suaj dhe ua plotësova dhuntinë Time ndaj jush. Jam i kënaqur që feja islame të jetë fé e juaja”***.

Dijetarët që e perceptuan kështu Islamin i kanë denoncuar vazhdimisht tendencat e ndryshme, që kanë synuar futjen e risive në fe si në aspektin teorik – besimin, ashtu edhe në atë praktik.

Ata e komentuan Kuranin me Sunet, kurse botëkuptimet i formuan në përputhje me ato të xhematit të parë, sahabëve. Sipas veprës ata edhe u emëruan ***“Ehlu Sunne uel xhema’a - ithtarët e Sunetit dhe Xhematit.”*** Këta në fakt ishin vazhdimësia e muslimanëve të parë, përfaqësuesit e mësimave të Muhamedit, sal-lallahu alejhi ue selem. Ndërkohë filluan të paraqiten sekte të ndryshme, majtas e djathtas që ranë në kundërshtim me xhematin amë, ***Ehli Sunetin***, mu ashtu siç pat paralajmëruar i Dërguari në mënyrë figurative, duke vizatuar një vijë të drejtë e të gjatë, kurse në të dy anët e saj disa viza. Vija e drejtë dhe e gjatë simbolizonte të vërtetën, që duhej ta ndiqnin besimtarët, kurse vizat simbolizojnë devijimet sektare...

Havarixhët ishin grupacioni i parë që doli nga binarët e së vërtetës. Megjithëse e keqja i kishte rrënjët më të thella, qysh kur i quajturi **Dhul Huvejsire** e akuzoi të Dërguarin me padrejtësi, ata shfaqen në kohën kur kalifatin e godet një tronditje e madhe – vrasja e Osmanit, radijallahu anhu. Sipas tyre rënia në mëkate të mëdha nënkuptonte dalje nga feja.

Më vonë paraqiten ***Shiat***, të cilët shpikën besimin në pagabueshmërinë e **imamit** dhe kështu dalëngadalë bidatet morën dhenë, sidomos kur filluan ta përqafojnë Islamin popujt joarabë. Sa më shumë që largoheshim nga koha e të Dërguarit, aq më tepër shfaqeshin devijime të reja.

Lëvizja e ***Sufijve*** pati një ndikim të madh në përhapjen e ideve joislame. Ata shpikën tarikatet, vallëzimin, panteizmin dhe sajuan një përzierje të çuditshme të hebraizmit, krishterimit, filozofisë persiane, filozofisë indiane etj., duke ua veshur të gjithëve petkun islam.

Ehli Suneti qëndroi vazhdimisht përballë devijimeve me llojllojshmërinë e tyre. Ata asnjëherë nuk u shuan, të vërtetën e ngritën lart për ta parë të gjithë njerëzit. I Dërguari i Allahut ka thënë: ***“Në umetin tim do të jetë vazhdimisht një grup që do ta ngrejë të vërtetën lart...”***.

Duke pasur parasysh rëndësinë e këtyre temave vendosëm që në këtë numër të revistës të hedhim një shkëndijë të ***Ehli Sunetit*** për të zbardhur sadopak realitetin e disa grupacioneve të devijuara. Jemi të vetëdijshëm se kjo tematikë është e ndërlikuar dhe se nuk mund të plotësohet me disa shkrime, mirëpo është e rëndësishme fjala, se ajo që nuk arrihet e tëra nuk duhet të braktiset e tëra. Së paku lexuesit do të mundën të mësojnë për sufijtë, rafidijtë, nurxhijtë, për shkaqet e paraqitjes së havarixhëve dhe murxhivë e të tjera.

Këtë herë, rubrikat libri dhe bota islame, do t'i lëmë në dobi të temës në fjalë duke e lutur të Gjithëmëshirshmin që të na bëjë të qartë të vërtetën e ta pasojmë atë dhe të kotën të na bëjë të qartë dhe të largohemi prej saj.

Në emër të redaksisë: Agim BEKIRI

AKTUALE

A po rrëzohet idhulli vilajetul fekih
në Iran?! **3-8**

KËNDI IM

Vdekja, argument për të gjallët **8-9**
Faktorët e shfaqjes së irxhasë dhe tekfirit **10-14**
Debati i Ibën Tejmijes me Shiat Rafidij **15-18**

AKIDE

Ju tregoj diçka për sufizmin
(pjesa e parë) **19-24**
Drejtësia ndaj kundërshtarit **24-30**

FIKH

Dasmat me haramë **31-35**

AVANCIMI PERSONAL

A je fleksibël aq sa duhet? **36-40**

FAMILJA

Shokët e anijes
(bisedë e një prindi me fëmijët e tij) **41-42**

TEFSIR

Konflikti dhe lidhja duale me njeriun dhe zotin
(Vështrim rreth konceptit islam të luftës dhe mbrojtjes, dy ajetet e sures Enfal si model) **43-46**

HADITH

Umeti im do të përçahet **47-50**

FETVA DHE KONSULTIME

Dallimi mes Ehli Sunetit dhe
medhhebeve tjera **51-54**

HISTORI

Nga Seid Nursi te Fetullah Gyleni **55-60**

REDAKSIA

Omer BERISHA – kryeredaktor
Anëtarë të redaksisë:

Ahmed KALAJA, Bekir HALIMI, Agim BEKIRI, Driton LEKAJ, Ali SHABANI, Ismail BARDHOSHI,
Talha KURTISHI, Bledar HAXHIU, Sedat SHABANI, Agron TERZIQI, Lulzim SUSURI, Genc PLUMBI, Zeki ÇERKEZI,

Enver AZIZI, Bashkim BAJRAMI, Bilal TEQJA.
Bashkëpunëtorë: Ekrem AVDIU dhe ENIS RAMA
Roald HYSA – redaktor gjuhësor
Halil BERISHA – redaktor teknik
Dorlir KRAJA (ENSARTDESIGN Studio) - ballina
Sedat RAMADANI - shpërndarje dhe marketing
Boton: AlbIslam

Adresa: rr: 110 nr: 5 | Çarshia e vjetër | Shkup 1000
email: albislam@gmail.com
sms: +389 75 436 718 | fax&tel: +389 2 3230 827
Revista është e regjistruar pranë Agjencisë për
Informata të Maqedonisë nr. 02-124/2
ISSN: 1409-6250
Tirazhi: 2000

ABONIMI NJË VJEÇAR
Për Maqedoni: 600 den, Jashtë vendit: 20 euro
(në çmim janë të përfshira edhe harxhimet postare)
e-mail: albislam.abonues@gmail.com
ALBISLAM DOOEL
Xhirollogaria: 300000002770453
Komercijalna Banka A. D. – Skopje
Numri tatimor: 4030008038784

Abonimet me euro mund t'i bëni online nëpërmjet shërbimit
PAYPAL. Të dhënat mund t'i gjeni në www.revista-albislam.com



A PO RRËZOHET IDHULLI VILAJETUL FEKIH NË IRAN?!

Ç'po ndodhë në Iran? Pse shoqëria iraniane po vlon kundër revolucionit të Homeinit? A thua në murin e Vilajetul Fekih ka ndodhur një plasaritje? A mund të themi se dashuria ndaj Homeinit mori tatëpjetën? Mos vallë shoqëria ka marrë një ngjyrë të re nga ajo që mori menjëherë pas revolucionit të Homeinit? Mos ndoshta themelet mbi të cilat u ndërtua revolucioni i Homeinit po ato që do të shkaktojnë prishjen e tij? A thua zgjedhjet e fundit do të jenë një xixë për grusht shteti ndaj Vilajetul Fekih, gjë e cila e shtyu Musaviun, që falsifikimet dhe gënjeshttrat e sistemit të Vilajetul Fekih t'i vlerësojë si veprime që "do të dëmtojnë themelet e revolucionit".

Këto pyetje do të mundohemi t'i prekim gjatë rreshtave në vazhdim.

HEJTHEM ZAFAN

Ç'po ndodhë në Iran? Pse shoqëria iraniane po vlon kundër revolucionit të Homeinit? A thua në murin e Vilajetul Fekih ka ndodhur një plasaritje? A mund të themi se dashuria ndaj Homeinit mori tatëpjetën? Mos vallë shoqëria ka marrë një

Vilajetul Fekih (qeverisja e dijetarit të mirëfilltë) është sistem qeverisës të shiat bashkëkohorë i cili nënkupton dhënien e qeverisjes së njerëzve nga Allahu për dijetarin e mirëfilltë derisa të vijë imami i pritur që momentalisht është i fshehur.

Besojnë se ky dijetar është i pagabueshëm sikur pejgamberët, prandaj duhet respektuar si i tillë. I pari që mori këtë qeverisje "nga Allahu" ishte Homeini. Ky është shkaku pse themi se 'vilajetul fekih' është idhull.

ngjyrë të re nga ajo që mori menjëherë pas revolucionit të Homeinit? Mos ndoshta themelet mbi të cilat u ndërtua revolucioni i Homeinit po ato që do të shkaktojnë prishjen e tij? A thua zgjedhjet e fundit do të jenë një xixë për grusht shteti ndaj Vilajetul Fekih, gjë e cila e shtyu Musaviun, që falsifikimet dhe gënjeshttrat e sistemit të Vilajetul Fekih t'i vlerësojë si veprime që “do të dëmtojnë themelet e revolucionit”.

Këto pyetje do të mundohemi t'i prekim gjatë rreshtave në vazhdim.

Së pari: Zgjedhjet e fundit në Iran ishin plot falsifikime, presione dhe anomali. Këto zgjedhje ishin krejt ndryshe nga zgjedhjet nëpër të cilat kaloi Irani që nga revolucioni i Homeinit (1979). Pati presion ndaj medieve duke mbyllur zyrat e kanaleve informative arabe dhe duke i penguar ato përëndimore. U mbyllën shumë faqe elektronike interneti, si dhe shumë gazeta të opozitës, sidomos ato të krahut reformator iranian. Në këtë mënyrë media e vetme aktive mbeti media zyrtare, që i përket grupit konservator dhe drejtohet nga lideri suprem i revolucionit iranian.

Krahas presionit dhe errësirës mediatike pati edhe veprime të ndryshme në ditën e zgjedhjeve, që mëtonin të ndikojnë në rezultatin e zgjedhjeve për të mirën e krahut konservator, e që kjo u pa qartë me lojën e numrit të letërnjoftimeve.

Pas kësaj doli ministri i punëve të brendshme, pjesëtar i grupit konservator dhe shpalli këto rezultate: 24 527 516 vota për **Ahmedinexhad** (62.63%), 13 216 411 vota për konkurrentin më serioz **Mir Husejn Musavi** (33.75%), 678 240 vota për **Muhsin Ridain**, udhëheqësin e ish-Gardës Revolucionare (1.73%), si dhe 333 635 vota për **Muhamed Kerubi**, kryetarin e parlamentit të mëparshëm (0.85%).

Pas publikimit të rezultateve Irani u

trazua dhe kjo u pa sepse:

1. Krahu reformator e refuzoi këtë rezultat dhe shpalli rezultate të tjera në të cilat Musavi fitonte me 3 milionë vota më shumë.

2. Biseda rreth falsifikimit dhe gënjeshtrave në rezultatet e zgjedhjeve të cilat ishin nën mbikëqyrjen e liderit suprem të revolucionit, **Ali Hamenei**, i cili sipas shiave duhet të jetë i pagabueshëm, sepse ai njëkohësisht përfaqëson “imamin e fshehur” për të cilin besojnë se duke qenë fëmijë paska hyrë në një shpellë dhe nuk ka dalë akoma.

3. Dalja në demonstrata e qindra e mijëra njerëzve nëpër rrugë për të protestuar rreth falsifikimit dhe gënjeshtrave dhe për të kërkuar përsëritjen e zgjedhjeve, formë kjo e cila nuk ka ndodhur që nga revolucioni i Homeinit (1979).

4. Nga koha e revolucionit është hera e parë që hidhen parulla të njëjta, ashtu siç i ngrinte revolucioni kundër Shahut atëbotë, si “poshtë diktatori”. Pra, Ahmedinexhadi si përfaqësues i krahut konservator dhe i ndihmuar nga lideri suprem u shndërrua në një diktator, i cili duhet të bjerë poshtë.

5. Një presion i paparë nga ana e konservatorëve kundër demonstruesve që rezultoi me arrestime, përleshje, bomba, plumba, të plagosur po edhe të vrarë nga ana e demonstruesve.

6. Arrestime të shumta të personaliteteve dhe udhëheqësve nga krahu reformator, si dhe kufizime për vendqëndrimin e shumë të tjerëve.

7. Ngjarjet e nxehta janë akoma të ndezura në rrugët e Iranit, ku po qortohet gënjeshtra, tradhtia, mashtrimi, falsifikimi dhe padrejtësia e bartësve dhe e mbrojtësve të sistemit shiit Vilajetul Fekih.

A thua Vilajetul Fekih ua solli shpirtin në fytyrë iranianeve? A thua ka ndonjë ndryshim real në ngjyrimin e shoqërisë iraniane, që do

“Mbrotjtësit e të drejtave të gruas në Iran kërkojnë anulimin e këtij sistemi martesë, sepse e konsiderojnë derë të kurvërisë...”

të sjellë grusht shtetin kundër Vilajetul Fekih? Nëse ka, cilat janë shenjat e atij ndryshimi?

Së dyti: Ndryshimi në ngjyrimin e shoqërisë iraniane dhe zbulimi i realitetit të Vilajetul Fekih:

Ai që analizon ngjyrimin e shoqërisë iraniane, sidomos të asaj shiite nga thjerrëza e zgjedhjeve të fundit do të shohë aty dallimin e madh mes përkrahësve të revolucionit të Homeinit dhe përkrahësve të krahut reformator. Nga ky dallim vërehet edhe largësia dhe gërditja e shoqërisë iraniane nga shtypja dhe mendjemadhësia e Vilajetul Fekih, të cilën e shpiku Homeini, me qëllim që të fitojë besnikërinë dhe të bëhet personi udhëheqës, nga i cili iranienët do të shpresonin për një realitet të ri nga ai i Shahut. Pas vdekjes së Homeinit sistemi i Vilajetul Fekih, i cili i kishte në dorë frerët e pushtetit u mundua ta vazhdojë me dorë të hekurt besnikërinë ndaj Homeinit, sikur ai të ishte i pavdekshëm, duke supozuar se kjo besnikëri do t'i mundësojë liderit suprem vazhdimin e revolucionit iranien, si dhe ruajtjen e pushtetit për një kohë shumë të gjatë, duke realizuar kështu ëndrrën e kthimit të perandorisë persiane. Mirëpo kjo, nuk paska qenë e shkruar, ndaj ndodhi fillimi i grusht shtetit – i cili ende nuk ka arritur kulmin – nga këto zgjedhje iraniane të falsifikuara, si dhe nga ngjarje të tjera të mëhershme dhe të tanishmet. Dy elemente kryesore po zbulojnë dallimin në

ndryshimet e shoqërisë iraniane midis përkrahësve të Homeinit dhe kundërshtarëve të tij pas tridhjetë vjetëve nga revolucioni i vitit 1979. Ato janë: rinia dhe gruaja.

1. Rinia midis Homeinit në 1979 dhe Mosavit 2009

Në vitin 1979 shtylla e revolucionit iranien, që udhëhiqej nga Homeini ishte rinia. Ata e bënë revolucionin, i cili vazhdon akoma. Nëse shikon personalitetet udhëheqëse në Iran do të vëresh se të gjithë janë rinia e Homeinit. Mirëpo njëkohësisht po vërejmë Musavin – të riun e mëparshëm që vjen nga rreshtat e Homeinit, ndërsa kundërshtuesin e tanishëm të gënjeshtreve, falsifikimeve dhe mashtrimeve që po bëjnë bartësit e revolucionit, duke përfshirë këtu edhe liderin suprem – i cili filloi rrugëtimin zgjedhor kundër Nexhadit, por me ndihmën e rinisë, të cilët po hedhin parulla si: “erdha për të mbrojtur nderin njerëzor” apo “do të punoj për të shtuar lirinë njerëzore”. Këto janë edhe pikat kyçe nga të cilat anon gjenerata e sotme e rinisë, sidomos nën hijen e integritetit me të gjitha shoqëritë. Ndonëse janë një pjesë e rinisë, por kjo ka rrezikun e vet, sepse në këto kohë të ndryshimeve të shpejta në shoqëri, me faktin e rënies së karizmit të Vilajetul Fekih tek miliona reformistë, si dhe me presionin që po bëhet ndaj demonstruesve do të zgjerohet akoma rrethi i rinisë, që do të synojë ndryshimet.

Brenda dhjetë vjetëve kjo rini do të jetë në pozita dhe poste, ku do t'u mundësohet ndryshimi i shumë gjërave në shoqërinë iraniane në përgjithësi dhe pastaj do të zgjerohet plasaritja midis shoqërisë iraniane dhe sistemit Vilajetul Fekih, e cila do të bëhet edhe më e madhe.

2. Gruaja dhe grusht shteti ndaj Vilajetul Fekih

Nga anomali të shumta në zgjedhjet e fundit në Iran është paraqitja e dosjes së

gruas iraniane shumë e fuqishme në këtë situatë. Këtu po përmendim katër pika kryesore lidhur me këtë dosje të sikletshme:

a. që nga revolucioni (1979) shoqëria iraniane nuk kishte parë që bashkëshortja e një kandidati të dalë në fushatë, duke mbartur me vete një numër të madh kërkesash të grave dhe kështu të mbloodhi rreth saj dhjetëra-mijëra gra iraniane, që nga thellësia e zemrës duan ndryshimin. Vlen të përmendet se kërkesat e tyre janë të përafërta me kërkesat e lëvizjeve botërore të grave, të cilat kanë si pikënisje liberalizmin. Këtë thyerje akulli e bëri në Iran **Zehra Rahnafard**, gruaja e Musavit, e cila ka doktoruar për artie. Ajo shprehet: “Unë jam nga thirrëset e lirisë dhe të respektimit të mendimeve të të gjithëve... ndihma ime ndaj Musavit mbështetet në besimin e tij për të drejtat e gruas dhe pozitën e saj në shoqëri, sepse nuk ka asnjë arsye që gruaja iraniane të mos marri pjesë në organizmat e ndryshëm për vendimmarrje dhe ligjëvënie në Iran”.

b. Elementi i gruas gjendet te militantët e fushatës së Musavit, ku brohorasin shumë rreth ndryshimit të ligjeve mbi gruan në Iran, ligje të cilat janë hartuar gjatë revolucionit iranian.

c. Mbesa e Homeinit, e cila kishte një rol të dalluar në zgjedhjet e fundit. Ajo përkrahte Musavin dhe ishte mbartëse e dosjes së gruas iraniane. Ajo është bashkëshortja e **Dr. Muhamed Rida Hatemit**, vëlla i kryetarit të mëhershëm të republikës Muhamed Hatemit. Gjithashtu ajo është nga femrat më të përmendura të familjes Homeini. Ajo e refuzon mbulesën e detyruar dhe kërkon të drejta të barabarta për burrin dhe gruan. Kjo është një anomali në ndryshimin e ideve të shfaqura të Homeinit, po edhe në shtëpinë e tij. Pas shpalljes së rezultateve ajo u arrestua dhe të njëjtën ditë u lirua. Kjo zonjë kërcënohet ashpër dhe

“Qëllimet e revolucionit ishin thjesht persiane (nacionaliste) dhe ai vepron për të ringjallur kulturën persiane. Si i tillë, ai nuk është aspak islamik...”

shprehet së në rrethin e mbartësve të Vilajetul Fekih ka shumë degjenerime, ndaj kërcënon se do të zbulojë dosjet e zeza të **dijetarëve** dhe **ajatollahëve** konservatorë të Iranit.

d. nga pikat më të theksuara për grushtshteti ndaj revolucionit të Homeinit për temën e gruas është “nikahu i përkohshëm”. Mbrojtësit e të drejtave të gruas në Iran kërkojnë anulimin e këtij sistemi martesë, sepse e konsiderojnë derë të kurvërisë dhe të fëmijëve të braktisur, sidomos pasi u bë e qartë se dijetarët e revolucionit të Homeinit nuk i martojnë bijat e tyre në këtë formë. Prandaj shoqëria iraniane e refuzon këtë lloj bashkimi mes gruas dhe burrit, ku të drejtat e gruas humbasin, shfrytëzohet seksualisht, përzihet prejardhja e fëmijëve, shtohet aborti dhe braktisja e fëmijëve nëpër rrugë.

Së treti: Shkaqet që sollën ndryshimin e ngjyrave të shoqërisë iraniane brenda tridhjetë viteve

Ka disa fakte dhe shkaqe, të cilat brenda tridhjetë viteve të kaluara kanë ndikuar në ndryshimin e përbërjes së shoqërisë iraniane, paraqitjes së një numri të madh të kundërshtarëve të qeverisjes së Vilajetul Fekih dhe kërkuesve për ndryshim dhe integrim në botë. Nga këto shkaqe janë:

1. Vetë Homeini kur desh i ta shpallë Iranin shtet islam, nuk mori si shembull Muhamedin, lavdërimi dhe paqja qofshin

mbi të, por ai e bëri veten shembull dhe imam të pagabueshëm, i cili duhet të respektohet dhe rruga e tij të ndiqet. Këtë pagabueshmëri ia trashëgoi atyre që vinin pas tij, gjegjësisht liderëve supremë të revolucionit, mirëpo veprimet e ndyra të tyre ia nxorën bojën pagabueshmërisë së pretenduar, sepse kjo cilësi në realitet i takon vetëm Pejgamberit, lavdërimi dhe paqja qofshin mbi të.

2. Periudha kohore, që nga ndodhitë e shumta gjatë revolucionit vërtetoi se qëllimet e revolucionit ishin thjesht persiane (nacionaliste) dhe ai vepron për të ringjallur kulturën persiane. Si i tillë, ai nuk është aspak islamik, që mëton bashkimin e Umetit musliman siç pretendon prej nga zërat e ndryshëm të revolucionit.

3. Degjenerimi i simbolit ideal dhe i pagabueshmërisë nga dijetarët e revolucionit, e sidomos të liderit suprem Ali Hamenei, i cili mori pjesë në falsifikimin e zgjedhjeve të fundit për t'i ndihmuar Nexhadit.

4. Mashtrimi i qartë midis ngritjes së flamurit të demokracisë/lirive të përgjithshme dhe zbulimit të diktaturës së vërtetë të Vilajetul Fekih, gjë e cila bëri që demonstruesit ndaj këtyre gënjeshtreve, mashtrimeve dhe falsifikimeve të ngrenë parullat, ku shkruhet: “diktaturë, diktaturë, poshtë diktatura”.

5. Degjenerimi financiar brenda rrethit të dijetarëve dhe ajatollahëve, për të cilat flasin shumë raporte dhe këtë e pohon jetesa luksoze dhe në bollëk, që bëjnë ajatollahët. Kjo bëri që shëmbëlltyra e mirë, si edhe pagabueshmëria e pretenduar të thyhet në sytë e rinisë, e cila kërkon shëmbëlltyrën. Ishte një tëharrje e pozitës së sistemit Vilajetul Fekih te rinia dhe kështu numri i

“...Në këtë situatë Irani duhet të pyesë veten: Si të shpallim armiqësinë kundër çifutëve dhe të krishterëve, ndërsa u zgjasim dorën e ndihmës në fshehtësi?!...”

demonstruesve arriti në miliona të rinj për të shprehur zemërimin e tyre.

6. Brenda këtij degjenerimi financiar të sistemit Vilajetul Fekih, populli iranian interesohet për fatin e “zekatit, një e pesta”, të cilin shiat e paguajnë, ndërsa ajo pasuri shkon te dijetarët dhe ajatollahët me shallet e zinj, me të vetmin arsyetim se i përkasin familjes së Pejgamberit (Alu Bejt), edhe pse shumica e tyre janë persianë. Në kohët e fundit sa vijnë e po shtohen shkrimet që flasin për keqpërdorimet dhe luksin e arritur nga “një e pesta”, e mos të flasim për vërejtjet e disa shiave për faktin se vetë shiat nuk kanë asnjë dobi nga të ardhurat e këtij zeqati, të cilin e marrin ajatollahët persianë.

7. Raportet e shërbimeve inteligjente zbulojnë, madje një pjesë të tyre i gjejmë si dokumente zyrtare në librin **“Aleanca mashtruese – marrëdhëniet e fshehta mes Amerikës, Izraelit dhe Iranit”**¹, se ideja për “shejtani më i madh”² është veçse për konsumin e entuziazmit, ndërsa realiteti na tregon për bashkëpunimin e thellë të shiave revolucionarë nga një anë dhe çifutëve e të krishterëve nga ana tjetër. Profili i këtij bashkëpunimi u qartësua edhe më tepër pas okupimit amerikan në Irak dhe kontributit iranian për lehtësimin e okupimit dhe

¹ Autor i këtij libri është Trita Parsi, profesor i marrëdhënieve ndërkombëtare në universitetin “Xhon Hopkins”.

² Shprehje me të cilën Irani aludon Amerikën.

vrasjen e muslimanëve sunij. Në këtë situatë Irani duhet të pyesë veten: Si të shpallim armiqësinë kundër çifutëve dhe të krishterëve, ndërsa u zgjasim dorën e ndihmës në fshehtësi?!

8. Tani po jetojmë në shoqërinë e informacionit dhe të transparencës me gjithkënd dhe kësioj Irani si çdo shtet tjetër do t'i kapërdijë ndryshimet. Më pas do të shohim sesi profili i shoqërisë ndryshuese në Iran dhe njëkohësisht rebelimi kundër Vilajetul Fekih do të kontribuojë në përbërjen e tij shekullare, globalizuese dhe liberale, si dhe në shoqërinë e informacionit.

Zgjedhjet e fundit në Iran nuk do të ndalojnë te zgjedhja e kryetarit të shtetit, pas të cilit mund të vijë një kryetar, që do të rrënojë çdo vendim që mori pararendësi i tij, por anomalia është në gjërat që rezultuan nga këto zgjedhje, gjegjësisht në ndryshimet në ngjyrat e shoqërisë iraniane, të cilat shprehën plasaritjen në sistemin e Vilajetul Fekih dhe fillimin e humbjes së besnikërisë ndaj Homeinit. Në kohën e degjenerimit financiar, shfrytëzimit seksual të gruas, falsifikimit, gënjeshtërs, rënies së pagabueshmërisë dhe simbolit ideal të liderit suprem të revolucionit, siç zbulon krahu reformist; dhe në kohën e hapjes së rinisë për ide të tjera dhe studimin e rrënjëve dhe synimeve të revolucionit persian të Homeinit, rrethi i kundërshtuesve të Vilajetul Fekih, grushti i shtetit dhe tëharrja nga brenda do të zgjerohet dhe do të bëhet me duart e rinisë, e cila gjithashtu kontribuoi në ndërtimin e Vilajetul Fekih para tridhjetë viteve. ■

Nga arabishtja: Omer BERISHA

VDEKJA, ARGUMENT PËR TË GJALLËT

Vallë përcjellja e të vdekurit duhet të kthehet në shprehje, që vetëm sa duhet të prezantohemi sa për sy e faqe, ku do të takohemi me njerëzit që nuk i kemi parë për një kohë të gjatë, apo duhet të prezantohemi për të përkujtuar veten, se vdekja është argument i qartë

NGA HAJRUSH MANI

Vdekja mund t'ju vijë në çdo çast. Kushedi ndoshta ky është momenti. Ose mund të jetë shumë më afër se sa e keni menduar ndonjëherë. Këto rreshta mund të jenë mundësia e fundit, përkujtesa e fundit, paralajmërimi i fundit para se t'ju vijë vdekja. Ndërsa po lexoni këto rreshta, kurrë s'mund ta dini nëse do të jeni gjallë në orën që pason. Qoftë edhe nëse vërtetohet se është ashtu asgjë s'mund t'ju garantojë se do të jetoni edhe një orë tjetër. A është e sigurt se do të jeni gjallë pas edhe një çasti të vetëm e lëre më një orë.

“Ai është që krijoi vdekjen dhe jetën, për t'ju provuar se cili prej jush është më vepërmirë.”

A e mendon ndokush nga të gjallët se mund ta mohojë vdekjen, assesi jo, vdekja është argument i qartë. Pa dyshim që vdekja do ta takojë çdonjërin nga njerëzit, padyshim që vdekja i prek edhe të gjallët, por më e vështira është se si njerëzit logikojnë për atë. Të gjithë e dimë se vdekja është hak, por duke u zhytur në larminë e kësaj bote, shpesh edhe mendja nuk funksionon si duhet. Padyshim që fjala e Allahut subhanehu ue teala ngadhënjën

gjithmonë dhe të gjithë neve e shohim se e vërteta nga dita në ditë po ngadhënjën gjithnjë e më shumë. Por a marrim mësimin e duhur; ne flasim dhe nuk heshtim dhe themi atë që nuk duhet thënë. Kur njerëzit mblidhen për të përcjellë të vdekurin, atëherë ndoshta fillojnë të mendojnë pak, se vallë edhe sa ditë do të kenë ngelur nga kënaqësia e kësaj bote. Por kjo nuk ndodh as edhe me zemër, pasi në përcjelljen e fundit ata nuk i ulin kokat dhe nuk i ndalin bisedat e kota. Në fytyrat e tyre përvijohet buzëqeshja, edhe pse do të duhej të ishin të lagura nga lotët e mallëngjimit.

Vallë përcjellja e të vdekurit duhet të kthehet në shprehje, që vetëm sa duhet të prezantohemi sa për sy e faqe, ku do të takohemi me njerëzit që nuk i kemi parë për një kohë të gjatë, apo duhet të prezantohemi për të përkujtuar veten, se vdekja është argument i qartë, duke menduar kështu edhe fundin e kësaj jete, kur edhe ne do të hyjmë në varrin e errët. Vdekja na përkujton se sa të paaftë jemi. Duke parë të vdekurin ne mësojmë se nuk kemi asgjë në duart tona, i vdekuri nuk lëviz më, i shtangen krahët, këmbët, nuk mund të ecë më, sikurse ecim ne, derisa e kemi dërguar atë në varr.

Vallë, pse nuk e kapni për krahësh, por e keni shtrirë dhe ai po ju paraprin juve! A nuk mendoni tani, a thua ende nuk e keni kuptuar argumentin e qartë, argument që Krijuesi i qiejve dhe i tokës e ç'ka në mes tyre, që e përcaktoi dhe inspiroi, duke e quajtur vdekjen argument të qartë, që ju ta shihni! Që ju ta përjetoni! Që ju të mos i paraprin këtij argumenti!

Nga çasti në çast neve jemi edhe më injorantë ndaj vdekjes, në oborrin e xhamisë mblidhen njerëz që janë nisur për të përcjellë të vdekurin në varr, e as që kanë marrë abdes e as që i falin namazin e xhenazes të vdekurit.

Vallë çfarë njerëz mund të jenë këta, a thua nuk e shohin se atyre po ju paraprin një

“...Në oborrin e xhamisë mblidhen njerëz që janë nisur për të përcjellë të vdekurin në varr, e as që kanë marrë abdes ...”

i vdekur, të cilin po e bartin ndër duar. Vallë pse o njeri nuk logjikon. Pse o njeri nuk arrin të nxjerrësh një mesazh nga ai që po bart mbi supet e tua. Pse nuk largohesh së paku për një çast nga kjo botë, para se të vijë një ditë kur do të shtangesh! Pse nuk i përjeton argumentet, e të marrësh mësim prej tyre, para se të bëhesh argument për të tjerët! Pse nuk largohesh prej atij që urdhëron të keqen e të ndalon të mirën. Armikun e merrni për mik, ndërsa mikun e bëni armik! Mjerë për njerëzit që nuk logjikojnë!

I vdekuri, sado që do të dëshironte të ngrihej e të na jepte porosinë e vet, për ne përsëri do të ishte e vështirë që ta merrnim mesazhin e tij. Por ai nuk do të kthehet, se po të ndodhte ashtu me të dy duart do ta kapte Kuranin, e të mos e lëshonte më kurrë! Çdo lëvizje që do të bënte ai do ta madhëronte Allahun, me ballë në sexhde do të binte që kurrë të mos çohet. Do të dëshironte që gjithçka që ka, ta jepte në rrugën e Allahut. Sigurisht që do ta flijonte edhe dynjanë për ta fituar ahiretin; vetëm e vetëm falënderues, mirënjohës e besimtar i devotshëm do të ishte.

Mirëpo kur argumentet e Allahut subhanehu ue teala do të shfaqen për sytë e njerëzve haptazi, nuk ka më kthim mbropa! Ose të shpërblyer; ose të ndëshkuar!

E për argumentet e qarta parashenja nuk ka! Janë të befasishme, e një prej tyre është edhe vdekja. Prandaj t'i lutemi Allahut që të na udhëzojë, që argumentet t'i shohim para se të bëhemi argument për të tjerët. ■

FAKTORËT E SHFAQJES SË IRXHASË DHE TEK FIRIT

Çdo ideologji që paraqitet në shoqëri, sado të vjetrohet dhe të dobësohet përsëri mbetet. Këtë nuk mundemi ta mohojmë. Ai që lexon historinë islame dhe fraksionet e saj do të shohë se rrymat ideologjike, ndonjëherë forcohen dhe herë të tjera dobësohen. Mirëpo ato nuk zhduken, ato mbesin të dobësuar derisa të gjejnë dikë që do t'i trazojë

DR. HANI IBËN ABDULLAH EL XHUBEJR

S'ka dyshim se njohja e origjinës së gjërave dhe principeve të tyre; po ashtu edhe gjurmimi (studimi) i faktorëve që shpjen në zhvillimin dhe paraqitjen e tyre; si dhe njohja e thelbit se çfarë del nga ato është nga shkencat më të dobishme, meqë njeriu kur nuk njeh thelbin e gjërave, në zemrën e tij mbetet një brejtje. Studimi i këtyre faktorëve është thelbi i shërimit të tyre, prandaj gjurmimi i shkakut të sëmundjes duhet të jetë gjëja e parë, e më pas të shikohet sëmundja, e në fund të flitet për ilaçin. Njohja e faktorëve është rrugë që e ndërpret zhvillimin e saj dhe e ndalon të përsëritet. Pejgamberi, paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të, ka thënë: “Nuk kafshohet besimtari nga një vrimë (të njëjtë) dy herë”.

Ai që analizon këto dy ide të kundërta (ideologjinë e irxhasë dhe ideologjinë e tekfirit bashkëkohor) dhe hulumton të gjejë faktorët e paraqitjes të tyre, domosdo duhet t'i kthejë ato në dy shkaqe themelore. Ato i ka përmendur **Shatibiu**: “Origjina e

divergjencave, që ka ngjarë në

umetin tonë ka dy shkaqe. Shkaku i parë nuk ka lidhje me robërit (njerëzit). Ai kthehet në kader, ndërsa shkaku tjetër është rezultat i veprave të bëra”.¹

Sa i përket Kaderit, Allahu ka dashur për ndonjë urtësi të madhe, që njerëzit të mos jenë të gjithë një umet i bashkuar. Allahu ka thënë: *“Sikur të kishte dashur Zoti yt, të gjithë njerëzit do t'i bashkonte në një bashkësi të vetme, por ata vazhdojnë të jenë të përçarë, përveç atyre, që i ka mëshiruar Zoti yt. Për këtë qëllim Ai i krijoi ata.”* Hud 118-119.

Sa i përket shkaqeve veprore, ato janë tema jonë këtu shkurtimisht, por pasi t'i sqarojmë dy hyrje.

Hyrja e parë: Ideologjitë nuk vdesin

Çdo ideologji që paraqitet në shoqëri, sado të vjetrohet dhe të dobësohet përsëri mbetet. Këtë nuk mundemi ta mohojmë. Ai që lexon historinë islame dhe fraksionet e saj do të shohë se rrymat ideologjike, ndonjëherë forcohen dhe herë të tjera dobësohen. Mirëpo ato nuk zhduken, ato mbesin të dobësuar

Irxha gjuhësisht: vonim, ndërsa terminologjikisht d.m.th. pretendimi se veprat nuk numërohen pjesë e imanit, ndërsa pasoja e këtij pretendimi është: secili që deklaruar se është besimtar mbetet i tillë pavarësisht çfarë vepra bën dhe çfarë nuk bën.

Tekfir d.m.th. gjykim për një njeri se nuk është musliman.

¹ El Itisam (2/164)



derisa të gjejnë dikë që do t'i trazojë. Për këtë shkak çdo fraksion që ka ekzistuar në historinë e umetit, nuk është për t'u çuditur nëse rishfaqet, kur të ketë dikush që do ta përvetësojë, pa marrë parasysh a shfaqet plotësisht, apo pjesërisht, shfaqet me formën e saj të parë, apo me një formë tjetër të ndryshme.

Orientimi i tekfirit dhe nxjerrjes së njerëzve nga imani për shkak të mëkateve të mëdha është një orientim, që ka ekzistuar në historinë islame të Havarixhët dhe Mutezilitë. Ky orientim ka mbetur edhe pse sot i dobësuar. Gjithashtu krahu shiit, themelohet mbi tekfir, e që kjo demonstron me tekfirin e sahabëve, radijallahu anhum. Kjo ideologji përfaqësohet nga grupime të ndryshme.

Siç e gjejmë tekfirin, po ashtu e gjejmë edhe irxhanë, madje edhe më qartë. Është përhapur në etapat e mëvonshme me një përhapje të gjerë. Mjafton të dish se Esharitë dhe Maturiditë mbështesin këtë ide që pastaj të mësosh se sa institucione islame të mëdha e mbështesin këtë orientim.

Çështja e dytë: Ndryshimi i jashtëm nuk e ndryshon brendinë

Dihet se vlera e gjërave qëndron në realitetin dhe kuptimin e tyre, e jo në

formën dhe ndërtimin e tyre.

Sot vërejmë paraqitjen e tekfirit dhe irxhasë, e cila ka veshur petkun e rrugës së selefit (gjeneratave të para) dhe me të identifikohet. Argumenton me fjalët e tyre për të dëshmuar atë dhe pretendon se ky është besimi i grupit të shpëtuar. Ata ndoshta kanë lënë diçka nga idetë e tyre, me qëllim që ta arsyetojnë drejtimin e tyre.

Për tu identifikuar një grup me një ideologji, nuk është domosdo t'i marrin të gjitha mendimet e tyre, por mjafton të pajtohen në thelbin e asaj ideologjie. Prandaj, ulematë kur kanë numëruar fraksionet e bidatçive i kanë emëruar sipas fraksioneve bazë, edhe pse ka mjaft dallime midis tyre.

Kur **Ebul Hasen Eshariu** foli për Murxhitë, foli për divergjencën e tyre rreth përkufizimit të besimit dhe i ndau në dymbëdhjetë fraksione.² Gjithashtu kur filloi temën e havarixhëve, përmendi thelbin e ideologjisë së tyre, pastaj divergjencën rreth atij thelbi dhe në fund tekfirin e njëri-tjetrit.³

Ibën Tejmije ka thënë: "...sepse këta dhe të tjerët si këta, nuk i kanë kuptuar fjalët e selefit, por u dalin zot mendimeve të cilat i kanë marrë nga apolojetët (mutekelimunët) xhehmij dhe bidatçitë e tjerë. Kështu që fjalët

² Mekalatul Islamijjin (1/213)

³ Mekalatul Islamijjin (1/167)

në shikim të parë janë të selefit, ndërsa kuptimi i tyre merret nga xhehmitë, të cilët janë më të prishurit në çështjen e imanit”.⁴

FAKTORËT E ZHVILLIMIT DHE TË PARAQITJES

Faktori i parë: Mos-nxënia e dijes nga dijetarë të sigurt

Si shkak i përhapjes së mësimdhënies dhe shkrimeve të shumta në ditët e sotme, është shtuar edhe nxënia e dijes drejtpërsëdrejti nga librat pa e dëgjuar nga goja e dijetarëve. Kjo ka shkaktuar gabime të mëdha siç janë keqkuptimi i termeve të sheriatit, mosdallimi i çështjeve divergjente dhe paaftësia për të parë gabimet e disa mendimeve.

Këto anomali dhe të tjera ishin shkak që selefi ta ndalojë marrjen e diturisë nga ata të cilët e kanë fituar dijen prej librave. **Ebu Zura ka thënë:** “Nuk guxon t’u japi fetva njerëzve letraxhiu”.⁵ Po sjell këtu një çështje si shembull për pasojat që vijnë nga marrja e dijes vetëm prej librave, kur keqkuptohen.

P.sh.: mungesa e kuptimit të dallimit midis *miqësimit me jobesimtarët (teveli)*, që është një nga gjërat që e çrrënjësin imantin dhe *bashkëpunimit me jobesimtarët (muvalat)*, gjë që është mëkat.

Bërja e tekfirit me shikim të parë rrezikon që një gabim i cili është gjynah të gjykohet si kufër. Shembull për këtë është rasti me **Hatib ibën Ebi Belta**, kur u shkroi një letër kurejshëve për marshimin e Pejgamberit dhe muslimanëve në drejtim të tyre për çlirimin e Mekës. Kjo është muvalat me qafira. Ky muvalat bëhet ndoshta për ndonjë interes të dynjasë (ruajtja e familjes dhe pasurisë që kishte në Mekë), por mund të bëhet edhe për shkak se përkrahë dhe pëlqen fenë e tyre! Prandaj, Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem*, e ka pyetur për këtë veprim, e ai është

përgjigjur: “Unë isha me kurejshët, por nuk jam kurejshit. Ndërsa muhaxhirët e tjerë, që janë me ty kanë fisin e tyre, të cilët u mbrojnë familjet në Mekë. Kështu, duke qenë se nuk kam afërsi gjaku me kurejshët, desha t’u bëja një nder që për shkak të tij të më mbronin familjen. Këtë akt nuk e bëra si femohues”.⁶ Me këtë na bëhet e ditur se vepra e tij është vetëm gjynah e jo kufër. Për këtë shkak Pejgamberi tha: “Por ai ka marrë pjesë në Bedër. E ku e di ti, o Omer! Ndoshta Allahu i Lartësuar i ka parë luftëtarët e Bedrit dhe ka thënë: “Bëni çfarë të doni, se unë jua kam falur të gjitha!”; e sikur të bënte kufër, nuk do t’i bënte dobi pjesëmarrja në Bedër.

Pra, kur njeriu nuk i kupton fjalët e dijetarëve lidhur me dallimin se çfarë është kufër dhe çfarë jo, atëherë doemos do të gabojë në këtë temë.

Faktori i dytë: qëndrimet kundërshtuese

Kundërveprimet kanë rol të qartë në shfaqjen e ideologjive ekstremiste, si ajo e tekfirit dhe e irxhasë në ditët e sotme.

Sa i përket ideologjisë së tekfirit, thuajse shumica e atyre që e kanë analizuar dukurinë e ekstremizmit të këto grupime pajtohen se nga shkaqet më të rëndësishme, që i kanë shtyrë këto grupe të marrin kësi qëndrimesh ekstreme është lufta nëpër të cilat morën pjesë ndjekësit e këtyre grupeve që pastaj rrjedhimisht edhe kundërveprimet e tyre ndaj shoqërisë, qofshin ata pushtet apo popull. Disa nga të rinjtë e xhemateve islamike, të cilët përfaqësonin rininë më të mirë të Egjiptit, në vend se të gjejnë mbështetje për të realizuar shpresat e tyre për një jetë fisnike islame, kundër tyre u thurën akuza të rrejshme dhe të falsifikuara. Më pas e gjetën veten nëpër burgje dhe u bënë pre i kërbaçëve të xhelatëve dhe i mjeteve të ndëshkimit, ndërsa në anën tjetër

⁴ Mexhmuul Fetava (7/143)

⁵ El Fekihu uel Mutefekih (2/97)

⁶ Sahihul Buhari nr. 4890; Sahihu Muslim nr. 161

duart e armiqve të Islamit ishin të lira të veprojnë gjithçka për të shembur vlerat dhe parimet Islame.

Madje, ndodhte u merreshin edhe gratë si peng dhe vendoseshin nëpër burgje e ndëshkoheshin derisa ktheheshin burrat e arratisur.

Si rezultat i gjithë kësaj, këta njerëz ndien se ata që bëjnë kësi vepra të egra, madje sheriatin e cungojnë dhe bëjnë shumë harame tjera, ata nuk mund të jenë muslimanë dhe kështu ideja e tekfirit u shfaq mjaft e fortë në disa xhemate. Kur u shfaq kjo ideologji dijetarët u treguan të gatshëm ta qartësojnë këtë dukuri. Mirëpo qëndrimet emocionale dhe debatet e ndryshme shkaktuan kundërveprime tjera të gabuara, sikurse kushtëzimi i tepruar që haramin ta konsiderojë hallall për ta bërë tekfir një njeri. Saqë e kushtëzuan këtë edhe për veprat e qarta të mosbesimit, sikurse nëpërkëmbja e Mus'hafit, fyerja e Pejgamberit, anulimi i sheriatit, për të cilat thanë: Vepruesi i tyre nuk guxon të quhet qafir përveç nëse mendon se janë hallall. E gjithë kjo u bë vetëm me qëllim që gjykimi me tekfir të jetë i sigurt!

Kështu që, të gjithë kufrin e lanë të jetë ose mohim ose konsiderim i haramit hallall, asgjë tjetër.⁷

Disa që mbështesin këtë mendim, janë shprehur haptazi se këtë e bënë “si kundërpërgjigje ndaj atyre që i bëjnë tekfir muslimanët, të cilët çështjen e tekfirit të kryetarëve e bënë thelb të çështjeve madhore të tyre dhe sprovë më të rëndë” dhe se “aktivistët islamistë e kanë tepruar me tekfinin e gjynahqarëve dhe delikuinteve, e sidomos kryetarëve”.⁸

Kështu pra, kundërveprimet patën rol në shfaqjen e ekstremizmit të dy anët e kundërta.

“...Ebu Zura ka thënë: “Nuk guxon t’u japi fetva njerëzve letraxhiu”...”

Faktori i tretë: paaftësia e bashkëveprimit me situatën aktuale

Në këtë kohë janë shfaqur disa probleme, që nuk i kanë ndodhur umetit më parë: braktisja e të gjykuarit me Librin e Allahut, kurthet për t’i dëmtuar këshillëdhënësit, vërsulja e popujve, theksimi i armiqësimit të Fesë nga ana e disave që identifikohen me këtë fe dhe shprehja se nuk është i përshtatshëm për zbatim. E tëra kjo me një masë të madhe, prandaj dallon nga ajo që umeti e përjetoi në të kaluarën, ku edhe nëse kishte gabime dhe mangësi nuk ishin ato në këtë masë të madhe, siç është në kohët e fundit.

Në këtë situatë, umeti ka nevojë më shumë se kurrë për dijetar të shpirtit, i cili do të ketë mundësi të ballafaqohet me këto probleme, duke dhënë zgjidhjen fetare për to dhe jo të arsyetojë situatën në llogari të Fesë apo të mos tregojë interes në analizimin dhe studimin e situatës së umetit dhe shoqërisë.

Por, në vend se të kemi dijetarë të aftë për të dhënë ixhtihad rreth çështjeve bashkëkohore, dy dekadat e fundit dhe të tjera më herët ishin mbyllje e derës së ixhtihadit dhe ndalim i tij. Madje, ai që mendonte se ixhtihadi lejohet, konsiderohej se ka bërë gjynah të madh, apo ndoshta edhe kufër. Nga akuzat e kundërshtarëve të thirrjes selefite ishte edhe ajo pse këta të fundit e lejojnë ixhtihadin!

Ndërkohë, duke u munduar t’i bëhet një përballje situatës – por në mungesë të dijetarëve të mirëfilltë – u shfaqën dy drejtime, njëri drejtim nuk dinte t’i bëjë ballë gabimeve dhe thirri në izolim dhe braktisje të shoqërisë

⁷ Sajhatu Nedhir fq. 39

⁸ Hakikatul Hilaf bejne Selefije Sherije ue edijaiha fq. 161

inJORante, me gjithë organizmat që ka. I gjyquan shoqëritë si femohuese pasi po pajtohen me atë sistem dhe nuk bëjnë as gjënë më të vogël nga islami; kurse drejtimi tjetër, e arsyetoi gjithë situatën, me të gjitha format e saj dhe mori qëndrimin se kushdo që thotë shehadin është musliman, pa marrë parasysh se çfarë vepra të kufrit dhe shirkut bën, përveç nëse e dimë se me zemër do ta mohojë fenë apo do ta konsiderojë haramin hallall.

Mirëpo, e vërteta është: ai që është i bindur në Islam dhe është i sinqertë, doemos do t'i mësojë rregullat e përgjithshme dhe shumëpërfshirëse që vlejnë për çdo situatë. Kush i kupton mirë themelet dhe synimet e Islamit, do të ketë aftësi të gjejë zgjidhjen për çdo çështje të re, me kusht që të jetë i sinqertë dhe të fitojë suksesin nga Allahu.

Faktori i katërt: synimet e sëmura të atyre që pretendojnë se kanë dije

Nga ato synime, më të theksuarat dhe që shkaktuan paraqitjen e këtyre dy ideologjive janë ndjekja fanatike ndaj hoxhallarëve të tyre, tentimi për ta arsyetuar gjendjen faktike dhe moskthimi tek e drejta edhe kur u bëhet e qartë. Ndryshe, kjo përkthehet: pasim i epshit.

Pasimi i epshit është fillimisht qëndrim, i cili forcohet me argumentim, ndaj secilin argument e shtrembërojnë për ta pajtuar me atë qëndrim. Ndërsa te pasuesit e hakut është e kundërta, ata fillimisht i marrin argumentet, u nënshtrohen atyre dhe pastaj marrin qëndrimet përkatëse.

Ndikimin e këtij shkak ndoshta e forcoi edhe inferioriteti i dijetarëve të mirëfilltë, të cilët nuk shpjeguan hakun dhe nuk sqaruan qëndrimin, ndoshta për ndonjë arsye!

Faktori i pestë: tekstet muteshabih (jo të qarta) nuk i kuptuan sipas teksteve muhkem (të qarta)

Allahu i Madhëruar ka treguar se disa

⁹ Tefsirul Kuranil Adhim (3/7,9)

“Në këtë situatë, umeti ka nevojë më shumë se kurrë për dijetar të shpirtit, i cili do të ketë mundësi të ballafaqohet me këto probleme...”


ajete janë muteshabih dhe të tjerat muhkem. Na rrëfeu se rruga e atyre që zemrat i kanë të sëmura është marrja e teksteve muteshabih dhe moskuptimi i tyre sipas teksteve muhkem, ndërsa në anën tjetër, rruga e atyre që kanë dije të thellë është kuptimi i ajeteve muteshabih sipas ajeteve muhkem. Muteshabih janë ato ajete që nuk janë të qarta, që mund të kuptohen ndryshe, madje duke u bazuar në aspektin gjuhësor mund të keqinterpretohen.⁹ Allahu i Madhëruar ka thënë: *“Ai është që ta zbriti librin ty e që në të ka ajete të qarta dhe ato janë bazë e librit, e ka të tjerë që nuk janë krejtësisht të qartë (muteshabih). E ata, që në zemrat e tyre kanë anim nga e shtrembra, ata gjurmojnë atë që nuk është krejt e qartë për të shkaktuar huti, e kinse kërkojnë komentin e tyre.”* Ali Imran 7.

Duhet ditur mirë se ata që ndjekin metodologji të ndryshme nga udhëzimi i gjeneratave të para, marrin një tekst dhe krijojnë një mbështetje që nuk lejojnë të kundërshtohet, ndërsa në realitet ai kundërshtohet nga tekste të qarta; ose marrin një tekst që flet për një çështje të caktuar dhe e përgjithësojnë deri në skajshmëri.

Kjo që u tha më lartë është një qasje e shkurtër në këtë temë, që meriton të zgjerohemi më tepër. Allahu dhëntë sukses, s'ka të adhurar me të drejtë përpos Tij. ■

Zgjedhi nga arabishtja:
Ali SHABANI

DEBATI I IBËN TEJMIJES ME SHIAT RAFIDIJ



Ehli Suneti është më korrekt me çdo fraksion, se sa vetë ithtarët e një fraksioni mes tyre, ata edhe ndaj rafidive janë më të mirë se sa rafiditë ndaj njëri tjetrit... këtë e kanë pranuar edhe ata vetë.”

DR. ABDULAZIZ IBËN MUHAMED ABDULATIF

Shejhulislam Ibën Tejmije krahas shumë gjërave është shquar edhe me debatet e tij me ithtarët e feve dhe fraksioneve të ndryshme. Prej fraksioneve të devijuara me të cilët ka debatuar shumë herë janë Rafiditë. Kemi hasur të shkruar vetëm dy prej atyre debateve:

Dabati i parë: Ibën Tejmije polemizoi me njërin prej klerikëve shiitë rreth temës: “pagabueshmëria e Imamit – udhëheqësit shiit” dhe se Aliu, radijallahu anhu, është tërësisht i mbrojtur nga rënia në mëkate, të mëdha qofshin ato apo të vogla. Shejhulislami e kundërshtoi këtë besim duke sjellë fakte bindëse, prej të cilave raste të shumta nga historia e sahabëve, ku Aliu dhe Abdullah ibën Mesudi kanë pasur divergjenca ndërmjet

tyre për çështje të caktuara, pastaj ky mospajtim kur i është paraqitur Pejgamberit, alejhi salatu ue salam, është vërtetuar se mendimi i Abdullah ibën Mesudit ka qenë i sakti. Sipas burimeve të sakta fetare vetëm pejgamberët kanë qenë të mbrojtur nga mëkatet.¹

Debati i dytë: Ibën Tejmije flet për një debat të tij me një klerik shiit lidhur me çështjen e imamit si koncept i besimit shiit. Ai tregon: “njëri prej të nderuarve të këtij fraksioni kërkoi prej meje që të debatojmë me dyer të mbyllura për këtë çështje. Unë pranova dhe në fillim i bëra me dije besimin e tyre rreth kësaj çështje, si për shembull: Allahu i ngarkoi robërit e Tij me detyra dhe i ndaloi nga disa vepra, prandaj obligohet që njerëzve t’ju dhurojë butësinë (mëshirën) me të cilën do të munden t’i kryejnë detyrat dhe të largohen nga ndalesat... këtë e kanë marrë nga Mutezilitët. Pastaj kanë thënë: imami është butësia, ngase kur njerëzit kanë imam, i cili do t’i urdhërojë t’i kryejnë detyrat dhe do t’i ndalojë nga të këqijat, njerëzit do të zbatojnë më lehtë urdhrat dhe kështu do t’i braktisin mëkatet. Për këtë arsye është e domosdoshme që të kenë imam. Ky imam duhet të jetë patjetër i pagabueshëm, sepse nëse nuk është i tillë nuk arrihet qëllimi. Pagabueshmëria nuk iu la askujt pas Pejgamberit, alejhi salatu ue salam, përpos Aliut, prandaj bëhet e qartë në mënyrë të domosdoshme se ai është i vetmi që do mbetet i pagabueshëm... pastaj u zgjerova duke sqaruar mendimin e tyre dhe referencat.

Pastaj kanë thënë: Aliu, pas tij caktoi Hasanin, Hasani caktoi Husejnin derisa përfundon emërimi tek imami i fundit, i prituri Muhamed ibën Hasani. Pasi përfundova ai u pajtua se besimi i tyre

“Çdo i mençur mund të shikojë atë që ndodh në kohën e tij, fitnet, sherret dhe fesatet që ndodhin kundër Islamit, ai do të vërejë se shumica e tyre vijnë nga rafiditë...”

ishite mu ashtu siç ia paraqita unë.

I thashë: unë dhe ti jemi kërkues të diturisë dhe të vërtetës, kurse shiitët thonë: kush nuk beson në imamin e prituri ai është kafir. Unë po të pyes: këtë imamin e prituri e ke parë? Apo a ke parë ndonjë që e ka parë atë? Apo a di ndonjë fjalë që ai ka thënë? A di ndonjë urdhër apo ndalesë të tij të transmetuar ashtu siç transmetohen fjalët e imamëve?

Ai tha: JO.

I thashë: çfarë dobie ka nëse besojmë në këtë imam? Çfarë butësie fitojmë nëpërmjet këtij imami? Pastaj si mundet që Allahu të na ngarkojë me respektimin e dikujt, kur ne nuk dimë se çfarë na urdhëron e çfarë na ndalon, madje nuk ekziston asnjë rrugë për të mësuar një gjë të tillë? Kurse ju jeni ata që e mohoni më shumë ngarkimin me gjëra të parealizueshme. Çështja në fjalë është mu prej këtij lloji të obligimeve.”²

Duke shikuar këto dy debate të Shejhul Islam Ibën Tejmijes themi:

1. Çështja e imamit është një bazament i besimit të rafidive rreth të cilit sillen të gjitha fjalët e ithtarëve të këtij medhhebi të devijuar. Ndikimi i këtij themeli shihet

¹ Elukud Durrije, 122

² Minhaxhu sunneti nebevije, 1/101

në Fikhun, Akiden, Tefsirin dhe shkencat e tjera të tyre. Kjo çështje është karakteristike vetëm për këtë sekt, për këtë Ibën Tejmije thotë: “Çështja thelbësore e medhhebit rafidij imamij ithnaasherij është besimi në imamin e pagabueshëm, pretendimi se imamlleku i Aliut, radijallahu anhu, është i përcaktuar qartë nga Ligdhënësi, pastaj edhe për të tjerët pas tij, një nga një.”³ Sa i përket bazamenteve tjera siç janë: teuhidi, drejtësia, pejgamberia, rafidijtë janë njësoj me fraksionet e tjera të devijuara.

Nuk është për t'u habitur pse Ibën Tejmije kontribuoi në demantimin e këtij themeli shiit, me sqarimin e tij se ky besim është një degjenerim, pra, besimi se dymbëdhjetë imamët e tyre janë përcaktuar me tekst të qartë nga Ligdhënësi, pagabueshmëria e tyre, se imami i pritur është mëshira e Allahut ndaj robërve të Tij, sepse kur të qartësohet pasaktësia e këtij besimi bie poshtë gjithçka, që është ngritur mbi këtë besim, goftë akide ose Fikh.

2. Shejhulislami nuk u mjaftua vetëm duke debatuar e polemizuar me rafiditë, porse i luftoi ata edhe me shpatë në vendin e tyre vetëm për një arsye: për shkak të devijimit të shëmtuar dhe tradhtinë e tyre të madhe që u kanë bërë muslimanëve përgjatë historisë. Ai për ta thoshte: “Çdo i mençur mund të shikojë atë që ndodh në kohën e tij, fitnet, sherret dhe fesatet që ndodhin kundër Islamit, ai do të vërejë se shumica e tyre vijnë nga rafiditë. Ata janë fitneshinjtë dhe sherrshinjtë më të mëdhenj. Po ju dha mundësia për të bërë

fitne e sherr ata asnjëherë nuk rrinë duarkryq.”⁴ Pasi përmendi ndihmën që rafiditë u kanë dhënë armiqve të muslimanëve tha: “Për këtë arsye rafiditë miqësohen me armiqtë e fesë, me ata që çdonjëri e njeh armiqësinë e tyre, qofshin ata çifutë, të krishterë apo politeistë. Ata armiqësojnë miqtë e Allahut, të cilët janë besimtarët më të mirë, zotërinjtë e devotshëm. Rafiditë ishin shkaku kryesor që ua mundësuan mongolëve mosbesimtarë për të hyrë në vendet e muslimanëve. Ata ishin shkaku kryesor për rënien e Bejtul Makdisit në duart e të krishterëve.”⁵

Shejhulislami dha fetva për t'i luftuar ata. U bëri thirrje që t'i binden sheriatit të Allahut në vitin 699 h. ku u tha: “Dihet se në bregdetin e Shamit është një kodër e madhe⁶. Aty qëndrojnë mijëra rafidi, të cilët derdhin gjakun e pafajshëm të muslimanëve, ua marrin pasurinë, kurse robërit ua kanë shitur të krishterëve. Mu për këtë, kur një pushtetar pyeti për ta, unë shkrova një përgjigje të shtjelluar lidhur me lejimin e luftimit të tyre.”⁷ Shejhulislami vazhdon të tregojë: “Iu afruam vendit të tyre. Më erdhën një grup prej tyre dhe zhvilluam debate e negociata të gjata. Ndërkohë muslimanët çliruan vendin e tyre dhe dominuan mbi ta. Atëherë unë ua ndalova që t'i vritnin apo që t'i robëronin, por urdhërova që të shpërndahen nëpër vendet e muslimanëve që të mos grumbullohen në një vend.”⁸

3. Me gjithë urrejtjen dhe shtypjen që ushtronin ndaj Ehli Sunetit sërish Ehli Suneti u sollën me ta me drejtësi të plotë,

³ Tisinije 2/625

⁴ Minhaxhu sunneti nebevije 6/372

⁵ Minhaxhu sunneti nebevije 7/414

⁶ Emri i kodrës është Keservan

⁷ Erred ala ehli Keservan

⁸ Minhaxhu sunneti nebevije 5/158

mu ashtu siç veproi me ta Shejhulislami kur e shpërndau grumbullin e tyre. Ai nuk lejoi që të vriten, robërohen edhe pse ata kishin vrarë muslimanët më parë dhe i kishin robëruar ata.

Rafiditë e kanë pranuar këtë. Ata e dëshmuar me gojën e tyre se Ehli Suneti janë sjellë me ta me aq drejtësi, saqë as vetë rafiditë mes vete nuk kanë qenë të tillë. Për këtë Shejhulislami thotë: “Ehli Suneti kundrejt tyre janë të drejtë dhe korrekt, nuk u bëjnë padrejtësi ngase padrejtësia është haram në çdo rast. Madje Ehli Suneti është më korrekt me çdo fraksion, se sa vetë ithtarët e një fraksioni mes tyre, ata edhe ndaj rafidive janë më të mirë se sa rafiditë ndaj njëri tjetrit... këtë e kanë pranuar edhe ata vetë.”⁹

Në një vend tjetër Ibën Tejmije thotë: “Çdo grup i Ehli Sunetit janë shumë më të ditur, dhe më të drejtë, dhe më larg injorancës e padrejtësisë se sa rafiditë. Këtë e ka dëshmuar shikimi dhe dëgjimi. Nuk ka fraksion më rrenacak e më të padrejtë se sa rafiditë. Këtë e dëshmojnë edhe klerikët e tyre, të cilët thonë: Me të vërtetë Ehli Suneti janë burra, sikur ne të kemi fuqi mbi ju nuk do të silleshim me drejtësi ashtu siç sillen ju me ne.”¹⁰

4. Në debatin e dytë shohim një etikë të lartë të Shejhulislamit. Me kundërshtarin ai sillej në mënyrën më të mirë, ai ishte u butë me ta, prandaj ai i cilësoi ata si “i nderuar” i grupacionit të vet. Pranoi që të flasë me ata me dyer të mbyllura, për një temë të caktuar. Ai e sqaroi medhhebin e kundërshtarit me korrektësinë më të plotë, madje edhe kundërshtari i tij e pohoi një gjë të tillë. Ibën Tejmije ishte i sinqertë deri në kulm, kur bëhej fjalë për

të vërtetën. Shkaku që e shtynte atë në debate ishte këshillimi, mëshira e jo dëshira për triumf e famë.

5. Shejhulislami karakterizohet me një fuqi të madhe argumentimi, me debate konstruktive dhe me njohje të thellë të medhhebit të kundërshtarit. Kjo nuk është për t’u habitur shumë, sepse ai vetë thotë: “Unë di çdo bidat që është shpikur në Islam, kush është i pari që e shpiku atë dhe cili ishte shkaku i paraqitjes së tij.”¹¹

Në debatin e parë Shejhulislami kërkoi prej tyre argumente për pagabueshmërinë e imamit, sepse pagabueshmëria nuk mund të vërtetohet për askënd tjetër përveç pejgamberëve, alejhim selam. Ky pretendim nuk merret parasysh, edhe nëse e thonë një numër i madh njerëzish. Ajo që merret parasysh është argumenti i qartë dhe i llojllojshëm.

Në debatin e dytë Shejhulislami nxori në pah kontradiktat e rafidive, sepse besimi në imamin e pritur nuk mund të jetë mëshirë prej Allahut. Kjo i ngjan ngarkimit me gjëra që s’mund të mbahen, kurse ata kapen më shumë pas këtij rregulli. Shejhulislami në përfundim dha këtë rregull: “Nuk di ndonjërin që del nga suazat e Kuranit dhe të Sunetit e të mos jenë kontradiktorë.”¹² ■

Shkëputur nga libri “Munadherat Ibën Tejmije li ehlil mileli ue nihal” nga arabishtja: Agim BEKIRI

⁹ Minhaxhu sunneti nebevije 5/175

¹⁰ Minhaxhu sunneti nebevije 4/121

¹¹ Mexhmuul fetava 2/548

¹² Mexhmuul fetava 13/305



JU TREGOJ DIÇKA PËR SUFIZMIN

(PJESA E PARË)

Po, u përhap dhe u vërtetua ndër ta ajo për të cilën Profeti i kishte këshilluar, ata tashmë filluan të bien në atë që ai qortoi; filluan kokat e së keqes të dalin e bimët e helmëta të mbijnë. Filluan të shfaqen grupet e para, të cilët e filluan nga një shkëndijë e vogël e që më pas u përhapën e u bënë bindje, medhheb e fe

SHKRUAN: BLEDAR HAXHIU

Përpara se të hymë në temën tonë, është e udhës që të theksojmë se: Allahu i Lartësuar u caktoi njerëzve nëpërmjet Profetit *sal-lallahu alejhi ue selem*, fenë të cilën Ai e pëlqen, duke ua sqaruar atyre se çdo fe, rrugë apo ideologji tjetër nuk do të jetë e pranuar.

Po ashtu Profeti Muhamed u përpoq t'ia sqarojë umetit çdo detaj të kësaj feje dhe Allahu e mori pikërisht atëherë kur feja

ishte e plotësuar.

Kështu Profeti vdiq dhe umetin e tij e la në një rrugë të qartë, ku nata e dita janë njësoj e ku humb vetëm ai që është i shkatërruar. Ndaj në këto kohë e kurdoherë është plot me vlerë thënia e imam Malikut: “Ajo që nuk ishte dje fe, nuk mund të jetë as sot fe.”

Përveç kësaj Profeti *sal-lallahu alejhi ue selem*, e sqaroi umetin e tij dhe i tërhoqi vërejtjen për gjëra në të cilat do të binin, si thënia e tij: “*Do t'i veproni/imitoni sjelljet e popujve para jush, pëllëmbë për pëllëmbë*

dhe hap pas hapi, aq sa nëse ata do të hynë në gropën e hardhucës do të hynit edhe ju...”¹

Punuan me këto ajete e hadithe brezat e parë të muslimanëve, sahabët e tabiinët, dhe Allahu i nderoi, iu dha sukses e i bëri të triumfojnë; ndërkohë që Islami u përhap në kultura të reja, kur injoranca filloi të shfaqej në horizontin e disa prej këtyre vendeve, kur muslimanët përkthyen dhe u angazhuan me librat e filozofisë greke e të tjera, ra në mesin e muslimanëve gjëma.

Po, u përhap dhe u vërtetua ndër ta ajo për të cilën Profeti i kishte këshilluar, ata tashmë filluan të bien në atë që ai qortoi; filluan kokat e së keqes të dalin e bimët e helmëta të mbijnë. Filluan të shfaqen grupet e para, të cilët e filluan nga një shkëndijë e vogël e që më pas u përhapën e u bënë bindje, medhheb e fe. Nga këto grupe që dolën ndër muslimanët dhe që vazhdojnë të jenë ende me shumicë është edhe Sufizmi, të cilët arritën në atë gjendje ku janë sot vetëm si shkak i largimit të tyre nga Kurani dhe Suneti.

Por ç’është Sufizmi? Ku i ka rrënjët ai?

Këto janë disa çështje të nxehta, të cilat do të trajtohen në këtë kënd, duke u përpjekur të ringjallim në mesin e muslimanëve paralajmërimin, këshillën dhe qortimin që Profeti i bëri umetit të tij, në mënyrë që të mbesin në rrugën e drejtë, të pa-devijuar e që të mos e gjejnë veten më pas ndjekës të ndonjë shejtani të mallkuar.

Ç’është Sufizmi?

Për prejardhjen e fjalës Sufizëm dijetarët islamë kanë shprehur mendime të shumta e të ndryshme, por këtu do të përmendim atë që mendojmë se është më afër me origjinën e kësaj rryme.

Fjala Sufizëm në shumicën e mendimeve rrjedh nga fjala Suf që do të thotë: Rrobë e leshtë, të cilën Sufitë e vishnin si formë adhurimi dhe shenjë asketizmi e përçmimi ndaj bukurive të kësaj bote, për këtë ata u quajtën dhe Sufi.²

Mendim tjetër është se Sufizëm rrjedh nga fjala Greke “Sofia” që ka kuptimin: urtësi, mençuri.

Shfaqja e Sufizmit dhe si filloi ai

Nëse hedhim një shikim në librat e Besimit dhe të Historisë gjejmë se fjala Sufizëm nuk njihej në mesin e sahabeve, madje as në mesin e tabiinëve, përkundrazi ky term dhe ky emërtim u shfaq pas kohës së tyre në Basra të Irakut, atëherë kur disa njerëz filluan ta tepronin dhe të tejkalonin kufijtë në adhurim dhe asketizëm, madje në një shkallë, e cila nuk njihej më parë.

Edhe ky sekt, si çdo sekt tjetër fillimin e tij nuk e kishte shumë të ndryshëm nga masa e gjerë e Islamit, me përjashtim të disa teprimeve që ata bënë në adhurim dhe sjellje, dhe kjo edhe për vetë faktin se fillimet e këtij sekti ishin në një kohë kur dija ishte e pranishme dhe ekstremi i kritikuar nga dijetarët, gjë që bëri që kjo rrymë të mos hapej rrethi i saj në sjellje dhe ndjekës.

Nëse shohim me kujdes se ku filloi Sufizmi ndoshta e kuptojmë se ai është një teprim i urryer dhe me të vërtetë larg nga rruga e kërkuar profetike, edhe pse veshjen dhe paraqitjen e jashtme në pamje të parë e ka islame, sepse Profeti *sal-lallahu alejhi ue selem*, iu drejtua atyre tre personave, të cilët vendosën ta tepronin - duke agjëruar, falur dhe duke mos iu afruar grave - me këto fjalë: *“Unë jam njeriu që i frikësohem dhe ia kam drojën më shumë se çdokush nga ju*

¹ Buhari, Muslimi etj.

² Mexhmu Fetaua të Shejhul Islam Ibën Tejmijes (11/195).

³ Buhari dhe Muslimi nga hadithi i Enesit. # Të cilët nuk mund të quhen Sufi, por që konsiderohen si imamë nga pasuesit e këtij sekt.

Allahut, por unë agjëroj dhe ha, falem dhe fle dhe unë martohem me gra”³.

Shkaqet që çuan fillimisht në këto qëndrime dhe veprime – pra, teprimi në veçim dhe mos-përzierje si dhe teprimi në disa adhurime - ishte përhapja e fitneve/sprovave të shumta të brendshme; derdhja e gjakut të disa njerëzve të pastër; hapja e dynjasë dhe shtimi i pasurisë si shkak i çlirimeve të shumta, gjë që çoi në atë që një grup njerëzish të izoloheshin, dikush për të ruajtur veten nga këto fitne e dikush si një reaksion kur pa sesi shumë njerëz të dobët në fe filluan ta teprojnë me bukuritë e kësaj bote.

Nëse është kështu, ku qëndron problemi?

Problemi qëndron se kjo lëvizje nuk qëndroi në këto korniza, por ajo arriti në ato shkallë sa shkaktoi vesvese, largim total nga dynjaja – në një gjendje të përafërt me murgjëri - dhe devijime në sjellje e veprime, madje dhe më e rëndësishmja është se shpikën në fe adhurime, sjellje dhe mendime, të cilat nuk njiheshin më parë, por që në shumë raste shkaktuan edhe dalje nga feja.

Që kjo të kuptohet më mirë, patjetër që ka nevojë të flasim diçka për etapën e Sufizmit dhe sesi ai ka përparuar nëpër breza e shekuj, duke nxjerrë kështu një sërë rrymash e sektesh të reja, Allahu na ruajt nga rrëshqitja e këmbëve dhe lajthitja e mendjeve.

Etapë e parë:

Sikurse dhe e pamë dhe më lart, etapa e parë ishte adhurim dhe asketizëm i tepruar e që shoqërohej tek ndjekësit e kësaj rruge me vetmi dhe mos-përzierje, si dhe dominimi i frikës së madhe, e cila shkaktonte qarje të vazhdueshme apo të

“...Rrufaitë pretendonin se ata mund të hynin në zjarr e të dilnin pa u djegur aspak, atëherë Shejhul Islam ibën Tejmije i sfidoi duke i thënë se ai do të hynte me ta në zjarr...”

fikët, por që në përgjithësi në këtë etapë njerëzit i përmbaheshin parimeve të sheriatit dhe edukatës së Kuranit e Sunetit.

Nga figurat më të shquara të kësaj etape⁴ është dhe Amir ibën Abdulla ibën Zubejri, i cili agjëronte pandërprerë dhe që kishte adhurim të shumtë, aq sa i ati i tij, sahabi i nderuar Abdulla ibën Zubejr i tha: “O biri im! Unë e kam parë Ebu Bekrin edhe Omerin, por ata nuk ishin kështu!”⁵

Prej tyre ka qenë dhe Talk ibën Habibi, i cili ishte dijetar punëtor dhe nga asketët e mëdhenj; në këtë etapë hyn edhe Bishër Hafiu, koka e sinqeritetit dhe e përkushtimit; po ashtu Xhunejd ibën Muhamed ibën Xhunejd, i cili thoshte: “Dija jonë është e rregullt, atëherë kur ajo është nga Kurani dhe Suneti, ndaj ai që nuk merr e mëson nga Kurani e Suneti, nuk duhet të pasohet.”⁶

Përveç këtyre ka edhe të tjerë, por që qëllimet i kishin të mira me përjashtim të disa veprimeve jo të drejta në të cilat mund t'i bënte ndonjëri prej tyre, ose si shkak i injorancës, ose si shkak i asaj që gatuan me duart e tyre, duke punuar me hadithe të dobëta, duke mos e kuptuar. Këta bëjnë

⁴ Imam Dhehebiu në Sijer Alamu Nubela (5/219).

⁵ Risale e Kushejrit (1/118).

⁶ Rrëfime të marra nga librat e feve të mëparshme.

pjesë tek sufite e parë, por që duhet të thuhet se në këtë etapë u shfaqën këto cilësi prej tyre:

Të kapurit pas Suneti, me përjashtim të disa mangësive të vogla.

Respekti ndaj dijes dhe dijetarëve.

Humbja e Fikhut dhe mos angazhimi me hadithin.

Dhënia rëndësi e këshillave dhe historive që shpesh merreshin dhe nga Israilijatet.⁷

Mbizotërimi i frikës, brengës; shfaqja e agjërimit të pandërprerë; rënia e të fiktit dhe agonia kur dëgjonin Kuran.

Largimi nga dija dhe mos-angazhimi për të fituar riskun.

Jemi munduar t'i ndajmë këto dukuri në mënyrë kronologjike për t'u kuptuar edhe ndryshimet që janë bërë në këtë etapë.⁸

Etapë e dytë:

Kjo etapë karakterizohet me shfaqjen e sufizmit të vërtetë dhe rrymave e sekteve, të cilat lindën prej tij. Në këtë epokë u shfaq ajo që njihet si Dija e Brendshme dhe e Jashtme/e dukshme,⁹ shkarkimi nga detyrimet e sheriatit për evlijatë – sipas pretendimeve të tyre - për faktin se ata kanë arritur në dijen e vërtetë me anë të zbulesave dhe ëndrrave.¹⁰

Udhëheqësit e kësaj etape janë të parët dhe dirigjuesit e sekteve dhe rrugëve Sufiste si:

Ebu Hasen Shadhiliu (vdekur më 656 h), udhëheqësi shpirtëror i sektit Shadhili, i cili

“Ebu Zejd Bestamiu - i drejtohet Ehli Sunetit – “ju e merrni dijen tuaj nga të vdekurit, ndërsa ne –Sufite-, e marrim nga i Gjalli, i cili nuk vdes kurrë” ...”

edhe pse pohonte në ndonjë rast: Nëse zbulesat bien në kundërshtim me Kuranin dhe Sunetin, atëherë kapu pas Kuranit dhe lëre zbulesën dhe thuaj vetes se Allahu e ka siguruar paprekshmërinë e librit të Tij dhe Sunetit, gjë të cilën nuk e ka bërë me zbulesën e ëndrrat.¹¹ Porse fatkeqësisht ky person nuk iu përmbajt këtij pohimi, sepse po në të njëjtin burim pohohet se ka thënë: Kam pasuar deri tani Abduselam ibën Mashish, porse unë tani nuk pasoj askënd, përkundrazi unë tashmë notoja në dhjetë dete¹²: Muhamedin, Ebu Bekrin, Omerin, Osmanin, Aliun, Xhibrilin, Mikailin Azrailin, Israfilin dhe Shpirtin e madh.¹³

Po ashtu ndjekësit e Shadhiliut pohojnë, se kur ai ishte në Medine i ka folur vetë Profeti *sal-lallahu alejhi ue selem*: Kur shkoi në Medine qëndroi përpara derës së xhamisë që në agim deri në mesditë, me kokë të zbuluar e këmbëzbathur duke kërkuar leje nga Profeti që të hynte brenda, kur ja, dëgjoi një zë nga brendësia e Reudës

⁷ Akide Ehli Sune uel Xhema të Seid bin Musfir Kahtanit (388).

⁸ Dija e brendshme është dije, të cilën e pretendojnë sufite e të cilën e përfitojnë –sipas tyre-, nga zbulesat dhe ëndrrat, ndërsa dija e dukshme është ajo që e kuptojnë masa e muslimanëve, tek të cilët sufite fusin edhe dijetarët e Ehli Sunetit.

⁹ Fetaua Shejhul Islam Ibën Tejmiye (11/417-439).

¹⁰ Tabakat Sharani (2/4).

¹¹ Kam mbledhur dijen e këtyre të dhjetëve.

¹² Tabakat Sharani (2/6).

¹³ Reuda Sherife është vendi nga dhoma e Aishes e deri tek minberi i Profetit.

Sherife¹⁴, i cili i tha: O Ali, hyr brenda.¹⁵

Nga dirigjuesit e sekteve Sufiste është dhe Ahmed Rrifaiu për të cilin pretendojnë se kur bëri haxhillëkun në vitin 555 h, qëndroi përballë varrit të Profetit dhe tha: Selamu alejke o gjyshi im. Në këtë çast Profeti iu përgjigj: Ue alejke selam, o biri im. Këtë e dëgjoi kush ishte në xhami, madje Profeti nxori dorën nga varri i tij dhe Rrifai e puthi në prezencën e afërsisht nëntëdhjetëmijë burrave. Madje ata thonë se kush e mohon këtë ka dalë nga feja.¹⁶

Përkundrazi besimi i kësaj shpifjeje është injorancë e mangësi logjike.

Në kohën e tij Shejhul Islam ibën Tejmije ka pasur dialogë të fortë me Rrufaitë, sidomos në praninë e princit të Damaskut, kur Rrufaitë pretendonin se ata mund të hynin në zjarr e të dilnin pa u djegur aspak, atëherë Shejhul Islam ibën Tejmije i sfidoi duke i thënë se ai do të hynte me ta në zjarr, por me një kusht: që të laheshin me ujë të ngrohtë dhe uthull në mënyrë që të largonin yndyrat dhe ilaçet me të cilat lyenin trupin e tyre; më pas kush do të digjej, për të do të ishte zemërimi dhe mallkimi i Allahut dhe ai do të ishte i humbur. Ata kur e panë që iu zbulua hilja e s'kishin nga t'ia mbanin kërkuar teube.¹⁷

Mundet që t'i përmbledhim shfaqjet e sufive në këtë etapë si më poshtë:

Shfaqja e udhëheqësve të sekteve dhe rrugëve sufiste dhe vendosja e bazave dhe

e metodave të përgjithshme të këtyre sekteve.

Pretendonin pasimin e Kuranit, Sunetit dhe pasimin e sahabeve, ndërkohë që në praktikë ishin kundërshtues të kësaj motoje.

Prania e disa shtrembërimeve në shprehje, sjellje dhe veprime, gjë që çoi në refuzimin e tyre nga dijetarët e selefit, si dhe cilësimin e tyre si humbje.

Shfaqja e poemave sufiste, avancimi i tyre në dëgjimin e muzikës dhe ato që i shoqëronin atë si dehja dhe vallet.

Shfaqja e shprehjeve sufiste si: zbulesa, realitetet/fakte, të fshehtat, shuarje, dëshmia etj.¹⁸

Etapë e tretë:

Kjo konsiderohet nga etapat më të rrezikshme të sufizmit, për faktin se në këtë kohë filluan devijime drastike, të cilat vinin si shkak i ndikimit të filozofive të ndryshme, si ajo Greke, Perse, dhe nga besimet e mëparshme si Judaizmi e Krishterimi.

Ndër karakteristikat më kryesore të kësaj etape mund të veçojmë:

Formimi i bazave të Sufizmit dhe ndikimi i tejskajshëm i këtij sekti nga Krishterimi; si thënia dhe besimi i tyre në Itihad – njësimin midis krijuesit dhe krijesës -, mishërimin/personifikimin e Krijuesit me krijesën; shenjtërimin e individëve, të cilën e përfituan nga Mexhusët; shuarjen dhe rimishërimin, të cilën e morën nga Hindusët, po ashtu morën nga filozofia

¹⁴ Medrese Shadhiliye (32), Pra ky pretendonte se Profeti i kish folur afro 650 vjet pas vdekjes në praninë e të gjithë atyre që ishin në xhami. Çdokush që ka sado pak nga drita e shpalljes e kupton që këto janë thjesht shpifje të shëmtuara, Allahu na ruajt.

¹⁵ Kiladetu Xheuahir (104).

¹⁶ Këtë ngjarje e ka përmendur Shejhul Islam ibën Tejmije

¹⁷ "Derasat fi teseuf" i Ihsan Ilahi Dhahir (235).

¹⁸ "Der'u Tearud el Akël ue Nakël" i Ibën Tejmijes (5/82). Panteizmi është të besosh se çdo gjë në ekzistencë është një realitet i vetëm dhe se çdo gjë që shohim është një aspekt i ekzistencës së Allahut; me fjalë të tjera: është çdo gjë që shohim dhe çdo gjë që shohim është vetë Allahu i Lartësuar dhe i Madhëruar, qoftë nga ajo që i atribuojnë të padrejtët.

greke dhe afetarizmin e saj, panteizmin.¹⁹

Pretendimi se ata e merrnin dijen drejtpërdrejt nga Allahu, sikurse thotë Ebu Zejd Bestamiu²⁰ - i drejtohet Ehli Sunetit – “ju e merrni dijen tuaj nga të vdekurit, ndërsa ne –Sufitë-, e marrim nga i Gjalli, i cili nuk vdes kurrë”. Apo si thënia e Ibën Arabiut në librin e tij Futuhat Mekije:²¹ “Pasha Allahun! Nuk kam shkruar në librin Futuhat Mekije ndonjë shkronjë e të mos ketë qenë shkrim nga Hyji, apo recitim nga Zoti, apo fryrje shpirtërore, apo shpirt i ekzistencës.”²² Ndërsa unë them se kanë qenë inspirime Shejtanësh.

Rënia e tyre në shumë bidate në çështjet e akides si: shiizëm, irxha, në kader dhe largimi i madh nga ndjekja e Kuranit dhe Sunetit.

Rënia e disa prej tyre në veprime dhe punë të fëlliqura, duke pretenduar se ato janë nga çudirat e tyre.

Në këtë pjesë treguam se si ka filluar e është zhvilluar devijimi tek këta njerëz e në pjesën tjetër do t’ju tregojmë edhe më shumë. ■

¹⁹ I cili ka shprehur nga fjalët më të shpifura dhe nga më të pafetë si: I lartësuar jam Unë, sa e madhëruar është qenia Ime” -Subhani ma Adheme Shani-, shprehje të cilat janë lartësim vetëm për Allahun. Kjo ishte për shkak të besimit që ata kishin në mishërimin e Allahut në krijesat dhe me këtë fjalë ai besonte se madhëronte Allahun.

²⁰ Ibën Arabiu është një ndër ata, të cilin dijetarët e kanë quajtur renegat të pafe. Në këtë libër është mbledhur shirku më i madh që mund të ekzistojë, madje më ekstrem se i çifutëve dhe të krishterëve, që besojnë në trinitetin. Ndër të tjera në këtë libër ai thotë: Robi është Zoti dhe Zoti është rob. Do të dëshiroja të dija cili do të ishte ai që do të ngarkohej me detyrat e nevojshme. Apo: Ata që adhuroan viçin nuk adhuroan tjetër pos Allahut. Allahu na ruajt nga ky kufër i hapur.

²¹ Futuhat Mekije (3/456).

DREJTËSIA NDAJ KUNDËRSHT ARIT

Ne si muslimanë jemi të detyruar të jemi të drejtë edhe me ata që e mohojnë fenë tonë dhe nuk besojnë besimin tonë, e mos të flasim për ata që pavarësisht dallimeve që kemi mbesin brenda rrethit islam

SHKRUAN: ENIS RAMA

Ajo që është me rëndësi të përmendet në hyrjen e këtij punimi është se ajo që kemi ndër mend me termin kundërshtarë nuk janë ata që ne nuk pajtohemi me ata në një çështje sheriatit apo disa prej tyre. Por ajo që kemi parasysh janë ata që kanë një kuptim të posaçëm të fesë dhe një metodë të ndryshme në renditjen e bazave të fesë dhe argumentimit me to, ku rrjedhimisht nga kjo marrin një qëndrim të caktuar ndaj ndonjë prej çështjeve të fesë.

Shejhul Islam Ibën Tejmije thotë: “Dijetarët e mirëfilltë... e njohin të vërtetën, e cila është në pajtim me rrugën e të Dërguarit *sal-lallahu alejhi ue selem*, e pastër nga të gjitha llojet e risive dhe më pas janë të drejtë ndaj atyre që kanë dalë jashtë kësaj rruge, edhe në qoftë se këta të fundit u bënë padrejtësi atyre.

Allahu i Madhëruar thotë: “O

“...Kush shpif për ty apo ndodh që të bëjë imoralitet me ndokënd nga familja jote, nuk bën që ti të shpifësh për te, apo të bësh imoralitet me ndokënd nga familja e tij...”

squaruar të vërtetën dhe duke dëshmuar gabimin dhe padrejtësinë e kundërshtarëve, atëherë të gjithë këtë e bëjnë me qëllimin e mbrojtjes së të vërtetës dhe mëshirës ndaj njerëzve...-pastaj në vazhdim thotë:- “ ...për këtë arsye dijetarët e Ehli Sunetit asnjëherë nuk e anatemojnë kundërshtarin me mosbesim vetëm për shkak se ai i ka trajtuar kështu dhe i ka akuzuar ata. Kjo sepse ata janë të bindur, se shpallja e ndokujt si jobesimtar është një e drejtë e rezervuar vetëm për Sheriatin dhe në anën tjetër nuk i takon njeriut që ta kthejë padrejtësinë me të njëjtën mënyrë që i është bërë atij, sepse kush shpif për ty apo ndodh që të bëjë imoralitet me ndokënd nga familja jote, nuk bën që ti të shpifësh për te, apo të bësh imoralitet me ndokënd nga familja e tij...” (Er-Red ala Bekriyy-2/490,492).

Me këtë që u përmend më lart kuptojmë se raportet e Ehli Sunetit me ata që i kundërshtojnë ndërtohen me dituri, drejtësi dhe mëshirë e assesi nuk i diktojnë këto rregulla rrethanat, personat apo shkalla e padrejtësisë që bëhet. Këto rregulla janë të shumta dhe të ndryshme dhe padyshim nuk është e mundshme që të gjitha ato të trajtohen në këtë temë dhe në këtë vend, por ajo që do të mundohem ta bëj është të përmend disa nga rregullat e përgjithshme nën të cilat pastaj

besimtarë! Bëhuni të qëndrueshëm në urdhrat e Allahut dhe bëhuni dëshmuar me drejtësi! Le të mos ju nxisë urrejtja ndaj njerëzve për të bërë padrejtësi. Bëhuni të drejtë, se kjo është më afër devotshmërisë dhe frikësoruni Allahut!”

Maide 8. Prandaj ata i mëshirojnë njerëzit dhe u dëshirojnë vazhdimisht atyre të mirën, udhëzimin dhe dijen. Ata asnjëherë nuk e nisin të keqen, por nëse detyrohen të sillen më vrazhdë me ndokënd duke e

rreshtohen rregulla të tjera të shumta.

Pasi kuptuam se trajtimi i drejtë ndaj kundërshtarit duhet të jetë në bazë të rregullave të Sheriatit e assesi mos të jetë i natyrës së hakmarrjes personale, na mbetet që për ta dëshmuar këtë gjë duhet ta bëjmë një ndarje të domosdoshme mes dy etapave në vijim:

Etapë e parë përfshin rregullat që duhen pasur parasysh, atëherë kur të klasifikojmë dikë se i takon atyre që na kundërshtojnë.

Ndërsa **etapë e dytë** përfshin rregullat, të cilat flasin për metodën që duhet ndjekur gjatë trajtimit të atyre që na kundërshtojnë.

Të dy etapat janë me rëndësi dhe shkëlja e bërë në etapën e parë do të reflektohet domosdo negativisht edhe në etapën e dytë. Etapë e parë është temë ne vete dhe ka rregullat e veta por do të përmend vetëm disa rregulla shumë të përgjithshme me të vetmin qëllim që të bindemi se sa e ndjeshme dhe me ndikim është kjo temë dhe se nuk bën të merren me këtë temë përveçse ata që kanë dituri të mjaftueshme për këtë dhe i përmbushin kriteret për t'u marrë me një problematikë të kësaj natyre.

1- Tekfiri i ndokujt qoftë individ apo grup duhet të jetë korrekt, i verifikuar dhe i mbështetur në argumentet e Sheriatit.

Ibën Tejmije thotë: “Meqë pasuesit e të dërguarve janë ithtarët e dijes dhe drejtësisë, atëherë edhe atë që e thonë për jobesimtarët dhe ithtarët e risive të ndryshme ndërtohet mbi dituri dhe drejtësi, larg hamendjeve dhe ndjekjes së epshit.”

Me dituri kemi si qëllim të verifikojmë saktësinë e asaj që thuhet për grupin apo individin e caktuar, ndërsa nuk bën të mjaftohemi me spekulimet apo thashethemet që thuhet për ndokënd,

“Njerëzit kanë prirje që kur janë në mospajtim me dikë, çdo fjalë që del nga kundërshtari mundohen ta mobilizojnë në favor të tyre...”

duke pasur parasysh gjithnjë rregullat mbi të cilat ndërtohet verifikimi i lajmeve dhe i asaj që thuhet rreth një ndodhie të caktuar.

Ndërsa me drejtësi kemi si qëllim përdorimin e peshores sheriatike për gjykimin e ndonjë veprimi të caktuar e ky gjykim assesi mos të jetë i ndërtuar mbi hamendjet dhe pasimin e epshit. Kështu që mos të gjykojmë për një veprim se është kufër apo bidat, përveç kur kemi mbështetje të sigurt për tërë këtë në argumentet e qarta të Sheriatit.

2- Nëse përmes rregullit të lartpërmendur kemi arritur të gjykojmë veprimin e ndonjë grupi apo individi, atëherë nuk bën të nxitojmë që të lidhim mes gjykimit për veprën dhe vepruesit. Me një fjalë nëse nga ndokush buron ndonjë vepër, e cila sipas peshores sheriatike ka marrë gjykimin si “mosbesim” (kufër), atëherë nuk bën që të mjaftohemi me kaq edhe kur vjen puna me individin, kështu që në bazë të gjykimit për veprimin ta shpallim edhe atë të atillë. Dijetarët kanë bërë dallime mes veprës dhe vepruesit, prandaj që i njëjti person nga i cili ka buruar fjala apo vepra e shëmtuar ta marri përsipër emrin e veprës duhet që të plotësohen kushtet e caktuara dhe të evitohen disa pengesa e që të gjitha këto janë përmendur në mënyrë të përkryer në librat përkatës, që janë shkruar për këtë qëllim. Meqë kuptuam renditjen se si e

kanë trajtuar dijetarët tanë këtë temë vijnë kështu tek etapa e dytë, e cila ka të bëjë me qëndrimin që duhet ndjekur kur kemi të bëjmë me ata që na kundërshtojnë.

1- Të zbatuarit e drejtësisë ndaj tyre në çdo rast dhe rrethanë

Ne si muslimanë jemi të detyruar të jemi të drejtë edhe me ata që e mohojnë fenë tonë dhe nuk besojnë besimin tonë, e mos të flasim për ata që pavarësisht dallimeve që kemi mbesin brenda rrethit islam. Për ta kuptuar më drejt këtë që përmendëm mund ta ndajmë në pikat në vijim:

a- Nga shenjat e sjelljes së drejtë ndaj atyre që na kundërshtojnë është që të mundohemi vazhdimisht që fjalët e tyre t'i kuptojmë në mënyrën më të drejtë dhe konform qëllimeve, e jo t'i ngarkojmë ato me kuptime të cilat nuk i mbart teksti apo nuk janë për qëllim. Njerëzit kanë prirje që kur janë në mospajtim me dikë, çdo fjalë që del nga kundërshtari mundohen ta mobilizojnë në favor të tyre, e kjo padyshim që nuk është e drejtë. Ibën Tejmije thotë: "...prej padrejtësive më të mëdha ndaj ndokujt është të vlerësuarit e fjalëve tij se janë gabim, para shqyrtimit të mundësisë së përmirësimit dhe rregullimit të asaj që ka thënë..." El-Fetava-31/114

Nga kjo fjalë kuptojmë se sa herë që kemi mundësi t'i drejtojmë fjalët e ndokujt në kahun e duhur dhe të saktë, atëherë duhet ta bëjmë këtë para se të shpejtojmë me vlerësimin se ajo që ka thënë është gabim. Kjo do të thotë ka mundësi që të është shprehur gabim, por jo edhe qëllimi i tij të jetë gabim, e nëse e vërtetojmë se qëllimi i tij është në pajtim me atë që ka thënë, atëherë mund të vlerësojmë se e ka gabim.

Për ta vërtetuar këtë kuptim që përmenda po sjell edhe një thënie të këtij

dijetari kur flet për disa nga besimtarët, të cilët nga emocionet e tyre kanë gabuar në të shprehur: "...e kjo i ngjan gjendjes së shumë prej adhuruesve të singertë, të cilët ndiejnë përjetime të vërteta dhe arrijnë në një situatë të shëndoshë, por nuk gjen fjalë për ta shprehur prandaj ndodh që të shprehet gabimisht duke mos qenë i tillë edhe qëllimi i tij..." El Fetava 10/698. Prandaj edhe pse personat në fjalë janë nga sufinjtë, nuk bën që vetëm pse janë të atillë neve të mundohemi që çdo fjalë apo veprim që buron prej tyre ta shpallim si të gabuar.

b- Të kemi parasysh tërë veprimtarinë e tij gjatë trajtimit, pra nëse bie fjala të flasim për gabimet dhe devijimet e tij nuk bën të hezitojmë, ngase e kemi detyrim t'i mbrojmë të tjerët nga ky devijim, por në anën tjetër nëse ndonjë vepër e mirë buron nga ai, neve as këtë nuk duhet ta fshehim apo ta mohojmë.

Ibën Tejmije thotë: "...gjithashtu esharijtë (duhen lavdëruar) për kontributin që kanë dhënë në mbrojtjen e fesë nga devijimet e mutezileve, shiitëve apo xhehmijeve dhe për sqarimin e kundërthënieve që ranë në to këta të fundit dhe në anën tjetër për shkak të madhërimit dhe shenjtërimit të Sunetit dhe kuptimit të të parëve ku përmes kësaj përfituan shumë njerëz..." El Fetava 13/97.

Sikurse kanë thënë më herët: "Nëse i miri vjen me një të keqe, atëherë vijnë të mirat me një mijë ndërmjetësues."

c- Të pranojmë të vërtetën, kur buron nga ai që na kundërshton

Ky rregull na jep të kuptojmë se synimi ynë duhet të jetë e vërteta dhe e qëlluara pavarësisht nga kush buron, e nuk bën që të na shtyjë devijimi i ndokujt apo mospajtimi i tij me ne, që të refuzojmë të gjithë atë që vjen nga ai, qoftë kjo sikur të jetë e vërtetë. Allahu i Madhëruar e ka

vërtetuar fjalën e Belkises (mbretëreshës së Jemenit), kur ka dashur ta komentojë para parisë së saj ardhjen e Sulejmanit alejhi selam ku thotë: ***“Ajo tha: “Njëmend, kur mbretërit pushtojnë ndonjë vend, e rrënojnë atë dhe e poshtërojnë parinë e tij. Kështu veprojnë ata.”*** Nemël 34. Dijetarët thonë se këshilla që i jepet parisë këtu buron nga mbretëresha, ndërsa në fund ia ka konfirmuar Allahu i Madhëruar këtë vlerësim të saj duke thënë: ***“Kështu veprojnë ata”***. Dijetari i mirënjohur i tefsirit Muhamed Shinkiti thotë: “...gjatë këtij komentimi të Kuranit do të marrim parasysh fjalët që jemi të bindur se janë të sakta, për shkak se i përkrahin argumentet e assesi nuk do të jemi fanatikë të ndonjë drejtimi (medhhebi) të caktuar, sepse ne shikojmë në thëniet e jo në ata që i thonë ato, dhe jemi të bindur se çdo fjalë e ka mundësinë e pranimit dhe refuzimit përveç fjalëve të të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi te), prandaj e vërteta është e vërtetë edhe kur ai që e flet atë nuk ka ndonjë vlerë. A nuk mjafton për këtë mbretëresha e Jemenit, që ishte adhuruese e diellit së bashku me popullin e saj, posa e tha të vërtetën ia vërtetoi edhe Allahu i Madhëruar thënien, duke mos qenë pengesë mosbesimi i saj për të pranuar të vërtetën kur buronte prej saj.” (Aduaul bejan 1/6).

d- Të bëjmë dallime mes tyre (d.m.th. vepruesve), duke iu shmangur përgjithësimeve dhe duke trajtuar çdo rast të ndarë nga tjetri.

- Kështu p.sh. nëse kemi të bëjmë me të njëjtën kategori d.m.th. kundërshtimi dhe shkella e bërë është e të njëjtit nivel apo lloj, atëherë në këtë rast duhet të kemi parasysh ndarjen në vijim:

a- Nëse personi që ka rënë në këtë vepër është nga njerëzit e thjeshtë, që ka kryer një veprimin të caktuar, si rezultat i

“...Çdo fjalë e ka mundësinë e pranimit dhe refuzimit përveç fjalëve të të Dërguarit (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi te), prandaj e vërteta është e vërtetë edhe kur ai që e flet atë nuk ka ndonjë vlerë...”

imitimit të verbër të ndonjë dijetari apo mjedisit ku ai jeton dhe niveli i tij nuk ia mundëson të interesohet më tepër për të vërtetën apo të ndryshojë atë që e ka gabim, atëherë në këtë rast trajtimi ndaj tij duhet ndryshuar nga kategoritë e tjera në vijim.

b- Ndërsa nëse personi është nga ata që kanë mundësi intelektuale të pyesin dhe të interesohen, por nuk e bëjnë një gjë të tillë për shkak të angazhimit pas përfitimeve të kësaj bote, si fjala vjen, që pasuria apo pozita ta pengojnë nga një gjë e tillë, atëherë ky është më larg se i pari, por jo edhe sa ata në vijim.

c- Tjetri mund të jetë nga ata që e njohin të vërtetën dhe nga ata që i kanë arritur argumente të mjaftueshme, të cilat dëshmojnë për gjykimin e Sheriatit në lidhje me veprimin e tij, por nuk e ndjek argumentin dhe nuk largohet nga veprimi i devijuar për shkaqe të ndryshme për të cilat nuk mund të gjejmë se është i justifikuar fetarisht.

d- Të sillet njësoj si ai para tij, por dallon se ky tashmë, edhe i thërret njerëzit, edhe mundohet t'i bindë, se kuptimi që ai po paraqet është i saktë dhe se kuptimi i Ehli Sunetit nuk është në

pajtim me fenë tonë.

c- Ky i fundit krahas asaj që bën, si ai tjetri para tij ky njëkohësisht, edhe i bën padrejtësi, edhe i persekuton thirrësit e të vërtetës dhe ata që nuk pajtohen me te. Në bazë të këtij dallimi duhet të dallohet edhe qëndrimi ynë ndaj tyre, meqë nuk janë të barabartë në dëmin që shkaktojnë nuk duhet ta kenë dënimin e njëjtë.

- Ndërsa kur kemi të bëjmë me grupet, të cilat dallojnë mes vete në bazë të dallimit të kundërshtimit që kanë bërë, atëherë duke pasur parasysh dallimet e lartpërmendura ia vlen të theksojmë se edhe grupet mes veti dallojnë njëra nga tjetri. Kështu që gjejmë nga dijetarët e mëhershëm, se për disa grupe kanë nxjerrë gjykimin se janë bidatçi (pasues të risive në fe), ndërsa për disa të tjerë kanë gjykuar se janë qafirë (jobesimtarë). Por edhe për ata që kanë gjykuar se janë bidatçi kanë bërë dallime të mëdha mes tyre varësisht nga rreziku i bidatit që e përfaqësojnë.

2- Kundërshtimi nuk i anulon detyrimet që kemi ndaj tij si besimtarë

Nga këto detyrime mund të veçojmë:

Këshillimi dhe përmirësimi i gabimeve

Besimtarët e kanë detyrim të këshillohen mes vete dhe të urdhërojnë për të mirë e të ndalojnë nga e keqja. Në bazë të kësaj motoje nuk bën që kundërshtimi i ndokujt apo mospajtimi me ne të na pengojë që ta këshillojmë me të mirë brenda mundësive dhe rrethanave. Ky këshillim duhet të bëhet në bazë të realizimit të interesave që synon sheriatin në këtë kaptinë, prandaj në bazë të kësaj vlerësohet se: a do të bëhet këshillimi në mënyrë të hapur, si p.sh. përmes ndonjë shkrimi apo fjalimi e kështu me radhë. E nëse rregullat e shariatit vlerësojnë se këshillimi duhet të bëhet sy më sy, atëherë

duhet të mbetet kështu.

Si do që të jetë ne duhet ta dimë, se ky këshillim ndërtohet mbi sinqeritetin dhe dëshirën e mirë për udhëzim e përmirësim e assesi mbi shfryrjen e nevojës për hakmarrje dhe dëmtimin e palës që na kundërshton.

Ibën Tejmije thotë: "...dhe tërë kjo (këshillimi) duhet të jetë për hir të Allahut të Madhëruar, e jo si pasim i epshit si fjala vjen të ketë mes atyre të dyve ndonjë mospajtim rreth çështjeve të kësaj bote, apo të jetë si shkak zilia mes tyre, apo gara për poste, e t'i përmendi të metat e tij kinse ka si qëllim ta këshillojë, ndërsa nga brenda e shtyn urrejtja që ka ndaj tij dhe ndjenja e hakmarrjes, e tërë kjo është nga veprat e shejtanit..." (El Fetava 1/221).

Dhënia e selamit dhe kthimi i tij

Disa njerëz mendojnë se thelbi i raporteve me kundërshtarin është bojkoti dhe ndërprerja e çdo kontakti me te madje edhe të selamit. Dijetarët e mëhershëm kanë folur për hexhrin (bojkotin) dhe e kanë përdorur si mënyrë trajtimi të atyre që i kundërshtojnë, por ajo që duhet të dimë është se ky mjet nuk është trajtuar asnjëherë si rregull bazë që duhet aplikuar gjithnjë në raport me kundërshtarin, por është vënë në funksion atëherë kur është dëshmuar efikasiteti i tij. Dijetari i njohur Ibën Tejmije, kur flet rreth kësaj çështje sqaron se bojkoti varet nga disa rrethana të jashtme në bazë të të cilave konstatohet efikasiteti i tij dhe nëse ky efikasitet nuk i tejkalon dobëtë që realizohen nga braktisja e tij, si fjala vjen shpërblimi dhe dobia që arrihet nga dhënia e selamit, bashkëpunimi në punë të mira etj., atëherë një bojkot i tillë nuk është legjitim.

"Ky bojkot varet nga dallimi mes atyre që bojkotohen në aspektin e fuqisë dhe të dobësisë apo në bazë të të qenit të tyre pakicë apo shumicë. Duhet të dimë se

qëllimi i bojkotit është qortimi i kundërshtarit dhe edukimi i tij, e në anën tjetër pengimi i të tjerëve që të bëhen si ai. Prandaj nëse përmes bojkotit realizohet aspekti i interesit, që kërkohet të arrihet përmes tij, si fjala vjen dobësimi i të keqes apo zhdukja e saj, atëherë në këtë rast një veprim i tillë konsiderohet legjitim. Ndërsa nëse ndodh që mos të përfitohet nga ky bojkot, as i bojkotuari e as të tjerët, përkundrazi kjo të shpie në shtimin e së keqes për shkak se ai që bojkoton është i dobët, atëherë në këtë rast bojkoti nuk është legjitim, madje në këso raste braktisja e bojkotit është më e dobishme për disa njerëz se sa zbatimi i tij.” (El Fetava 28/206).

Falja e namazit pas tij

Në këtë rast nëse kundërshtari është nga besimtarët, sepse me rregullat e mësipërme ne refuzojmë ta nxjerrim nga ky emërtim dhe në anën tjetër i përmbahet rregullave të namazit, atëherë vetëm të qenit e tij kundërshtar, nuk na lejon neve që ta braktisim namazin pas tij. Dijetari i njohur Ebu Xhafer Tahaviu në doracakun e shkruar mbi besimin e Ehli Sunetit thotë: “Ne besojmë se lejohet të falemi pas çdokujt që është pjesëtar i kibles (musliman), qoftë ai i devotshëm apo mëkatar...” (Akide Tahavije 59).

3- Marrja e diturisë nga kundërshtari

Muhamed ibën Sirin thotë: “Me të vërtetë dituria është pjesë e fesë, prandaj shikoni se nga kush po e merrni fenë tuaj.”

Nxënia e dijes nga ata që i kemi klasifikuar si kundërshtarë bëhet e lejuar vetëm kur merren parasysh rregullat vijuese:

Mos të ketë nga Ehli Suneti tjetërkush që merret me shpjegimin e asaj që kemi nevojë për te.

“...Duhet të dimë se qëllimi i bojkotit është qortimi i kundërshtarit dhe edukimi i tij, e në anën tjetër pengimi i të tjerëve që të bëhen si ai...”

Shpjegimi që ai bën mos të jetë i atij lëmi që e kanë kundërshtuar atë, e cila është e njohur si e vërtetë tek Ehli Suneti

Vazhdimisht të jemi në kontakt me ndonjë nga dijetarët e Ehli Sunetit, të cilin do ta konsultojmë kohë pas kohe për atë që jemi duke mësuar.

Ibën Tejmije thotë: “...nëse për realizimin e ndonjë detyrimi, sikurse është kërkimi i diturisë apo xhihadit detyrohemi që t'i bëjmë përmes atij që është i njohur me diçka nga bidatet (risitë), por me kusht që të jenë më pak të dëmshme se dëmi që arrihet me lënien e atij detyrimi, në këtë rast realizimi i atij detyrimi me gjithë dëmin që arrihet (sepse bëhet përmes bidatçiu) do të ishte më në interes dhe më i favorshëm se e kundërta (lënia e atij detyrimi)...” (El Fetava 28/212)

Këtë rregull mund ta përdorim gjatë shqyrtimit të çdo bashkëpunimi mes Ehli Sunetit dhe atyre që i kundërshtojnë. Me kaq po e mbyll këtë temë, duke lënë shumë gjëra pa përmendur. Ajo që dua të kuptohet nga e tëra kjo është se nuk dëshirojmë që askush të jetë kundërshtar i të vërtetës, e nëse ndodh atëherë mos të na shtyjë kjo që të jemi të padrejtë ndaj tyre, por që trajtimi ynë të drejtohet nga rregullat e shariatit, edhe pse një trajtim i tillë mund të bjeri ndesh me interesat dhe dobitë personale të ndokujt prej nesh. ■

DASMAT ME HARAME

Pra, nëse dikush ftohet të marri pjesë në një dasmë, apo në ndonjë gosti tjetër, mirëpo në atë gosti interpretohen këngë të ndaluara, përdoren instrumente muzikore apo bëhet ndonjë e keqe tjetër. Kush është dispozita e shariatit për këtë?

FEHD IBËN AHMED SELAME

Gjatë kohëve të pushimit po shpeshtohen pyetjet për dispozitën e pranisë nëpër gosti të ndryshme, të cilat përmbajnë në vetvete edhe të këqija. Shumë besimtarë ngushtohen të marrin pjesë në ato gosti, vetë apo me familjen e tij. Në këtë studim të shkurtër do të përmend dispozitën e shariatit për këtë çështje, duke përmendur mendimet divergjente, argumentet dhe mendimin më të vërtetë. E lus Allahun të japë dobi nga kjo.

¹ Buhariu nr. 5174



Pra, nëse dikush ftohet të marri pjesë në një dasmë, apo në ndonjë gosti tjetër, mirëpo në atë gosti interpretohen këngë të ndaluara, përdoren instrumente muzikore apo bëhet ndonjë e keqe tjetër. Kush është dispozita e shariatit për këtë?

Përgjigjja e ftesave dhe prania në to është gjë e urdhëruar, pasi kjo ndikon në afrimin e zemrave të besimtarëve. Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: “*Lironi robërit, përgjigjuni ftesave dhe vizitoni të sëmurin*”.¹

Ftesat bëhen për dasma apo për gosti tjera. Sa i përket dasmave: mendimi më i njohur i dijetarëve dhe më i vërteti është se përgjigjja ndaj këtyre ftesave është

detyrim për secilin nëse ftesa është me emër dhe mbiemër, përveç nëse ka ndonjë arsye. Mirëpo, nëse ftesa është e përgjithshme dhe jo me emër konkret, atëherë përgjigja nuk është e detyrueshme. Argument për këtë janë hadithet e vërteta për këtë temë, sikurse: “Kur të ftohet ndonjëri në gosti, le të shkojë”², apo: “Kur të ftohet ndonjëri në një gosti martese, le të përgjigjet”³.

Këto dy hadithe janë urdhra të qartë se përgjigja ndaj ftesës për dasmë është detyrim (vaxhib), sepse çdo urdhër është detyrim përderisa nuk ka ndonjë argument tjetër që e ndryshon këtë gjendje. Ndërsa përgjigja e ftesave për në gosti të tjera është e pëlqyeshme (mustehab) sipas mendimit të shumicës së dijetarëve.

Përgjigja ndaj ftesës lidhet ngushtë me atë, nëse në atë gosti nuk gjendet ndonjë e keqe që dëgjohet apo shihet. A nëse ka ndonjë të keqe, atëherë kemi dy situata:

E para: Të ketë mundësi ta largojë atë të keqe. Në këtë rast është e detyrueshme të shkojë, për dy çështje: t’i përgjigjet ftesës dhe të largojë një të keqe.⁴

E dyta: Të mos ketë mundësi ta largojë atë të keqe. Në këtë rast i ftuari mund ta dijë se do të ndeshet me këtë të keqe, por mundet edhe të mos e dijë.

Nëse paraprakisht e di se do të ndeshet me këtë të keqe dhe njëkohësisht e di se nuk ka mundësi ta largojë atë, dijetarët kanë dy mendime:

Mendimi i parë: E ka të ndaluar të

“...Rregulli i sheriatit thotë:
“Largimi i dëmeve ka
përparësi ndaj sjelljes së të
mirave” ...”

shkojë në atë gosti. Ky është mendimi i shumicës së dijetarëve hanefi⁵ e maliki⁶, mendimi më i fortë i shafijve⁷ dhe ky është mendimi i hanbelive⁸.

Është haram, sepse me praninë e tij, ai manifeston pëlqimin e të keqes⁹, ndërsa Allahu i Madhëruar ka thënë: “*Ai jua ka shpallur në Libër: Kur të dëgjoni se mohohen fjalët e Allahut dhe bëhet tallje me to, atëherë mos rrini me ata* (njerëz që veprojnë kështu), *derisa të ndërrojnë bisedë, përndryshe do të ishit si ata. Allahu do t’i tubojë në Xhehenem të gjithë hipokritët dhe mohuesit*”. (Nisa 140). Domethënia e këtij ajeti është se ai që është në një ndejë ku bëhet haram urdhërohet të largohet nga ajo ndejë, prandaj apriori nënkuptohet ndalesa për të shkuar në një ndejë ku bëhet haram.

Mendimi i dytë: Lejohet të shkojë në atë gosti dhe detyrohet të bëjë vërejtjet e tij me aq sa ka mundësi. Ky është një prej mendimeve të medhhebit shafi¹⁰, ndërsa arsyetimi i tyre është: Prania e këtij personi mund të ndikojë në largimin e të keqes.¹¹

² Buhariu nr. 5173; Muslimi nr. 1429

³ Muslimi nr. 1429

⁴ Bedaiu Sanai (6/512), Mugnil Muhtaxh (3/247), El-Mugni (10/198)

⁵ Bedaiu Sanai (6/513), Tebjinul Hakaik (13/6)

⁶ Sherhul Kebir ue hashijetu Desuki alejhi (2/337)

⁷ El-Havil Kebir (9/536)

⁸ El-Mugni (10/198)

⁹ Mugnil Muhtaxh (3/247)

¹⁰ El-Havil Kebir (9/536)

¹¹ Ibid

Debati ndaj këtij mendimi:

Nëse me ‘vërejtjet sipas mundësive’ kanë si qëllim vërejtjen me zemër kur nuk ka mundësi me gojë dhe pastaj të ulet me ta, kjo situatë është e papranueshme, sepse të ndenjurit me ta nuk do të ndryshojë asgjë, përkundrazi vetëm do të shtojë numrin e keqbërësve, ndërsa ky person ka mundësi të largohet nga aty.

Nëse kanë si qëllim shprehjen e vërejtjeve me gojë dhe pastaj të ulet me ta, gjithashtu është e papranueshme, sepse dihet mirëfilli se pas qortimit të së keqes nuk rrihet me të keqen, ngase të ndenjurit me ta nënkupton pëlqimin e veprës së tyre.

Ndërsa fjala e tyre: Prania e këtij personi mund të ndikojë në largimin e të keqes: Nëse me praninë e tij nënkuptojnë të ndenjurit me ta, kjo është e papranueshme, sepse është supozim, ndaj nuk pranohet. Meqë prania e personit duke qenë i bindur se nuk ka mundësi ta largojë të keqen është vetëm shtim i numrit të keqbërësve. Rregulli i sheriatit thotë: **“Largimi i dëmeve ka përparësi ndaj sjelljes së të mirave”**, pra: largimi nga dëmi i dëgjimit të haramit duke mos iu përgjigjur ftesës ka përparësi ndaj dobisë së përgjigjes së ftesës.

E nëse me praninë e tij kanë si qëllim, që ai ta ndalojë të keqen sipas mundësisë dhe nëse nuk ka mundësi ta largojë, atëherë largohet vetë nga ajo ndejë, kjo është e pranueshme, sepse muslimani është i urdhëruar ta ndalojë të keqen me aq sa ka mundësi.

Cili është mendimi i vërtetë?

Mendimi më i vërtetë në këtë çështje – Allahu e di më së miri – është se i ftuari është i lirë të zgjedhë mes: të mos shkojë

fare në këso gostish ose të shkojë për ta kundërshtuar këtë të keqe sipas mundësive. Nëse keqbërësit heqin dorë nga e keqja dhe e largojnë, atëherë mund të rrijë me ta sepse ashtu i përgjigjet ftesës, mirëpo ama nëse ata nuk largohen nga e keqja, atëherë ky duhet të largohet nga ata.

Kurse të ndenjurit me ta, kur ata nuk largohen nga e keqja nuk lejohet për shkak të ajetit të sipërpërmendur dhe për shkak të hadithit, ku Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: *“Dobësia e parë që filloi te Beni Israilët ishte: Njeriu takonte njeriun dhe i thoshte: o filan, ki frikë Allahun dhe largohu nga kjo që po bën, sepse nuk e ke të lejuar. Mirëpo të nesërmen kur e takonte, nuk i prishte punë të hajë, të pijë dhe të rrijë së bashku. Kur e bënë këtë, zemrat e tyre Allahu i bëri njësoj. Pasi lexoi disa ajete tha: Gjithsesi, pasha Allahun, ose do të urdhëroni në të mira, do të ndaloni të këqijat, do ta pengoni zullumqarin dhe do ta ktheni tek e drejta e nuk do ta lejoni të dalë nga ajo, ose zemrat tuaja Allahu do t’i bëjë njësoj dhe do t’ju mallkojë siç i mallkoi”*.¹²

Ky hadith na mëson qartësisht detyrimin e urdhërimit në të mirë dhe ndalimit nga e keqja si dhe detyrimin e bojkotimit të gjynahqarëve, nëse nuk largohen nga gjynahu. **Mirëpo nëse shkon në gosti duke mos e ditur se ka të këqija dhe befasohet kur e sheh atë, ai detyrohet të shprehi keqardhjen dhe ta largojë atë sipas mundësive. Por nëse nuk ka mundësi ta largojë, a i lejohet të rrijë në atë ndejë ose jo?**

Për këtë çështje dijetarët kanë tre mendime:

Mendimi i parë: Në çastin që e dëgjon të

¹² Daif Sunen Ibën Maxhe fq. 322

keqen, ai duhet të largohet nga ajo ndejë. Ky është mendimi i malikive¹³, shafive¹⁴ dhe hanbelive¹⁵. Për këtë kanë disa argumente:

1. Ajeti: ***“Ai jua ka shpallur në Libër: Kur të dëgjoni se mohohen fjalët e Allahut dhe bëhet tallje me to, atëherë mos rrini me ata (njerëz që veprojnë kështu), derisa të ndërrojnë bisedë, përndryshe do të ishit si ata.”*** (Nisa 140). Abdurrahman Sadiu thotë: Nga kjo kuptohet, se ai që shkon në një ndejë ku bëhet gjynah ndaj Allahut detyrohet të qortojë sipas mundësive, ose të largohet që aty nëse nuk ka mundësi të qortojë”.¹⁶

2. Rasti i përcjellë nga Sefineja, Allahu goftë i kënaqur me te, se Aliu radijallahu anhu, kishte ftuar një njeri dhe kishte përgatitur ushqim për të. Fatimja tha: Sikur ta kishim ftuar edhe Pejgamberin, *sal-lallahu alejhi ue selem*, që të hante me ne! Dhe e ftuan. Kur erdhi, posa mori për ta hapur derën ai pa një pëlhurë, që e kishin vendosur në një pjesë të shtëpisë dhe u kthye. Fatimja i tha Aliut: Shko pas tij dhe mëso çfarë e ktheu. Ai shkoi pas tij dhe e pyeti: O i Dërguar i Allahut, çfarë të ktheu? ***Nuk më ka hije mua – apo një pejgamberi – të hyjë në një shtëpi të zbukuruar me vizatime – u përgjigj ai.***¹⁷

Pasi Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, u kthye nga vendi ku ishte ftuar për shkak të një të keqe që shihet kjo na mëson, se i ftuari duhet të largohet nga vendi ku sheh një të keqe. E njëjta gjë vlen edhe për të këqijat që dëgjohen.¹⁸

4. Rastin që na e përcjell Nafiu: Ibën Omeri dëgjoi një zë zamareje dhe vendoi gishtat në vesh, pastaj u largua nga rruga dhe më tha: “O Nafi, tani a dëgjohet gjë? Jo

“... Ibën Omeri dëgjoi një zë zamareje dhe vendoi gishtat në vesh, pastaj u largua nga rruga dhe më tha: “O Nafi, tani a dëgjohet gjë? Jo – i thashë. Atëherë i hoqi gishtat prej veshëve...”

– i thashë. Atëherë i hoqi gishtat prej veshëve dhe tha: Kam qenë me Pejgamberin, *sal-lallahu alejhi ue selem*, dhe ai dëgjoi diçka të atillë dhe veproi kësisoj”.¹⁹

Këtu shohim se si Abullahu, djali i Omerit ishte larguar nga rruga ku dëgjohej zëri i zamares derisa humbi ai zë, e pastaj i hoqi gishtat prej veshëve dhe tregoi se ky është udhëzimi i Pejgamberit, *sal-lallahu alejhi ue selem*. Kjo na mëson se ai që dëgjon një të keqe duhet të largohet nga ai vend.

Mendimi i dytë: Lejohet të rrijë në atë ndejë, nëse është nga personat që nuk janë shëmbëlltyrë për të tjerët, ndërsa detyrohet ta braktisë atë ndejë, nëse është nga personat që janë shëmbëlltyrë për të tjerët. Këtë mendim e përkrahë Ebu Hanife dhe nxënësit e tij.²⁰ Argumentimi i tyre është: Përgjigjja ndaj ftesës është sunet dhe kjo nuk lihet për shkak të një gjynahu që e bën tjetri, sikurse namazi i xhenazes, ai është vaxhib të falet edhe nëse aty është e pranishme ndonjë vajtuuese.²¹

¹³ Mevahibul Xhelil (5/243)

¹⁴ El-Havil Kebir (9/563)

¹⁵ El-Mugni (10/198)

¹⁶ Tejsirul Kerimi Rrahman fi tefsiri kelamil Menan fq. 173

¹⁷ Sahih Sunen Ibën Maxhe 2/238

¹⁸ Aunul Mabud 10/163

¹⁹ Sahih. Tahrimu Alati Tarb fq. 117

²⁰ Bedaiu Sanai (6/513)

²¹ Ibid

Debati ndaj argumentit të tyre:

Argumentit të tyre i themi: Namazi i xhenazes është i domosdoshëm dhe braktisja e tij sjell dëme, ndërsa braktisja e ndejave ku ka harame nuk sjell dëme, përkundrazi qëndrimi në ato ndeja sjell dëme. Prandaj ky krahasim nuk është i drejtë, sepse është krahasim mes gjërave aspak të ngjashme.

Mendimi i tretë: Lejohet të rrijë në atë ndejë përderisa nuk ka shkuar me qëllim që ta dëgjojë haramin. Këtë mendim e përkrahin disa shafi, disa të tjerë e thonë këtë në rast se është e pamundshme dalja nga objekti, si fjala vjen të jetë gjatë natës dhe ai frikësohet të dalë etj.²²

Argumentet e tyre janë:

1. Rasti, të cilin na e përcjell Nafiu: Ibën Omeri dëgjoi një zë zamareje dhe vendoi gishtat në vesh, pastaj u largua nga rruga dhe më tha: “O Nafi, tani a dëgjon diçka? Jo – i thashë. Atëherë ai i hoqi gishtat prej veshëve dhe tha: Kam qenë me Pejgamberin, *sal-lallahu alejhi ue selem*, kur ai dëgjoi një diçka të tillë dhe veproji kështu”.

Ata thonë: Përderisa Ibën Omeri nuk e qortoi Nafiun, i cili vazhdoi ta dëgjojë zërin e zamares d.m.th., se nuk ka asnjë të keqe nëse nuk e bën këtë me qëllim. Kjo kundërshtohet me faktin se Ibën Omeri u largua nga rruga së bashku me Nafiun dhe kjo aludon që në rast se dëgjohej një haram duhet ndërruar rrugën.

2. Argument me krahasim. Këta thonë: Nëse një njeri është në shtëpinë e tij dhe dëgjon ndonjë prej zërave të ndaluar nga komshiu i tij, zë të cilin nuk mund ta ndalojë, ai me siguri nuk duhet të dalë nga shtëpia e tij, prandaj edhe në këtë rast nuk detyrohet të largohet nga kjo ndejë, sepse nuk është duke e bërë këtë me qëllim.²³

Ky argumentim kundërshtohet:

²² Elhavi Kebir (9/563)

²³ Ibid

Krahasimi nuk është i vërtetë, sepse po bëhet mes dy gjërave aspak të njëjta. Dalja prej ndejave ku bëhet një haram është e lehtë dhe pa ndonjë dëmtim, ndërsa dalja prej shtëpisë personale është e rëndë dhe me shumë dëmtim, prandaj krahasimi nuk është i drejtë.

Cili është mendimi i vërtetë?

Mendimi më i vërtetë në këtë çështje është mendimi i parë, i cili thotë se largimi nga ndeja e ftesës, ku keqbërësit nuk heqin dorë nga e keqja pas vërejtjeve të bëra ndaj tyre është detyrim (vaxhib). Është mendim i vërtetë për shkak të argumenteve të forta, që u përmendën dhe për shkak të ndalesës nga të ndenjurit me ata që bëjnë mëkate haptazi.

Një fetva nga Komisioni i Përhershëm për Fetva që ka të bëjë me këtë temë:

Pyetje: Dasmat në ditët e sotme po bëhen nëpër pallate dhe aty po bëhen ca gjynahe që edhe ju i dini. Unë nuk i pëlqej aspak, prandaj e kam ndaluar edhe familjen time të shkojë, edhe pse ata kanë shumë dëshirë të shkojnë nëpër ato pallate dhe të shohin martesat. A të vazhdoj t'i ndaloj apo t'i lejoj, por të mos kem gjynah?

Përgjigja: Nëse dasma e martesës përmban harame, sikurse: përzierja burra-gra, muzika etj., atëherë nuk të lejohet t'ia mundësosh familjes të shkojë aty. E nëse në atë dasmë nuk ka ndonjë haram, atëherë mund t'i japësh leje familjes që të shkojë në këto lloj dasmash. Duhet ditur se përdorimi i deficit në dasma nga ana e grave nuk është e ndaluar, nëse aty nuk ka burra. Allahu dhëntë suksese.²⁴ ■

Nga arabishtja: Omer BERISHA

²⁴ Fetvatë e Komisionit të Përhershëm për Fetva, vëll. 19, faqe 96.



A JE FLEKSIBËL AQ SA DUHET?

Çdo gjë në këtë botë është relative. Veprat e njerëzve karakterizohen me mangësi dhe të meta. Ai që nuk zotëron fleksibilitetin e duhur për jetën do të ketë frikë nga çdo gjë e re, nuk do të fillojë të bëjë asnjë punë të dobishme

PËRGATITI: AGRON TERZIQI

Gjëja më keqe që mund të të ndodhë është entuziazmi i madh pas leximit të kësaj rubrike apo dhe shkrimeve të ngjashme, të cilat zgjojnë ambicien dhe të nxisin në veprim, e që më pas të dobësohesh dalëngadalë, të të kaplojë plogështia dhe të të çrregullohet perceptimi, duke mos pasur më forcë që t'i

shohësh objektivat dhe në fund të gjitha këto t'i marri era.

Entuziazmi i tepërt mund të shkaktojë lodhje, rraskapitje dhe dëshpërim, nëse nuk je sa duhet fleksibël, nëse nuk e ke parasysh se jeta është plot me befasi të pakëndshme dhe se gjërat shpesh mund të marrin rrjedhë të kundërt nga çfarë ke planifikuar.

Vrazhdësia dhe kokëfortësia janë disa prej shkaqeve të dështimit në realizimin e

synimeve, madje ato shpeshherë çojnë edhe në dëshpërim e kapitje.

Mos kërko përsosmëri

Të gjitha planet pavarësisht se sa janë të ndërlikuara dhe të studiuara mirë në fund kanë mundësi që të dështojnë. Njëra prej arsyeve të mossuksesit në të shumtën e rasteve mund të jetë edhe mospasja në konsideratë e përdorimit të fleksibilitetit, duke mos lënë fare hapësirë për befasi, transformime ose ndryshime të papritura.

Kërkimi i përsosmërisë të shkakton shumë probleme, sepse ti nuk ndërmerr asnjë iniciativë pa u siguruar se do të kesh sukses, megjithëse kjo është e pamundur!!! Po që se ndodh të fillosh ndonjë punë do të jesh i kënaqur vetëm nëse e përsos atë, edhe kjo është prapë diçka e pamundur. Me këtë koncept do të mbetesh gjithmonë skeptik dhe i pavendosur për shumë projekte, do t'i druhash dështimit, sepse çdo rezultat yti që nuk është i përkryer do ta konsiderosh si një lloj falimentimi, e kjo është si pasojë e kriterëve të tua të paarsyeshme.

Çdo gjë në këtë botë është relative. Veprat e njerëzve karakterizohen me mangësi dhe të meta. Ai që nuk zotëron fleksibilitetin e duhur për jetën do të ketë frikë nga çdo gjë e re, nuk do të fillojë të bëjë asnjë punë të dobishme dhe sukseset e tij do të mund të numërohen me gishtat e dorës. Ndërsa je duke jetuar në një botë jo të përsosur, me njerëz jo të përsosur dhe në një rreth jo të përkryer mos kërko përsosmëri nga vetja.

Përpiqu t'i shohësh nuancat

Bota është plot me ngjyra, të cilat ia shtojnë asaj bukurinë dhe hijeshinë. Përpiqu që të shikosh me të gjitha ngjyrat e ylberit dhe mos u kufizo vetëm në dy, të zezë dhe të bardhë. Nuk është çdo send në

“...Kërkimi i përsosmërisë të shkakton shumë probleme, sepse ti nuk ndërmerr asnjë iniciativë pa u siguruar se do të kesh sukses, megjithëse kjo është e pamundur!!! ...”

këtë botë i mirë dhe i keq, i vërtet dhe i rrejtshëm, i saktë dhe i gabuar... mirëpo ekzistojnë shumë nivele në mes këtyre dy ekstremeve. Mosrealizimi i plotë i objektivave të tua nuk do të thotë doemos dështim. Mosarritja në kohën e duhur aty ku synon nuk nënkupton se nuk ke mbërritur fare. Paraqitja e pengesave dhe problemeve gjatë realizimit të planit tënd nuk është e barazvlefshme me joefikasitet. Një fjalë e urtë popullore thotë: “Të jesh breshkë në rrugë të saktë është më mirë, se sa të jesh leopard në rrugë të gabuar.”

Këtu nuk bëj vetëm thirrje që t'i shihni nuancat në mes të ngjyrës së zezë dhe të bardhë, por t'i shihni të gjitha ngjyrat e bukura të ylberit duke parë alternativat e ndryshme, prurjet kreative dhe zgjidhjet origjinale.

Nëse të godet ndonjë problem, bëj diçka ndryshe

Tregohet se një herë kur astronautët amerikanë po kalonin orbitën e Tokës gjatë një udhëtimi në kozmos u ndodhi një problem, stilolapsat e tyre nuk shkruanin dot. Amerikanët formuan një qendër speciale të hulumtimit lidhur me këtë problematikë. Pas një kohe ata arritën me sukses të zbulojnë një stilolaps, i cili shkruan në kozmos, nën thellësi të madhe të detit dhe në të gjitha sipërfaqet. Kjo shpikje u kushtoi atyre miliona dollarë

“Të jesh breshkë në rrugë të saktë është më mirë, se sa të jesh leopard në rrugë të gabuar.” ...”

dhe normalisht se mburreshin me këtë zbulim. Në anën tjetër astronautët rusë e zgjidhën këtë problematikë në mënyrë shumë të thjeshtë dhe interesante që shkencëtarëve amerikanë fare nuk u kishte shkuar ndër mend. Ata përdorën një laps të thjeshtë grafik, ndërsa ky zbulim nuk u kushtoi atyre, as mund, as para.

Vëreni se zgjidhja e shumë problemeve është shumë më e lehtë se sa ju mund të mendoni.

Mos i druaj dështimit

Ajo çfarë i pengon shumicën e njerëzve dhe i ndalon të ndërmarrin diçka është frika nga dështimi. Një njeri i tillë sa herë që mediton për të ardhmen që synon ta arrijë, në imagjinatën e tij shfaqen imazhet e dështimit dhe frikës, se mos vendimet e tij janë të gabuara. Kështu ai automatikisht heq dorë nga ndërmarrja e çfarëdo hapi që mund ta çojë atë drejt një dështimi, duke u druajtur pa ndonjë arsye të justifikuar.

Është shumë e vërtetë, se suksesi vjen si rrjedhojë e vendimeve të qëlluara, mirëpo kjo shkallë arrihet vetëm si rezultat i një përvoje, e cila shpeshherë është e shoqëruar me vendime të gabuara. A nuk e ke vërejtur se gabimi njerëzit e suksesshëm i ka shpënë tek suksesi, ndërsa dështakët drejt ngurrimit, frikës dhe nganjëherë në bllokim të plotë. Frika nga dështimi nuk do të pengojë vetëm nga

nisja e realizimit të projektit tënd, por mund të të shfaqet sa herë që paraqitet para teje ndonjë pengesë, që duhet të ndërmarrësh ndonjë vendim që ta largosh atë për të vazhduar rrugëtimin tënd.

Një dijetar thotë: “Do ta gjejmë rrugën ose do të ndërtojmë një të re.”

Përgatitu të përballësh shumë pengesa

Gabon ai që mendon se jeta është gjithmonë e bukur. Kur dëshpërimi dhe mendimi negativ arrijnë ta pushtojnë mendjen, në jetë do të gesh vetëm pikëllim dhe mjerim. Dallimi ndërmjet fitimtarit dhe humbësit është se i pari zotëron një projekt për jetën dhe i sheh sukseset, ndërsa dështaku ka vetëm premtime, shpresa dhe sheh vetëm anën e errët të gjërave.

Sa herë ke vendosur të ndryshosh jetën tënde, duke filluar me një seriozitet të madh, mirëpo për një kohë shumë të shkurtër ke ngecur dhe je ndalur së vepruari, duke u kthyer në të njëjtën gjendje siç ishe në fillim? Por mos u brengos se nuk je i vetmi. Realisht, në çdo fillim gjërat rrjedhin në këtë mënyrë. Është shumë e natyrshme që uni të përzgjedhë rrugën më të lehtë, sepse kështu është i adaptuar. Vetëm të menduarit nuk mjafton që t'i ndryshosh veset dhe shprehitë e rrënjësura thellë në personalitetin tënd. Ti duhet patjetër të përpiqesh, të këmbëngulësh dhe ta stërvitësh veten derisa t'i largosh ato dhe t'i zëvendësosh me virtyte dhe sjellje të mira.

Kjo nuk do të thotë se për të arritur këtë duhet patjetër ta rraskapitesh dhe ta dhunosh veten. Mënyra më e mirë për t'i ndryshuar shprehitë është që gjatë këtij procesi të argëtohesh aq sa ke mundësi.

Ai që i fiton një milion euro në vit nuk

punon 1000 herë më shumë se ai që fiton një mijë euro në vit, ngase vetëm munda nuk mjafton, por duhet gjetur puna e duhur, e cila është e shoqëruar me kënaqësi dhe veprim.

Suksesi është udhëtim që fillon nga shpresa drejt synimit. Detyra jote është që ta bësh këtë udhëtim të këndshëm që me dëshirën më të madhe do ta përsëritësh prapë.

Imagjino veten duke luajtur një sport dhe kënaqesh me ushtrimin e këtij sporti, edhe nëse e humb ti je fituesi, ndërsa kundërshtari yt konsiderohet humbës edhe në qoftë se e ka fituar rezultatin.

Llogarit veten për çdo mbrëmje

Është shprehur shumë e mirë nëse i rezervon orarit ditor një gjysmë ore para se të shtrihesh në shtrat, që të kontrollosh hartën tënde, të bësh bilancin e arritjeve të ditës dhe të vendosësh detyrat për të nesërmen. Kjo është një shprehje e thjeshtë, por që të ndihmon në administrimin e kohës, orientimin e mendit dhe rrjedhën e aktiviteteve të tua në drejtimin e duhur. Të gjitha këto japin një kontribut të madh për objektivat e tua.

A mbështetesh tek Allahu, apo tek vetja?

Është një gjë shumë e bukur që të angazhohemi dhe t'i shfrytëzojmë shkaqet duke respektuar fjalën e të Dërguarit të Allahut, që na thotë: *“Po qe se ju do të mbështeteshit tek Allahu plotësisht, Ai do t’ju furnizonte juve ashtu siç i furnizon shpezët, të cilat gdhijnë të uritura dhe ngrysen (kthehen) të ngopura.”* (Ahmedi dhe Tirmidhiu). Njeriu në këtë botë nuk mund të arrijë asgjë, nëse mbështetet vetëm në aftësitë e tij personale. Allahu nëse dëshiron diçka e përgatit terrenin

dhe ia lehtëson kujtdo prej robërve të tij, që ta arrijë atë synim.

Ligjet e Zotit në natyrë janë triumfuese

Ligjet e Zotit përmbajnë në vetvete, që të gjitha rezultatet të kenë parakushtet e tyre, që duhen plotësuar dhe që pasojat të kenë shkaktarët e tyre. Shënohet se Omeri, Allahu qoftë i kënaqur me të, në kohën kur kolera u përhap në një vend dha urdhër që të mos hyhet aty dhe e gjithë ushtria muslimane u kthye. Disa nuk e pëlqyen këtë vendim të Omerit dhe i thanë: “A je duke ikur nga caktimit të Zotit (kaderit), o udhëheqës i muslimanëve? Tha po: “Jam duke ikur nga një caktim i Allahut drejt një caktimi tjetër të Tij.”

Mos u dëshpëro

Mbështetja tek Allahu dhe ndërmarrja e shkaqeve që të çojnë drejt suksesit është adhurim ndaj Zotit. I Dërguari thotë: *“Aspiro gjëra që të sjellin dobi, mbështetu tek Allahu dhe mos u bëj neglizhent. Nëse të godet diçka mos thuaj sikur të kisha bërë kështu do të bëhej ashtu, mirëpo thuaj: Allahu e ka caktuar dhe çfarë ka dashur ka vepruar, ngase fjala sikur e nxit cytjen e shejtanit.”* (Tirmidhiu).

Nëse nuk realizohet ajo çfarë synon dhe të tradhton fati edhe përkundër asaj se i ke ndërmarrë të gjitha shkaqet e suksesit, ti duhet të mbetesh i kënaqur me veten, sepse ti e di që kjo është dëshira e Allahut, që ka caktuar për ty. Ai është më i ditur për ty sesa ti për veten tënde. Ajo çfarë Ai ka zgjedhur për ty është shumë më e mirë, se ajo çfarë ke zgjedhur ti për veten tënde.

Allahu në Kuranin Famëlartë thotë: *“Mos u tregoni të dobët në ndjekjen e*

“...Kjo nuk do të thotë se për të arritur këtë duhet patjetër ta rraskapitesh dhe ta dhunosh veten. Mënyra më e mirë për t’i ndryshuar shprehitë është që gjatë këtij procesi të argëtohesh aq sa ke mundësi... ”

jobesimtarëve! Nëse ndjeni dhembje prej luftës, edhe ata ndiejnë dhimbje ashtu si edhe ju. Mirëpo ju shpresoni prej Allahut atë që ata nuk e shpresojnë. Allahu është i Gjithëdijshtëm dhe i Urtë.” (Nisa, 114) Besimtari nuk i vlerëson gjërat nga forma e jashtme, mirëpo beson në fjalët e Krijuesit: **“Ju mund ta urreni një gjë, ndërkohë që ajo është e mirë për ju; e ju mund ta doni një gjë, ndërkohë që ajo është e dëmshme për ju. Allahu di, kurse ju nuk dini.”** (Bekare, 216).

Besimtari e di se do të shpërblehet në të gjitha rastet. Nëse i ndodh ndonjë gjë e mirë e falënderon Allahun dhe kjo është hair për të, ndërsa nëse e godet ndonjë e pakëndshme duron edhe kjo është e mirë për te.

A e di duanë e namazit të Istihares

Para se të fillosh atë që synon ta arrish së pari fal dy rekate namaz vullnetar e më pas thuaj:

Allahume ini estehiruke bi ilmike ue estakdiruke bi kudretike ue eseluqe min fadlikel Adhim. Fe ineke takdiru ue la akdir, ue talemu ue la alem, ue ente al-

lamul gujub. Allahume in kunte talemu ene hadhel emre hajrun li, fi dini ue meashi ue akibeti emri ue axhilihi ue axhilih, fakdirhu li ue jesirhu li thume barik li fih. Ue in kunte talemu ene hadhel emre sherun li, fi dini ue meashi ue akibeti emri ue axhilihi ue axhilih, fasrifhu ani uasrifni anhu uakdir lije hajre hajthu kane thume erdini bih.

“O Zoti im, me diturinë Tënde kërkoj mbarësi. Kërkoj ndihmë prej fuqisë Sate; kërkoj nga të mirat e Tua të shumta, sepse Ti ke mundësi, kurse unë s’kam mundësi, Ti di çdo gjë, kurse unë nuk di, Ti je Ai që i di të fshehtat. O Zot nëse kjo punë e imja (dhe e përmend atë) është e dobishme për fenë time dhe jetën time, për kohën e tashme dhe të ardhmen, ma mundëso realizimin e saj, ma lehtëso mua këtë dhe më beko me të. E nëse kjo punë është e dëmshme për fenë dhe jetën time, për kohën e tashme dhe të ardhmen, largoje këtë nga unë dhe më largo mua nga kjo e më përcakto mirësinë (mbarësinë) kudo që të jetë dhe më bëj të jem i kënaqur me të.” (Fikhu i Duave)

Shumica e muslimanëve e falin namazin e istihares dhe e bëjnë këtë dua vetëm atëherë kur merakosen për ndonjë punë, janë në dyshim dhe nuk e dinë përfundimin e saj. Mirëpo realisht kjo është një kërkesë dhe lutje ndaj Allahut, që ta bëjë të mbarë atë punë që dëshiron besimtari ta ndërmarrë, për këtë arsye mos-ngurrimi për të filluar atë punë është parësor, t’i drejtoheni Allahut me namaz dhe lutje dhe pastaj t’i mbështeteni me ngulm dhe angazhim serioz. ■

SHOKËT E ANIJES

(BISEDË E NJË PRINDI ME FËMIJËT E TIJ)

SHADI FAKIH

Dielli filloi të perëndojë, në horizont filluan të shfaqeshin shirita të zinj, të cilët tregonin se nata tanimë kishte ardhur dhe po i hapte rrugën hënës dhe yjeve. Në këtë moment Ibrahimimi po bëhej gati për uljen e mbrëmjes me babanë. Babai i tij për çdo mbrëmje i tregonte ndonjë histori të bukur nga hadithet e Profetit Muhamed *sal-lallahu alejhi ue selem*.

Ibrahimimi: Fatime ku je?

Fatimja: Jam këtu tani sapo mbarova së faluri namazin.

Ibrahimimi: Unë sot jam shumë i lumtur.

Fatimja: Përse vëlla?

Ibrahimimi: Sot dy djem po ziheshin në shkollë me njëri-tjetrin dhe për pak sa nuk u rrahën, porse unë ndërhyra dhe i pengova që të rriheshin dhe kështu që i kam ndaluar ata nga një e keqe.

Fatimja: Por vëlla a nuk e di ti, se urdhërimi për mirë dhe ndalimi nga e keqja ka disa kushte?

Ibrahimimi: Vërtet! Po cilat janë këto kushte?

Fatimja: Duhet patjetër që të kesh dije në lidhje me atë që urdhëron apo ndalon, si fjala vjen të kesh dijeni rreth të lejuarës dhe të

ndaluarës.

Ibrahimimi: Po kushti i dytë?

Fatimja: Të jesh i bindur se do të ndikosh tek të tjerët, përndryshe nëse e ke të qartë se ndalimi nga një e keqe të çon në një të keqe më të madhe, atëherë duhet të gjesh një kohë, apo mënyrë tjetër për ndalimin nga kjo e keqe.

Ibrahimimi: Po kushti i tretë?

Fatimja: Të mos bëhet një gjë e tillë shkak për dëmtimin tënd, si të vihesh në rrezik për jetën dhe e katërta: të jetë në mënyrë të studiuar.

Ibrahimimi: Shkëlqyeshëm, po ku i ke mësuar ti të gjitha këto.

Fatimja: Unë studioj dhe lexoj shumë.

- Kur ja papritur hyri babai dhe ua ndërpreu bisedën atyre.

Babai: Selamu alejkum, vogëlushët e mi.

Fëmijët: ue alejkum selam babi.

Babai: Për çfarë po bisedonit?

Ibrahimimi: Po bisedonim rreth thirrjes për të mirë dhe ndalimit nga e keqja dhe Fatimja po më tregonte kushtet e kësaj vepre të madhe.

Babai: Shumë mirë. Si mendoni sikur t'ju tregoja historinë e shokëve të anijes, histori kjo të cilën e ka marrë Profeti *sal-lallahu alejhi ue selem* shembull për muslimanët. "Përpara disa kohësh kanë qenë një grup

njerëzish, të cilët hipën në një anije të madhe, e cila ishte e ndarë në dy pjesë: pjesa e poshtme dhe pjesa e sipërme. Njerëzit u ndanë në dy grupe, një grup qëndroi në hambarin e anijes, ndërsa tjetri në bordin e saj. Ata që ishin në hambarin e anijes, sa herë që kishin nevojë për ujë ngjiteshin në bordin e saj lart për të marrë nga uji i detit, kështu lanin me të enët e tyre dhe kryenin çdo nevojë të tyre.

Njëri prej tyre: Ejani të ngjitemi e të mbushim ujë.

Tjetri: Ngjitu ti, sepse unë jam lodhur duke u ngjitur e zbritur.

Dikush: Ne kështu po i shqetësojmë shumë ata që janë në bord sipër, një e dy dhe ngjitemi për të mbushur ujë.

Njëri prej tyre: Nuk duhet t'i bezdisim dhe t'i shqetësojmë ata që janë sipër.

Tjetri: Duhet të gjejmë një mënyrë tjetër me të cilën nuk do t'i shqetësojmë më shokët që janë sipër.

Njëri prej tyre: Kam një mendim, si thoni nëse bëjnë një brimë në fundin e anijes, kështu që sa herë do të na duhet ujë, nuk do të kemi më nevojë për t'u ngjitur sipër.

Tjetri: Mendim i shkëlqyer, sa mirë nuk do të kemi më nevojë të ngjitemi sipër.

Njëri prej tyre: Mendim shumë i mirë, unë për vete jam shumë dakord.

Babai: Kështu filluan banorët e hambarit të godisnin në fund të anijes, në mënyrë që të bënin një të çarë, porse goditjet që ata po bënin bënë një zhurmë shumë të madhe, gjë e cila i bëri ata që po rrinin në bordin e anijes të shpejtonin për të parë se ç'po ndodhte.

Ata që banonin në bord: Ç'është kjo zhurmë që po dëgjojmë të vijë nga hambari i anijes?

Njëri prej tyre: Ejani shpejt të shohim se ç'po ndodh.

Babai: Kështu ata që ishin në bord zbritën në hambarin e anijes dhe i gjetën ata kur po mundoheshin të hapnin një të çarë në fundin e anijes.

Ata që banonin në bord: Ç'është kjo që po bëni?

Banorët në hambar: Ne kemi nevojë për ujë ndaj dhe po e bëjmë këtë të çarë.

Ata që banonin në bord: Çfarë thoni kështu... të çarë në anije?!

Banorët e hambarit: Mos u shqetësoni, ne nuk duam t'ju bezdisim, pastaj dhe të çarën në pjesën tonë po e bëjmë e juve nuk ju dëmtojmë.

Ata që banonin në bord: Si ka mundësi një gjë e tillë?

Banorët e hambarit: Mos u frikësoni, ne vetëm po hapim një të çarë që ta përdorim për nevojat tona dhe kaq.

Ata që banonin në bord, ashtu të mërzhitur thanë: Mos vazhdoni më se do të na mbytet anija.

Një nga ata që banonin në bord: Ata po bëjnë të çarën vetëm në pjesën e tyre dhe nuk kanë ardhur në pjesën tonë.

Tjetri: Ç'thua more! Nëse i lejojmë të bëjnë një të çarë në anije do të mbyten ata dhe neve bashkë.

Dikush: Si the do të mbytemi?!

Tjetri: Po do të mbytet e tërë anija dhe nuk ka për të shpëtuar askush prej nesh, ndaj nëse i lemë të vazhdojnë do të shfarosemi të gjithë, por nëse i pengojmë me siguri që të gjithë do të shpëtojmë.

Fatimja: Babi çfarë ndodhi pastaj? A me të vërtetë i lanë të bënin një të çarë në anije?

Babai: Sigurisht që nuk i lejuan.

Ibrahimi: Po vallë a do të mbyteshin me të vërtetë, nëse do t'i lejonin ta bënin atë?

Fatimja: Vërtetë babi, si do të ishte përfundimi i tyre?

Babai: Sigurisht që përfundimi i tyre do të ishte ashtu si e ka përmendur Profeti *sal-lallahu alejhi ue selem*: **"Nëse do t'i lejonin, do të mbyteshin të gjithë."** Kështu është jeta vogëlushët e mi, njësoj si një anije e madhe, nëse do ta lejonim gabimtarin të vepronte ç'të donte, atëherë ai do të vazhdonte më tej e kështu do të mbytej anija e gjithë.

Fatimja: Faleminderit babi për këtë histori kaq të bukur.

Babai: Tani në gjumë vogëlushët e mi.

Fëmijët: Selamu alejkum babi.

Babai: ue alejkum selam vogëlushë. ■

Nga arabishtja: Bledar HAXHIU

KONFLIKTI DHE LIDHJA DUALE ME NJERIUN DHE ZOTIN

(VËSHTRIM RRETH KONCEPTIT
ISLAM TË LUFTËS DHE
MBROJTJES, DY AJETET E
SURES ENFAL SI MODEL)

“O ju që keni besuar, kur të takoheni me armikun qëndroni të fortë dhe Allahun përmendeni shumë, nëse doni të keni sukses. Dhe Allahun e të Dërguarin e Tij respektojeni dhe mos u përçani, se do të dështoni dhe do t’u humbasë fuqia. Dhe jini të durueshëm, se Allahu është me durimtarët.” (Enfal, 45-46)

SHKRUAN: EKREM AVDIU

Këto ajete janë pjesë e një tërësie tematike shumë të rëndësishme që trajton sureja Enfal dhe ajo që pason pas saj (Teube) e që ka të bëjë me institucionin e luftës, mbrojtjes, rregullave të saj, si dhe mënyrës së lidhjes së paqes dhe dispozitave përkatëse. Në realitet kjo pjesë e teorisë dhe e praktikës islame e bën Islamin të veçantë për vetë faktin se kjo është një dëshmi e fortë, që Islami është një tërësi rregullash e dispozitash, që rregullojnë jo vetëm raportet në drejtimin njeri-Zot, por edhe raportet

njeri-njeri, madje edhe atëherë kur njerëzit nuk funksionojnë në harmoni me njëritjetrin, por mund të vijë edhe deri te konfliktet e ndryshme. Edhe në këtë rast Islami i rregullon sjelljet dhe veprimet e pjesëtarëve të vet, duke i bërë ato të kontrolluara dhe të përmbajtura e asses afektive dhe euforike.

Brenda këtij rrethi pastaj hasim edhe lidhjen duale, shumë funksionale që ka të bëjë me raportin që duhet të ketë muslimani me Krijuesin dhe me krijesat, edhe në kohën kur problemet zgjidhen me anën e forcës, si pasojë e rrethanave që burojnë nga pamundësia e zgjidhjes së tyre me mirëkuptim. Duhet përmendur se edhe në

rastet e luftës dhe konflikteve të ndryshme, situata këto në të cilat njerëzit rëndom dalin nga kontrolli dhe veprimet e tyre bëhen shumë agresive dhe të pamatura, Islami edhe në këto rrethana ka instaluar mekanizmin e kontrollit të hidhërimit, vetëpërmbytjes dhe e ka ndaluar të tepruarit edhe në hakmarrje. Këmbëngulja e Islamit është që muslimani mu atëherë kur është i fortë dhe ka mundësi të ndëshkojë apo të hakmerret, mu në atë rast falja dhe ndjesa të dali në pah si virtyt, të cilin Allahu i Madhëruar e kërkon prej robërve të Vet. Është interesant të theksohet fakti se edhe aty ku duhet përdorur forca si alternativë apo zgjedhje ekzistojnë rregulla të rrepta, të cilave njerëzit duhet të përmbahen dhe në asnjë mënyrë nuk lejohet që situata të kalojë në anarki, siç mund të ndodhë në situatat e konflikteve të ndryshme me përmasa të gjera. Superioriteti i Islamit del në pah në këtë rast, sepse në asnjë mënyrë nuk mund të lihet hapësirë për shkëputjen e lidhjes ndërmjet njeriut dhe Allahut, dhe njeriu nuk është i justifikuar që të ndër marrë qëndrime dhe hapa të gabuara, dhe të padrejta, qoftë edhe kundër armikut të tij në luftë.

Ajetet e sipërcituara janë një shembull i shkëlqyer për vlerat që ka promovuar Islami, si dhe për hapat konkretë, që duhet të ndër marrë muslimani për të arritur deri te suksesi, qoftë në luftë apo në paqe.

QËNDRUESHMËRIA

Pas udhëzimit gjëja më e vlefshme në jetën e njeriut është qëndrueshmëria në rrugën e drejtë. Rëndësia e kësaj qëndrueshmërie vërehet, edhe në teori, edhe në praktikë. Teorikisht Allahu i Madhëruar na ka udhëzuar që në çdo lutje tonën (namaz) të lexojmë Fatihanë, në të cilën përveç të tjerash është kërkesa për udhëzim të vazhdueshëm në rrugë të drejtë, që duhet kuptuar si theksim i nevojës për

“...Këmbëngulja e Islamit është që muslimani mu atëherë kur është i fortë dhe ka mundësi të ndëshkojë apo të hakmerret, mu në atë rast falja dhe ndjesa të dali në pah si virtyt...”

qëndrueshmëri dhe stabilitet në rrugën e drejtë. Edhe vetë i Dërguari i Allahut, siç na përcillet në mënyrë autentike është lutur vazhdimisht dhe ka kërkuar nga Allahu që ta forcojë. Ky stabilitet i përgjithshëm është një mozaik i përbërë nga pjesë të shumta e të llojllojshme që secila prej tyre i referohet qëndrueshmërisë dhe këmbënguljes së muslimanit me rastin e kryerjes së ndonjë detyre fetare, apo realizimit të ndonjë projekti në përkrahje të Islamit.

Duke pasur parasysh se lufta është një prej projekteve më të vështira që kërkon sakrifica dhe ka kosto të lartë në të gjitha aspektet, kjo paraqet një sprovë për muslimanin dhe doemos kërkon një qëndrueshmëri dhe stabilitet më të veçantë. Mu për këtë ka ardhur si kërkesë e posaçme në ajet: ***“O ju që keni besuar, kur të takoheni me armikun qëndroni të fortë...”*** Sipas logjikës së thjeshtë, sa më e rëndë të jetë detyra aq më e vështirë do të jetë kryerja e saj. Kur njeriu ballafaqohet me armikun e vet ai i ekspozohet një sprove shumë të rëndë, sepse kosto e këtij ballafaqimi do të jetë jeta, pasuria, shëndeti apo mirëqenia e tij. Në raste të tilla të dy palët përgatiten për atë ballafaqim, ndërsa fitoren do ta arrijë vetëm ai që është më këmbëngulës dhe më i qëndrueshëm, ndërsa faktor i rëndësishëm për të siguruar qëndrueshmëri përveç të

tjerash është ideali dhe bindja për të cilën njeriu lufton dhe është i gatshëm të flijohet. Krahas kësaj, rëndësi ka edhe mënyra se si mëtohet të arrihet deri tek arritja e asaj që njeriu synon të arrijë.

PËRMENDJA E ALLAHUT

Qëndrueshmëria në rrugën e Allahut nuk mund të arrihet vetvetiu. Sado që njeriu mund të pretendojë se angazhimi i tij është i drejtë dhe për hir të së vërtetës, prapë nuk mjafton. Teoria islame, por edhe praktika e Muhamedit *sal-lallahu alejhi ue selem*, na mëson se ky stabilitet duhet kërkuar. Mu për këtë pas kërkesës për qëndrueshmëri vjen urdhri: **“...dhe Allahun përmendeni shumë nëse doni të keni sukses.”** Kur të kemi marrë të gjitha masat e duhura, që një projekt të realizohet me sukses dhe të kemi bërë tërë atë që është në duart dhe në kompetencat tona, ne duhet të kuptojmë se aty përfundon kufiri i mundësive tona dhe përtej atij kufiri mbetet vetëm Vullneti i Allahut dhe Dëshira e Tij, prandaj i tërë sukcesi dhe mbarëvajtja e punëve varet nga Dëshira e Allahut dhe sa Ai jep bereqet. Për këtë arsye të gjitha punët që i bëjmë duhet të shoqërohen nga dhikri, përmendja dhe përkujtimi i Allahut dhe lutja që Ai të japë sukses dhe bereqet.

Konkretisht, në rast të sprovave dhe vështirësive të mëdha, të cilat ndonjëherë duken si të patejkalueshme, sikurse janë lufta dhe ballafaqimi me armikun, përmendja e Allahut luan një rol vendimtar në stabilitet dhe qëndrueshmëri, sepse dhikri është faktori i brendshëm që shërben si gjenerues i forcës, fuqisë, trimërisë dhe qëndrueshmërisë.

Raporti mes aktivitetit dhe përmendjes së Allahut (dhikrit) është i mirënjohur. Edhe njerëzit më të mëdhenj dhe më të suksesshëm në historinë njerëzore kanë dëshmuar me praktikën e tyre, se kur i kanë mbaruar punët dhe kanë dhënë gjithë

mundin e tyre i janë drejtuar Allahut me lutje që t'u japë sukses, të pranojë mundin e tyre dhe ta bekojë atë. I këtillë është rasti i Ibrahimit *alejhi selam* kur së bashku me të birin Ismailin ndërtoi Qaben.

RESPEKTIMI I ALLAHUT DHE TË DËRGUARIT TË TIJ

Ky është një parim i përgjithshëm dhe i mirënjohur në Islam, saqë nuk mund të paramendohet të qenit e dikujt musliman, po qe se anashkalohet respekti dhe dëgjueshmëria e tij për Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Në të vërtetë i gjithë Islami nuk është gjë tjetër përveçse nënshtrim ndaj Allahut dhe respekt e dëgjueshmëri, prandaj edhe theksimi i kësaj kërkesë në këtë rast mund të duket si përsëritje në formë më të imtësuar e asaj që është parim i përgjithshëm.

E vërteta është se nuk mund të ketë kryerje të detyrimeve dhe realizim të suksesshëm të projekteve islame pa iu nënshtruar plotësisht udhëzimeve të Allahut dhe pa ndjekur rrugën e të Dërguarit të Tij. Në rastin konkret kemi të bëjmë me një projekt madhor për umetin, prandaj nevoja për ripohimin e rëndësisë së respektit dhe nënshtrimit ndaj tyre është e dukshme. Krahas një nënshtrimi të përgjithshëm nevojitet nënshtrimi i veçantë që lidhet ngushtë me projektin në fjalë.

“E vërteta është se nuk mund të ketë kryerje të detyrimeve dhe realizim të suksesshëm të projekteve islame pa iu nënshtruar plotësisht udhëzimeve të Allahut ...”

RUAJTJA E UNITETIT

“...dhe mos u përçani se do të dështoni dhe do t’u humbasë fuqia.”

Kompaktësia e radhëve të muslimanëve është një prej objektivave madhorë të Islamit. Ky objektiv është i ngritur mbi një bazë të fortë, mbi bazën e afrimit dhe të bashkimit mbi të vërtetën dhe për hir të saj. Uniteti i muslimanëve është një kërkesë e vazhdueshme islame dhe ajo si synim manifestohet në të gjithë poret e jetës së komunitetit mysliman. Nga kjo varet në masë të madhe edhe suksesi në realizimin e të gjitha projekteve dhe bereqeti që Allahu mund të ofrojë gjatë kryerjes së këtyre veprimeve. Të gjitha kërkesat islame janë të lidhura ngushtë me obligueshmërinë e bashkimit dhe unitetit, si dhe flakjen e përçarjes. Namazi, për shembull, në formën e tij më të mirë kryhet dhe vlerën më të madhe e ka nëse falet në xhemat pra, në kolektiv. Gjithashtu edhe agjërimi i muajit të ramazanit duhet të fillojë kolektivisht dhe të përfundojë kështu. Kështu është edhe xhumaja, haxhillëku etj..

Organizimi i luftës e bën edhe më të theksuar nevojën për unitet, kur dihet se lufta, mbrojtja dhe menaxhimi i konflikteve është një problematike e rëndësishme madhore dhe për këtë jo vetëm që nevojitet mund e angazhim, por lypset edhe kolektivitet e disiplinë. Bashkësia, sipas të gjitha standardeve dhe mendjeve bën fuqinë. Allahu i Madhëruar lidhur me këtë çështje, si dhe për t’u arritur sa më mirë realizimi i këtij objektivi ka ndaluar të gjitha aktivitetet, që çojnë kah përçarja dhe shkapërderdhja e muslimanëve, qoftë ajo edhe në qëndrime dhe mendime, në mënyrë që të mos shpërndahet forca dhe fuqia e muslimanëve.

“... dhe mos u përçani se do të dështoni...”, urdhër ky që muslimanët duhet ta kenë gjithnjë parasysh. Përçarja nuk mund t’u sjellë dobi muslimanëve në asnjë mënyrë.

“...Është normale që parimisht të ketë divergjenca në mendime e qëndrime përderisa ato mendime e qëndrime nuk dalin nga suazat e të vërtetës...”

Është normale që parimisht të ketë divergjenca në mendime e qëndrime përderisa ato mendime e qëndrime nuk dalin nga suazat e të vërtetës, por në atë moment që sqarohet dhe argumentohet se cili është mendimi i qëlluar, ai duhet të respektohet nga të gjithë dhe çdonjëri që ka menduar ndryshe, për hir të së vërtetës dhe unitetit, duhet të heqë dorë nga mendimi e qëndrimi i vet. Në asnjë mënyrë nuk bën që njeriu të kapet me fanatizëm dhe t’i përmbahet mendimit të vet vetëm pse ai është i veti. Ndër gjërat e bukura që janë përmendur në komentimin e këtij ajeti është edhe thënia se përçarja që ndalohet në ajet është divergjenca e paargumentuar në mendime e qëndrime, e cila çon në ndarjen dhe përçarjen e zemrave dhe rritjen e distancës mes pjesëtarëve të komunitetit.

Prej gjithë kësaj mësojmë, përveç tjerash edhe etikën e respektimit të mendimit të tjetrit edhe pse ai mund të bjeri ndesh me qëndrimet personale, dallim ky që nuk i tejkalon limitet e mospajtimit të tolerueshëm. Kjo etikë në kohët e fundme mungon në radhët e pjesëtarëve të Umetit islam, e posaçërisht në radhët e aktivistëve. ■


UMETI IM DO TË PËRÇAHE...

SHKRUAN:
LULZIM SUSURI

Zinxhiri i hadithit:

Ky hadith transmetohet nga disa sahabë, Allahu goftë i kënaqur me ta. Nga ata është Ebu Hurejre, Muavia ibën Ebi Sufjani, Enes ibën Maliku, Auf ibën Maliku etj. Ndërsa në librat e tyre e shënojnë imam Ahmedi, 2/332, 4/102, Ebu Davudi, nr. 4596, 4597, Tirmidhiu, nr. 2564, Ibën Maxhe, nr. 3991, 3992, 3993, Ibën Hibani, nr. 1834, Axhuriu në librin e tij *"Esh-sheriah"* fq. 25, Hakimi në *"Mustedrek"*, 1/128, Ebu Jala në *"Musnedin"* e tij, Darimiu, 2/241, Ibën Betah në *"El-Ibane"* 2/108, 2/119, Lalekai në *"Sherh es-suneh"* 1/23.

Këtë hadith e kanë përcjellë shumë, si sahabët, transmetuesit pas tyre (gjeneratat pas tyre) ashtu edhe dijetarët që e kanë shënuar në librat e vet. Nëse do të merrnim vetëm transmetimin e Enes ibën Malikut do të vërenim se nga ai transmetohet me shtatë zinxhirë transmetuesish, prandaj bazuar në rregullat e shkencave të hadithit ky transmetim konsiderohet i saktë pa kurrfarë dyshimi. Hadithin e saktëson Tirmidhiu,



Profeti, sal-lallahu alejhi ue selem, thotë:
"Çifutët janë përçarë në shtatëdhjetë e një grupe, të krishterët në shtatëdhjetë e dy, kurse umeti im do të përçahet në shtatëdhjetë e tri, të gjitha do të futen në zjarr përveç njërit. Shokët e pyetën cili është ai grup, o i Dërguari i Allahut? Ai tha: "Ai është që më pason mua në atë që jam unë sot dhe që pason shokët e mi".

fetava, 3/346), gjithashtu e saktëson edhe Albani në *"Silsile sahiha"* hadithi nr. 203, 204, 1492, 3842. Gjithë këto referenca i përmendëm për arsye se ka pasur njerëz, të cilët i futën hundët duke folur sipas epshit të tyre dhe për interesa shumë të ngushta, ku si pasojë e konsideruan hadithin të dobët.

Disa nga pretenduesit e studimit të fesë në baza filozofike e konsideruan hadithin të dobët jo nga aspekti i zinxhirit të tij, por të bazuar në logjikën e tyre ata menduan se një fjalë e tillë profetike do të mbillte bindjen në mendjet e njerëzve që përçarja do të ndodhë patjetër në këtë umet dhe nuk do të mërzhiteshin dhe nuk do të nguronin për përçarje. Kështu që sipas kësaj arsyeje do të ishte më mirë ta konsideronim këtë hadith të dobët, që të mos krijohet më pas kjo bindje tek njerëzit. Pra, kjo ishte arsyeja e dobësimit të hadithit sipas tyre.

Mirëpo ky grup pa dyshim se gabuan nga të gjitha aspektet apo këndvështrimet e tyre. Së pari kundërshtuan parimet fetare dhe

rregullat e vendosura nga dijetarët shekuj me radhë, se si duhet konsideruar një hadith i saktë apo jo dhe kështu u bazuan në mendjen e tyre, ku edhe për këtë shkak gabuan duke i lënë anash me mijëra rregulla të shkencës së Mustalahul hadithit. Kjo ndodhi vetëm për të përmbushur kërkesën e mendjes së tyre. Ndërsa arsyeja e tyre se ky hadith mund të krijojë bindje tek njerëzit se përçarja është normale ka disa të meta. Them së pari, se një fjalë e tillë konsiderohet akuzë ndaj Profetit, sal-lallahu alejhi ue selem, kinse ai nxit përçarje. Pastaj Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, nuk flet me hamendje si njerëzit e tjerë, por fjalët e tij janë shpallje ndërsa fjalët e tyre nuk janë asgjë tjetër veçse filozofi e kotë. Gjithashtu nëse këta filozofë me mendjet e tyre të “ndritura” arritën të kuptonin, se hadithe të tilla nxisin përçarje, atyre u themi se asnjë mendje dhe logjikë nuk është më e ndritur se ajo e Profetit, e cila ka qenë gjithmonë nën kontrollin hyjnor, prandaj çdo logjikë pas asaj profetike nuk është asgjë tjetër veçse humbje. Po ashtu realiteti i botës islame e pohon të kundërtën pra, pohon faktin se umeti veçse janë përçarë, pa marrë parasysh e dinë këtë hadith apo jo, apo pa marrë parasysh e konsideruan të dobët atë apo të saktë.

Komenti i hadithit:

Hadithi është shumë me rëndësi, ku për këtë shkak edhe Ebu Davudi, Allahu e mëshiroftë, e ka vendosur në radhë të parë në librin e tij Sunen, në kapitullin e pasimit të Sunetit dhe largimit nga grupimet. Gjithashtu çdo dijetar kur flet apo shkruan për përçarjet, grupimet apo sektet, ose kur flet për grupin e shpëtuar nuk lë pa përmendur edhe këtë hadith. Pra, është hadith i madh në kapitullin e tij, i cili e trondit çdo grupim që e kundërshton pasimin e Sunetit të Profetit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ku edhe për këtë shkak dëshiruan me çdo kusht të gjykonim

“...Ne nuk duhet ta duam përçarjen, as ta ndihmojmë atë, bile duhet edhe ta parandalojmë, por duhet të besojmë patjetër se ajo do të ndodhë...”

rreth tij, se është i dobët apo i shpifur. Pati të tillë, të cilët ja ndërruan vendet fjalive duke e ndërruar pjesën e fundit në këtë mënyrë: “Të gjitha në xhenet përveç njërit” pra, ndërruan fjalën e Profetit, *sal-lallahu alejhi ue selem*: “Të gjitha në zjarr përveç njërit”. Ky ndërrim konsiderohet shpifje ndaj Profetit, e si pasojë e të cilit është përgatitja e një karrige nga zjarri i xhehenemit për shpifësin.

Në fillim Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, tregon për çifutët dhe të krishterët, se si edhe ata ishin përçarë në grupe, ku pastaj u pasuan nga muslimanët, gjë e cila është më se e ditur, sepse vetë Profeti na tregoi se do t'i pasonim popujt para nesh pëllëmbë për pëllëmbë, ku ne nuk jemi mjaftuar vetëm me pasimin e çifutëve dhe të krishterëve, por edhe ua kaluam atyre siç përmendet në hadith. Pra, kemi shtuar edhe një grup më shumë se ata.

Ky hadith është një prej haditheve të shumta me të cilët vërtetohet profecia e Muhamedit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, sepse aty ai përmend gjëra të cilat për vetë Pejgamberin ishin të panjohura dhe fshehtësi (gajb) e të cilat me të vërtetë ndodhën më vonë mu ashtu siç i përmendi ai. Sa i përket pjesës së parë të hadithit, e cila flet për çifutët dhe të krishterët nuk do të ndalemi rreth saj, ngase janë më se të qarta, por aty dua të theksoj vetëm një gjë; ajo është se në disa transmetime përmendet se edhe grupet e tyre të gjitha do të jenë në zjarr përveç njërit. Këtu mendoj se do të ishte e arsyeshme

sqarimi i faktit, se ky grup i shpëtuar nga të dy palët janë pasuesit e Musait dhe të Isait, paqja e Allahut qoftë mbi ta. Pra, pasuesit e tyre në rrugë të drejtë, që nga Musai e deri tek Muhamedi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, dhe prej Isait e deri tek Muhamedi. Pas ardhjes së Profetit Muhamed çifutëve dhe të krishterëve nuk u mbetet më asgjë, përveç pasimit të Profetit të fundit, alejhi salatu ue selam. Pra, pasuesit e drejtë të Musait dhe të Isait konsiderohen si besimtarë deri me ardhjen e Muhamedit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ku pastaj urdhërohen me pasimin e këtij të fundit, sepse sheriat i tij shfuqizon çdo sheriat paraprak, e kush e beson konsiderohet musliman, ndërsa në të kundërtën kush e refuzon konsiderohet qafir.

Fjala e Profetit, *sal-lallahu alejhi ue selem*; “*Umeti im do të përçarhet në shtatëdhjetë e tri grupe...*” nënkupton, se kjo përçarje do të ndodhë patjetër, prandaj askush nuk mund ta ndalë atë dhe nuk duhet të harxhojë potencialin e tij në parandalimin e fenomenit, ngase ky mundim do të shkojë në llogari të pasimit të sunetit nga vetë parandaluesi. Pra, është e vërtetë, se ne nuk duhet ta duam përçarjen, as ta ndihmojmë atë, bile duhet edhe ta parandalojmë, por duhet të besojmë patjetër se ajo do të ndodhë, sepse është paralajmëruar nga ai i cili nuk flet nga mendja e tij, por çdo fjalë që ai thotë është vetëm shpallje.

Fjala e Profetit, *sal-lallahu alejhi ue selem*; “*të gjitha në zjarr përveç njërit...*”, ai me këtë fjalë nuk i arsyetoi apo nuk filloi të shprehte mendime të ndryshme rreth tyre dhe shkakut të përçarjes, por tregoi shkurt, se që të gjitha degëzimet janë në zjarr përveç njëres. Kjo fjalë, sikur na bën me shenjë, se njerëzit në pasimin e epsheve nuk i arsyeton gjithmonë qëllimi i mirë apo injoranca, kur kanë mundësi të mësojnë që të mos gabojnë. Njeriu arsyetohet me injorancë vetëm atëherë kur nuk ka mundësi të mësojë, kurse nëse një

mundësi e tillë i krijohet, ai prapë vazhdon të mos mësojë, duke u arsyetuar se injoranca është shkak që të më falen shumë gabime, këtu themi se në këtë rast kjo injorancë është e pavlefshme, sepse janë krijuar kushtet për mësim.

Fjala Profetike: “*Përveç njërit*”. Këtu dua të përmend, se pasuesit e së vërtetës në fakt nuk janë grupacion, as nuk quhen të tillë, sepse grupacionet janë ato që ndahen nga grupi i madh apo nga xhemati i muslimanëve, por Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, e përmendi në mesin e grupeve të tjera për shkak se çdo grup pretendon se ata janë pasuesit e denjë dhe kundërshtarët e tyre i konsiderojnë grupacione të humbura, kështu e konsiderojnë si të tillë edhe grupin që pason Sunetin. Kjo pjesë e hadithit sikur thotë se pa marrë parasysh si e quani ju këtë grup, ai është i vetmi i shpëtuar, për të cilin kur u pyet nga shokët e tij, se cili ishte ai grup Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ju përgjigj: “*Ai është që më pason mua në atë që jam unë sot dhe që pason shokët e mi*”.

Me këtë fjalë lind mërzia për çdo grup apo fraksion në Islam. Me të demoralizohet çdo pretendues me emra të ndryshëm jashtë pasuesve të Profetit dhe shokëve të tij. Këtu dua të ndalem në disa pika:

Profeti nuk përmendi pasimin e Kuranit, por menjëherë kaloi tek pasimi i Sunetit. Kjo për shkak se zakonisht shumica e fraksioneve në Islam pretendojnë se e pasojnë Kuranin, por e kundërshtojnë Sunetin.

Profeti e përmendi se pasimi i tij duhet të jetë në ato punë në të cilat ai ishte në atë kohë kur po fliste. Nga kjo kuptojmë se nëse dikush pretendon se është duke e pasuar Sunetin dhe në fakt ka shpifur hadithe dhe sunete nga vetja e tij duke ia veshur Profetit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ajo nuk është e pranuar. Ky pasim duhet të jetë patjetër i bazuar vetëm në hadithe të sakta dhe të vërtetuara shkencërisht, se janë trashëgimi profetike e jo

pasim i Profetit me hadithe të shpifura dhe të dobëta, ku pasuesit e tyre pasi nuk kanë çfarë të thonë për gradën e tyre në fund të secilit hadith në vend që të shkruajnë; ky hadith është i saktë apo i mirë etj., shkruajnë fjalën: “hadith sherif”.

Në fund shtoi se pasimit të Profetit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, i duhet shtuar edhe një kusht tjetër, e ai është pasimi i traditës dhe mësimëve të sahabëve. Kjo për vetë faktin se njerëzit që e dinin dhe e kuptonin më së miri traditën profetike ishin shokët e tij.

Vërejtje:

Grupi i vetëm i shpëtuar do të thotë se është i vetmi, i cili nuk do të futet në zjarr. Por kjo nuk nënkupton se çdo individ, i cili i takon atij grupi të jetë i sigurt nga zjarri, ngase edhe pse ka pasuar Sunetin dhe Xhematin mund të ketë mëkate të tjera, të cilat mund të jenë shkak për dënim të përkohshëm.

Grupacionet e lartpërmendura në umetin e Muhamedit, *sal-allahu alejhi ue selem*, edhe pse Profeti i përmend se do të jenë në zjarr, sipas mendimit më të saktë të dijetarëve kjo nuk do të thotë se ata janë qafirë, por ata konsiderohen vetëm jo-pasues të traditës profetike apo bidatçinj. Imam Hatabiu në librin e tij: “Mealimus sunen” 7/4 thotë: “Hadithi aludon se këto grupacione nuk janë të dala nga Islami, kjo për vetë faktin se Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, në këtë hadith i përmend duke i futur brenda umetit të tij” mendim ky që e përmend edhe Ibën Tejmie në “Mexhmu fetava” 3/346 dhe në librin e tij mbi Imanin. Për këtë arsye këto grupacione duhet pranuar se janë të rrezikuara me zjarr, por në anën tjetër nuk duhet vërtetuar për asnjë pasues të ndonjë grupacioni, se Allahu me siguri do ta dënojë me zjarr. Prandaj kur vjen puna tek përmendja e dënimit për ta duhet pasur kujdes, që mos ta zgjasim gjuhën për asnjërin

prej tyre, por të kërkojmë falje nga Allahu për vete dhe për besimtarët në përgjithësi.

Përmendja e numrit shtatëdhjetë e tre nënkupton se në këtë numër do të ndahet umeti i Muhamedit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, kurse grupacionet që dalin jashtë këtij numri ata edhe pse pretendojnë se janë në Islam në fakt nuk janë brenda tij. Çdo grup jashtë këtij numri janë qafirë, edhe pse për të vërtetuar saktësisht se cilët grupe janë brenda numrit shtatëdhjetë e tre, e cilët jashtë mbetet punë e dijetarëve dhe jo e çdokujt apo e çdonjërit i cili mundohet që me injorancë ta fusë brenda umetit kë do dhe ta nxjerrë prej tij kë i teket atij. Dijetarët në librat e tyre i kanë përmendur këto grupe, por ka disa kundërshtime të vogla mes tyre për disa grupacione, të dhëna këto të cilat nuk na mjafton hapësira t’i bartim në temën tonë, por nuk do të lë pa përmendur fjalën e Abdullah ibën Mubarekut (Mexhmu fetave 3/351): “Grupacionet bazë nga të cilët kanë lindur grupe të tjera janë katër: Shiitët (vetëm ata që me besimin dhe veprat e tyre nuk kalojnë në kufër), Havarixhët, Kaderitë dhe Murxhiet”.

Me fjalën përçarje është si qëllim përçarjet në akide e jo ato në fikh.

Shtimi i grupacioneve brenda umetit të Muhamedit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, nënkupton jetëgjatësinë dhe përhapjen e këtij umeti në botë, ngase këto grupe nuk mund të lindnin përnjëherë.

Dijetarët e selefit e kanë pasur traditë që fillimisht të merren me gabimet e veta dhe t’i zbulojnë ato në vetvete e pastaj të përmirësojnë veten e vet, në fund nëse u mbetej kohë merreshin me punët e të tjerëve. Prandaj as ne në këtë kohë nuk duhet të merremi me njerëzit, se filan personi cilit grupacion i takon dhe kështu t’i klasifikojmë njerëzit. ■

DALLIMI MES EHLI SUNETIT DHE MEDHHEBEVE TJERA



ZGJODHI NGÄ ARABISHTJA: TALHA KURTISHI

Pyetja: Cili duhet të jetë qëndrimi i muslimanit ndaj dallimeve të përhapura mes grupacioneve dhe partive të ndryshme?

Përgjigja: I falënderuar është Allahu...

Detyra e muslimanit është t'i përmbahet të vërtetës së treguar qartë në Librin e Allahut dhe Sunetin e të Dërguarit, bekimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të. Duke u mbështetur në Librin e Allahut dhe Sunetin ai i miqëson besimtarët dhe i armiqëson mosbesimtarët. Ai është i detyruar të kundërshtojë dhe të distancohet nga çdo lëvizje dhe parti që ndeshet me të vërtetën. Feja e vërtetë tek Allahu është vetëm Islami dhe rruga e drejtë është vetëm një rrugë. Rruga e

shpëtimit është adhurimi i Allahut dhe ndjekja e të Dërguarit të Allahut, bekimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të. Prandaj detyrimi i besimtarit është të përqendrohet në rrugën e adhurimit ndaj Allahut dhe në rrugën e zbatimit të sheriatit me sinqeritet dhe përpikëri. Atij nuk i lejohet që ndonjë lloj adhurimi t'ia drejttojë dikujt tjetër pos Allahut. Besimtari duhet të largohet dhe të distancohet nga çdo lëvizje dhe parti, që e kundërshtojnë këtë rrugë dhe duhet të bëhet thirrës i hakut, të cilin duhet t'ua shpjegojë familjes së tij me argumente fetare, me butësi dhe metoda të përshtatshme, duke ua mundësuar atyre të shohin të vërtetën.

**Përmbledhja e Fetvave të Ibën Bazit
vëll. 27 fq. 327**

Në këtë rubrikë mirëpresim të gjitha pyetjet e juaja, ndërsa ato më interesante do të botohen.
Pyetjet mund t'i dërgoni në albislam@gmail.com

Pyetja: Cili është dallimi mes Ehli Sunetit dhe medhhebeve të tjera (për shembull hanefi, maliki, shafi)? A i lejohet një vajze që është prej Ehli Sunetit të martohet me një njeri, i cili nuk është ndjekës i ndonjë medhhebi?

Përgjigja: Përballë Ehli Sunetit nuk qëndrojnë shkollat juridike, si shkollat e imamëve Ebu Hanife, Malikut, Shafiut, Ahmed ibën Hanbelit. Përkundrazi përballë Ehli Sunetit qëndrojnë ithtarët e risive dhe lajthitjeve në çështjet e besimit dhe metodologjisë, siç kanë qenë dhe janë sektet e mutezilive, murxhive, sufive etj.

Katër medhhebet e njohur janë shkolla juridike dhe imamët e këtyre shkollave janë në të njëjtën kohë edhe imamë të Ehli Sunetit. Në realitetin e sotëm me keqardhje konstatojmë, se shumica e ndjekësve të këtyre shkollave juridike e ndjekin edhe rrugën e risimtarëve dhe të lajthiturve në çështjet e besimit.

Është pyetur Masumiu : A është i detyruar muslimani të ndjek ndonjërin prej katër medhhebeve të njohur?

Përgjigja e tij ishte: Muslimanit i lejohet të ndjek njërin prej katër shkollave juridike, nëse nuk ka dije me të cilën ai ka mundësinë të nxjerri dispozita nga Libri i Allahut dhe Suneti i të Dërguarit, por po ai detyrohet ta pasojë të vërtetën e argumentuar, kur t'i bëhet e qartë, edhe atëherë kur bie ndesh me medhhebin e tij.

Ibën Tejmiye, Allahu e mëshiroftë, thotë: Allahu në Librin e Tij e ka kritikuar largimin nga ndjekja e të Dërguarve dhe pasimin e fesë së shpikur nga etërit. Ky është taklidi (pasimi qorrazi- imitim i verbër), të cilin e ka ndaluar Allahu dhe i Dërguari i Tij. Taklid është pasimi i atyre që nuk janë të Dërguar, duke i kundërshtuar mësimet e të Dërguarve dhe kjo me konsensusin e muslimanëve është

haram për çdonjërin. Nuk lejohet bindja ndaj krijesës duke bërë mëkat ndaj Krijuesit. T'i bindemi të Dërguarve është farz për çdonjërin prej të diturve dhe të paditurve, në çdo kohë dhe në çdo vend, kur është vetëm dhe para njerëzve, në çdo situatë... Allahu e ka bërë detyrim bindjen ndaj të Dërguarit në më se dyzet vende në Kuranin Famëmadh.

Taklidi nga i paafti për ta argumentuar mendimin e tij para dijetarit është i lejuar tek shumica e dijetarëve. **(Mexhmu'ul Fetava vëll. 19 fq. 260-266)**

Pasuesit e gjeneratave të lavdëruara janë të kapurit për Kuranin dhe Sunetin në çështjet e besimit (akides), fikhut dhe etikës. Ata kurrsesi nuk e kundërshtojnë Kuranin, Sunetin dhe qëndrimet rreth të cilëve janë pajtuar gjeneratat e zgjedhura të këtij umeti.

Dijetari i njohur Salih El Feuzan, Allahu e ruajt, thotë:

Në rrugën e selefit janë pasuesit e gjeneratave të lavdëruara të këtij umeti, gjeneratat e sahabëve, tabiinëve dhe imamëve të dalluar e me peshë, që ishin në rrugën e drejtë në çështjet e besimit dhe metodologjisë, që e dëshmuuan besimin e tyre dhe përpikërinë në zbatimin e Islamit, si besim, legjislacion, etikë dhe moral. Ata qëndrojnë larg risive, devijimeve dhe besëtytnive. Ky është Ehli Suneti, emër të cilin ata nuk e përdorin për t'u lavdëruar, por për të bërë dallim mes tyre dhe ithtarëve të sekteve të lajthitura. **(El Munteka min fetava Shejh Salih El Feuzan, vëll. 1, pyetja nr. 206)**

Nga kjo që u tha arrijmë në përfundimin, se nëse ndonjë njeri me besimin dhe moralin e të cilit jemi të kënaqur vjen dhe e kërkon për grua një muslimane, nuk ka pengesa për realizimin e kësaj martese, edhe nëse personi në fjalë nuk është ndjekës i ndonjë medhhebi prej

katër medhhebeve të njohur. Atij me siguri duhet t'i jepet përparësi para atyre që u përkasin grupeve të devijuara, me të cilët nuk lejohet të lidhet marrëveshja e kurorëzimit. Allahut i takon dija e plotë.

(Muhamed Salih El Munexhid)

Në një hadith nga i Dërguari i Allahut, që po ua transmetoj me kuptim, unë lexova se umeti do të ndahet/përçahet në 73 grupe dhe se të gjithë këto grupe do të dënohen me zjarr përpos asaj që është në Sunet. Sot ne shohim se katër medhhebet nuk pajtohen mes vete prandaj pyes në këtë hadith a janë të përfshira edhe shkollat juridike?

Përgjigja: I falënderuar është Allahu...

Hadithi i njohur për ndarjen e umetit në shtatëdhjetë e tre grupe është hadithi i Muavisë, birit të Ebu Sufjanit, Allahu qoftë i kënaqur me të, i cili tha: I Dërguari i Allahut, bekimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, u ngrit dhe na tha: *Me të vërtetë ithtarët e Librit para jush u ndanë në shtatëdhjetë e dy grupe dhe me të vërtetë ky umet do të ndahet në shtatëdhjetë e tre grupe, shtatëdhjetë e dy do të jenë në zjarr, ndërsa njëri do të jetë në xhenet, ai grup është xhemati (bashkësia).*

Tirmidhiu (2641) e përcjell hadithin në këtë formë: *“Umeti im do të ndahet në shtatëdhjetë e tre grupe, të gjithë do të dënohen me zjarr përpos njërit. Thanë: Kush është ai grup, o i Dërguari i Allahut? Tha: Ai që është në atë në të cilin jam unë dhe shokët e mi”*. Pjesa e hadithit në të cilin thuhet se umeti im do të ndahet në shtatëdhjetë e tre milete (fjala millet arabisht përdoret për fe) tregon se mospajtimi, i cili do të rezultojë me ndarje është mospajtimi rreth bazave dhe çështjeve të besimit e jo rreth dispozitave

dhe gjykimeve, që kanë të bëjnë me çështjet e fikut.

Edhe pjesët e hadithi *“ai grup është xhemati (bashkësia)”* dhe *“Ai që është në atë në të cilin jam unë dhe shokët e mi”* aludojnë për këtë gjë. Ai që ka mendim ndryshe në çështjet dytësore nuk del jashtë bashkësisë e as nga udhëzimi i të Dërguarit, bekimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, e as jashtë udhëzimit të sahabëve. Sahabët kishin mendime të ndryshme për shumë çështje dytësore dhe ato nuk përfunduan me ndarje dhe përçarje. Askush nuk ka pohuar, se me këto mospajtime ata hyjnë në hadithin që flet mbi përçarjen. Ata ngelën një xhemat, të bashkuar në metodologji, të unifikuar rreth çështjeve bazë të besimit. Ky është edhe realiteti i katër imamëve të pasuar dhe realiteti i dijetarëve të tjerë. Ata janë xhemati, grupi i shpëtuar, Ehli Suneti dhe kush shmanget nga rruga e tyre dhe nga themelet e tyre në besim është më meritore të quhet bidatçi i lajthitur. Për këtë shkak imam Shatibiu shkruan: Këto sekte meritojnë të quhen me atë emër, e jo me emrin e grupit të shpëtuar, për shkak të kundërshtimit në ndonjë çështje kryesore të fesë, bazë prej bazave të sheriatit, jo për shkak të kundërshtimit në ndonjë çështje më pak parimore. Nga kundërshtimi në çështje më pak parimore nuk përfundon në mospajtim, që të përfundojë me përçarje në parti. Një mospajtim i tillë ndodh kur ka kundërshtime rreth çështjeve të përgjithshme, që konsiderohen baza (themele)... (El l'tisam, 2/200)

Me këto që u tha u vërtetua padrejtësia e cilësimit të katër imamëve me cilësinë e përçarjes, si dhe padrejtësia e cilësimit të pasuesve të tyre, që mbetën unik me Ehli Sunetin në çështjet themelore, me këtë emër përçarës. Kjo pafajësi nuk vlen për

ata që braktisën rrugën e drejtë dhe u bashkuan me kundërshtarët në çështjet parimore si mutezilet, shiitët, murxhitë dhe sektet e tjera të ndryshme, që u binden pasioneve (epsheve) të tyre. Me këtë kriter Ehli Suneti vlerëson dhe gjykon, se kush është përçarës dhe kush bën pjesë në grupet e devijuara, që meritojnë dënimin në xhehenem.

(Muhamed Salih El Munexhid)

Pyetje: Dua të pyes për besueshmërinë e librit Nehxhul Belaga (Shtegu i elokuencës) dhe për mendimin tuaj rreth librit në fjalë?

Përgjigja: I falënderuar është Allahu. Ky libër i atribuohet prijësit të besimtarëve Aliut, Allahu qoftë i kënaqur me të, dhe në të ka shumë çështje rreth të cilave ndeshen mendimet e atyre që pohojnë se janë ithtarë të Islamit përfshirë këtu Ehli Sunetin dhe shi'itët. Në përgjigjen tonë do t'u përmbahemi rregullave fetare, që nënkuptojnë, së pari, të sigurohemi: a është i saktë pohimi, se është libër që përmban fjalimet, letrat, thëniet e imam Aliut, si dhe vlerësimin, që për librin në fjalë kanë dhënë dijetarët e specializuar në lëmitë e transmetimit, sepse ajo që transmetohet nga sahabët i nënshtrohet rregullave të transmetimit (rivajetit). Duke iu referuar vlerësimeve të dijetarëve, si dhe duke bërë krahasimin mes fjalëve të imam Aliut, Allahu qoftë i kënaqur me të, që kanë ardhur deri te ne me sened të saktë dhe thëniet që i vishen në libër dhe ne do të shohim një dallim të madh dhe kundërtënie.

Imam Dhehebiu, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: Murteda Ali ibën Husein ibën Musa El Musevi (vdiq në vitin 436 h.) është përpiluesi i librit "Nehxhul Belaga", i cili përmban fjalime, letra dhe thënie që i

atribuohen imam Aliut. Libri në fjalë nuk ka sened, ka transmetime pabazë dhe disa të sakta. Në këtë libër ka fjalë të trilluara, të cilat nuk ka mundësi t'i ketë thënë imam Aliu... Vëllai i autorit Er Radi ka përpiluar një libër në të cilin ka grumbulluar fyerjet, që u bëhen shokëve të zgjedhur të Muhamedit, bekimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të. Allahu na ruajt nga dija e padobishme. (Es Sijer, 17/589)

Për gënjeshttrat në këtë libër ka folur edhe Hatib Bagdadiu (2/161) Ibën Halikani, Safediu dhe të tjerë. Vërejtjet ndaj librit në fjalë do t'i përmbledhim në tekstin vijues:

Mes autorit dhe imam Aliut ka gjashtë breza transmetuesish, që nuk përmenden në këtë libër dhe nuk ka sened. Fjalja pa sened nuk pranohet, ndërsa ajo që ka sened duhet të analizohet dhe të vlerësohet, si e pranuar apo e papranuar. Elementi dytë i rëndësishëm është, se shumica e hutbeve që përmenden në këtë libër nuk janë të njohura para shkrimit të librit, gjë kjo e cila aludon se bëhet fjalë për shpikje. Elementi i tretë: vetë autori i librit është njeri për drejtësinë dhe besimin e të cilit kanë folur imamët. Pjesët e librit plotë fyerje ndaj sahabëve mjafton për refuzimin e tij. Shumë fjalë të shkruara nuk i kanë hije njeriut të thjeshtë e akoma më pak imamit dhe kalifit të drejtë Ali ibën Ebi Talibit. Gabimet gjuhësore plotë prozaizma (Fjalë e shprehje të rëndomta nga gjuha e përditshme që futen vend e pa vend në një vepër poetike) nuk mundën të janë fjalë të një oratori siç ka qenë imam Aliu...

Nga ajo që u tha mundemi të përfundojmë, se nuk është përkufizim i saktë, që libri ka përmbledhur fjalimet, letrat dhe thëniet e imam Aliut. ■

(Muhamed Salih El Munexhid)



NGA SEID NURSI TE FETULLAH GYLENI

SHKRUAN: JUSTINIAN TOPULLI

Kush ishte Seid Nursi dhe çfarë përfaqëson ai

Seid Nursi (1876 -1960) lindi nga dy prindër kurd. Falë zgjuarsisë së tij të rrallë dhe kujtesës së fortë ai arriti të mësojë në një kohë të shkurtër një sërë dijesh islame, duke filluar që nga Kurani, hadithi, fikhu, gjuha arabe, matematika, kimia, astronomia, filozofia etj. Kjo enciklopedi dijesh që ai mori bëri që njerëzit ta mbiquajnë atë “Bediu Zeman” (mrekullia e kohës).

Që në rininë e tij Nursi filloi të merrej me politikë dhe kjo duket qartë nga kritikrat që ai bën qeverisë për neglizhencë në drejtim të çështjeve fetare, gjë që shkaktoi edhe izolimin e tij nga pushtetarët lokalë në 1892. Në 1896 i propozon sultan Abdulhamitit që të hapi në Anadoll një universitet islamik, por nuk ia arriti qëllimit. Të njëjtën përpjekje e rimori më pas në 1907 në Stamboll, por edhe kësaj here nuk ia doli dot.

Nursi ishte kundra diskursit panislamik të sultan Abdulhamidit. Kjo bëri që Nursi të burgosej përsëri dhe të lirohet vetëm në 1908,

atë vit kur triumfoi lëvizja moderniste e xhonturqve. Ai përkrahu rivendosjen e kushtetutës së 1876, por nuk u bë pjesë e xhonturqve, që përfaqësohej nga organizata “Bashkim dhe Përparim”. Në këtë kohë ai fillon një aktivitet të zellshëm shkrimi në gazetën e kohës, ku i bën jehonë idesë së tij, se përparimi mund të vijë vetëm nëpërmjet sintezës në mes shkencës dhe zbatimit të fesë. Megjithëse ai mbështeti kushtetutën, Nursi nuk e pranonte faktin se një kushtetutë mund të ishte zëvendësuese e ligjeve të sheriatit. Për këtë arsye ai u bënte thirrje ndjekësve të tij të qëndronin larg xhonturqve dhe idesë së tyre, pasi kjo gjë ishte kufër. Në 1909 Nursi u përfshi në lëvizjen anti-xhonturke, por me dështimin e saj Nursit iu desh të përballëj përsëri me burgun. Në 1911-1912 Nursi përfshihet në një organizatë të fshehtë politike, e cila synonte të mbronte territoret e Perandorisë Osmane nga copëtimi, që po i shkaktonte lufta ballkanike. Në Luftën e Parë Botërore Nursi merr pjesë në frontin e Kaukazit, atje ai plagoset dhe bie rob lufte dhe internohet në Siberi. Ai arrin të arratiset prej andej dhe në 1916 mbërrin në Stamboll, ku

pritet si hero nga sulltani, Shejhul Islami dhe nxënësit e shkollave fetare. Në 1920 ai ftohet në Ankara, ku ishte përqendruar fronti dhe qeveria e Mustafa Qemalit, që kërkonte çlirimin e vendit nga ndërhyrja angleze. Nursi u zhgënjye nga kemalistët, sepse pa se ata nuk faleshin dhe nuk u interesonte aspak feja. Më pas ai vetizohet për afro dy vjet 1923-1925 në një shpellë pranë qytetit Van. Pas kësaj jeta e tij merr një kthesë tjetër, ku ai vendos të mos përzihet më me politikë, por i vë si qëllim vetes të ringjalli tek njerëzit të vërtetat e besimit, nëpërmjet dritës së Kuranit.

Duhet thënë se gjatë kësaj periudhe sundimi kemalist mori një sërë masash kundra fesë, në 1922 ai abrogoi sulltanatin dhe e ndau atë nga institucioni i kalifatit. Në mars të 1924 abrogohet edhe kalifati dhe mbyllet edhe ministria e vakëfeve dhe në vend të saj krijohet një administratë për mbarëvajtjen e xhamive dhe çështjeve fetare. Kjo dhe masa të tjera represive shkaktuan pakënaqësi të madhe në mes njerëzve deri në revolta të armatosura, si ajo e udhëhequr nga Seid Balu.

Në 1925 Nursi refuzoi të bashkohej me kryengritjen e shehut kurd, Seid Balu Nakshibendi. Megjithatë ai u akuzua për pjesëmarrje në të dhe u internua në një fshat në jug-perëndim të Turqisë, ku kaloi tetë vjet. Këtu ai filloi të shkruante "Resail Nur" (Mesazhet e Dritës). Këto shkrime janë trajtesa me karakter fetar, ku bëhen shpjegime të thjeshta rreth ajeteve të ndryshme të Kuranit dhe ku trajtohen çështje të përgjithshme të besimit. Këto trajtesa ai vazhdoi t'i shkruante deri në vitin 1950. Numri i këtyre trajtesave është 130 dhe janë botuar për herë të parë në 1954 në një libër të vetëm me disa volume.

Gjatë periudhës në vazhdim shteti do merrte masa të tjera shtrënguese, që synonin jo vetëm laicizimin e jetës së vendit, por

“...Përparimi mund të vijë vetëm nëpërmjet sintezës në mes shkencës dhe zbatimit të fesë...”

kombëtarizimin e fesë. Kështu në 1928 Turqia në kushtetutën e saj shpallet si republikë laike reformatore dhe po këtë vit bëhet edhe ndryshimi i shkrimit nga shkronjat arabe në shkronjat latine. Në 1932 ndryshohet namazi dhe ezani nga gjuha arabe me të cilat kryhen këto rite fetare, në gjuhën turke. Qemalistët shtuan represionin me anë të ligjeve dhe masave të reja ndaj aktiviteteve fetare. Kjo gjendje vazhdoi deri në mbarim të Luftës së Dytë Botërore.

Një nga format e rezistencës, ndaj kësaj lufte që i bëhej fesë ishin edhe Risalet e Nursit. Kjo gjë e detyroi shtetin përsëri në 1934 ta vinte atë bashkë me 120 prej nxënësve të tij në bankën e të akuzuarve, si njeri që kërkon të përmbys shtetin laik dhe ta kthej vendin mbrapa, nëpërmjet një rrjeti të fshehtë konspirativ. Por Nursi diti ta mbrojë mjaft mirë veten nga akuzat që i bëheshin. Megjithatë ai u dënua me njëmbëdhjetë muaj burg dhe më pas u internua në një qytet në brigjet e Detit të Zi.

Nursi vazhdoi përsëri aktivitetin e tij dhe në 1943 ai përsëri arrestohet dhe akuzohet, se ka ngritur një organizatë të fshehtë, që kërkon të ngrejë opinionin e popullit kundra qeverisë dhe Mustafa Qemalit, duke e përshkuar atë si dexhall. Gjyqi kësaj herë ngarkoi një grup hetimor që përbëhej nga akademikë dhe juristë, të cilët morën në studim një pjesë të Risaleve të tij. Grupi në fjalë erdhi në përfundimin, se shkrimet e tij ishin tërësisht trajtesa fetare, që nuk kishin lidhje fare me politikën, kështu që në qershor të 1944 ai lirohet. Gjithsesi mbrojtja që ai i bëri vetes edhe kësaj herë bëri jehonë të

madhe tek nxënësit e tij, të cilët thuhet se kishin arritur milionin. Pavarësisht kësaj ai u internua në perëndim të Anadollit. Aktiviteti i nxënësve të tij mori përmasa të mëdha, aq sa qeveria u ndje ngushtë dhe u detyrua të arrestonte dhe të burgoste shumë prej ndjekësve të tij. Madje edhe vetë Nursi u dërgua përsëri para gjykatës me të njëjtat akuza të mëparshme. Nursi do të lirohet në 1950, vit kur u zhvilluan për herë të parë zgjedhjet e lira demokratike në vend dhe fitoi Partia Demokratike e Adnan Menderesit, opozitë e partisë në pushtet. Vitet 1950-60 vitet kur edhe sundoi PD-ja, ishin vitet e një lirie të madhe fetare. Duhet thënë se në këto vite u lejua aktiviteti i shoqatave dhe botimeve fetare, u rihapën teqetë dhe u rikthye edhe një herë ezani në gjuhën arabe. Reformat demokratike që u bënë në ato vite në drejtim të lirisë fetare, i siguroi PD-së votat për disa mandate, mes tyre edhe e votat e nursinjëve, të cilët forcuan jo pak marrëdhëniet me Adnan Menderesin, kryeministrin e asaj kohe. Por që në vitet e para qeveria demokratike u përball me një opozitë të ashpër nga ish-partia në pushtet e Mustafa Qemalit, ajo u akuzua se po u jepte liri të madhe grupimeve dhe sekteve fetare dhe se po rrëronte parimet kemaliste të shtetit laik. Kjo gjë e detyroi qeverinë që gjithsesi të merrte disa masa nga të cilat nuk shpëtoi as vetë Nursi. Ai do të izolohej nga njerëzit në vitet në. Në mars të vitit 1960 ai ndërron jetë në një moshë të thyer tetëdhjetë e shtatë vjeçare.

Disa nga karakteristikat e lëvizjes së Nursit

Lëvizja e Nursit, sipas nursijve synonte rigjallërimin dhe forcimin e besimit te njerëzit. Nursi mendonte se nëpërmjet Risaleve të tij, ku kryesisht trajtonte besimin në ekzistencën e Zotit dhe me një gjuhë që i përshtatej kohës do të shuante pikëpyetjet dhe akuzat që ngriheshin ndaj fesë. Ai i jepte rëndësi edhe besimit në botën tjetër për t'u

“Në 1932 ndryshohet namazi dhe ezani nga gjuha arabe me të cilat kryhen këto rite fetare, në gjuhën turke...”

dhënë pas punëve të mira dhe moralit të lartë. Nursi besonte se ndryshimi vjen vetëm nëpërmjet edukimit të shoqërisë hap pas hapi dhe se nuk ka vend për xhihad të armatosur brenda një shoqërie muslimane. Ajo çka duhet bërë është ndriçimi i mendjes njerëzore dhe pastrimi i shpirtit e i zemrave nëpërmjet edukimit.

Lëvizja e Nursit i ngjan në shumë aspekte lëvizjeve të xhemateve islamike në botën islame, vetëm se ajo i kushton rëndësi besimit tek ekzistenca e Zotit, tek rigjallërimi i besimit dhe nuk merret me anë të tjera të Islamit. Përzierja e nursijve me politikën është thjesht një përzierje pragmatiste, jo për të siguruar drejtpërdrejtë pushtetin, por për të krijuar sa më shumë hapësira për aktivitetin e tyre edukues ndaj shoqërisë. Islami i nursinjëve nuk ndryshon shumë nga islami karakteristik i Anadollit, i cili është një islam me rrënjë sufiste dhe doktrinë maturidije. Nursinjtë nuk janë një tarikat sufist, por elementë të tarikateve sufiste duken qartë në aktivitetin e tyre, siç është bindja dhe nderimi i tepruar ndaj mësuesve të tyre, si dhe fanatizmi ndaj ideve dhe shkrimeve të Seid Nursit.

Lëvizja e Nursit ka pasur në një farë mase vlera pozitive në drejtim të ruajtjes së besimit në Turqi, por gjithsesi ajo nuk ka paraqitur një vizion të qartë dhe të plotë gjithëpërfshirës të Islamit. Për këtë arsye dhe të tjera, sot mes nursinjve ka disa grupime, të cilat interpretojnë mësimet e Nursit në mënyra të ndryshme.

Grupimi më i fuqishëm me sa duket, është grupimi i Fetullah Gylenit.

Fetullah Gyleni dhe lëvizja e tij

Fetullah Gyleni u lind në Erzurum më 1938 (diku thuhet 1941), nga një familje me ndjenja të forta fetare. Mësimet e para i mori nga i ati, prej tij mësoi arabishten dhe persishten. Më pas arsimin fetar e vazhdoi në “medresetë e fshehta”, në atë kohë të shtetit kemalist. Po ashtu në këtë kohë vizitonte shpesh edhe teqetë e tarikateve sufiste, nga ku mori edhe edukim shpirtëror sipas modelit që ata paraqisnin. Këtu ai krijoi një simpati të madhe për figura të tilla sufijnsh, si Meulana Rumi, Junus Emre e të tjerë. Në 1957 ai bëhet pjesë e xhematit nursij dhe bëhet një anëtarë aktiv në të, duke mësuar edhe Islamit sipas metodës së tyre. Pavarësisht ideve të ndryshme Gyleni i respektonte udhëheqësit e xhematit, derisa ai u shkëput nga vija tradicionale e nursijve. Gyleni përfitoi nga nursijtë sistemin e abilerëve (vëllezërve të mëdhenj), të cilët interpretonin mësimet e Seid Nursit, dhe mbanin nën kontroll rrjetin dhe diskursin e nursijve, sistem të cilin ai do ta aplikonte më pas edhe në rrjetin e lëvizjes së tij. Gyleni nuk kufizohet në aktivitetin e brendshëm të xhematit, por i jep një rëndësi të madhe komunikimit me publikun, nëpërmjet mësimave dhe hutbeve. Ai ishte një ligjërues shëtitës, që shkonte ngado duke predikuar besimin. Në gjysmën e dytë të viteve 1960 Gyleni mbikëqyrte zhvillimin e kampingjeve fetare, që zhvilloheshin në stinën e verës.

Në 1970, Gyleni pasi kishte krijuar një reputacion jo të vogël në radhët e njerëzve dhe të vetë nurxhinjve, krijon xhemin e tij dhe praktikon një metodë të ndryshme nga ajo e xhematit mëmë, siç që predikimi në masa më të mëdha njerëzish, përhapja, publikimi dhe shitja anembanë vendit e materialeve të tij predikuese të regjistruara nëpër kaseta dhe të shkruara në letra. Ai krijoi brenda bashkësisë së tij, rrjetin e “shtëpive të dritës”, që ishte modifikim i

“... Islami i nursinjëve nuk ndryshon shumë nga islami karakteristik i Anadollit, i cili është një islam me rrënjë sufiste dhe doktrinë maturidije...”

ders’haneve që përdornin edhe nurxhinjtë. Në këto shtëpi lexoheshin dhe studioheshin Risalet e Seid Nursit dhe krahas tyre edhe veprat e Gylenit. Në 1978 ata hapën qendrën e parë studimore, ku do të përgatiteshin studentët, që do të hynin në provimet e pranimeve universitare. Në 1979 lëvizja filloi të botonte gazetën Sizinti, ku promovojë një sintezë në mes dijeve shkencore dhe Islamit. Mesazhi i Gylenit tashmë përhapej nëpërmjet një aktiviteti publik ligjërimesh, regjistrimeve audio, literaturës private e publike si dhe tek kampet verore. Ndërkohë që xhematet e tjera financonin dhe mbanin shkollat private për imam-hatib si dhe kurse të mësimt të Kuranit, Gyleni mbështeste dhe nxiste pasuesit e tij të krijonin shkollat laike elitare të standardeve të larta. Moto e Gylenit ishte dhe ka mbetur, ndërtoni shkollat në vend që të ndërtoni xhami. Ai nuk synon të edukojë klerikë dhe besimtarë me njohuri të thella fetare, por një brez të gjerë njerëzish në mesin e të cilëve do të ketë, simpatizantë, mbështetës apo ndjekës të ideve të tij dhe mundësisht të krijojë në brezat e ardhshëm sa më pak kundërshtarë. Edukimi i tyre me moral fetar nuk bëhet nëpër shkollat, të cilat kanë tërësisht një program laik, por nëpër konvikte apo nëpër shtëpi, qoftë kjo nëpërmjet mësimt dhe literaturës apo edhe vetëm nëpërmjet shembullit të një morali të mirë që japin mësuesit dhe abilerët. Rrjeti i shkollave të Gylenit ngrihet me mbështetjen financiare të mbështetësve të tij në radhën e

tregtarëve të mesëm dhe të mëdhenj, por kjo mbështetje shpesh nuk është pa përfitime materiale, pasi shkollat janë me pagesë dhe kështu që në disa vende ato mund të kthehen edhe në biznese me ortakëri lokale. Rrjeti i shkollave të Gylenit ka marrë përhapje të madhe mbas viteve 90, ai numëron me qindra shkolla si brenda ashtu edhe jashtë Turqisë. Një përhapje të madhe ka kryesisht në ish-republikat sovjetike të Kaukazit dhe në Ballkan. Gjithsesi rrjeti i tij i shkollave ka përfshirë edhe vendet perëndimore të Evropës, të Afrikës dhe Amerikës. Në vendet jo-perëndimore këto shkolla mbështeten edhe nga shteti turk dhe janë edhe pjesë e politikës së tij të jashtme.

Lëvizja e Gylenit karshi politikës mban një qëndrim pragmatist, ajo mbështet gjithmonë atë forcë që i siguron asaj më shumë hapësira për veprimtaritë e saj, sidomos asaj arsimore. Gyleni akuzohet shpesh nga aktorë të majtë, ekstremistë të djathtë dhe nga ushtria si garantuesja e laicizmit në vend, se ka ngritur një rrjet konspirativ njerëzish dhe që kërkon të rikthejë edhe njëherë në pushtet ligjin islam të shariatit dhe të rrënojë. Gyleni këtë e mohon publikisht, ai promovon demokracinë liberale e perëndimore, dhe është për një shekullarizim sipas modelit amerikan dhe evropian por kundra laicizmit sipas modelit francez dhe atij kemalist, që është shumë herë më ekstremist sesa ai francez.

Në vitin 1998 Fetullah Gyleni largohet nga Turqia për në SHBA. Është interesante të përmendet fakti se autoritetet e SHBA refuzuan një kërkesë të Gylenit për t'i dhënë të drejtën e banimit të përhershëm në Shtetet e Bashkuara, për shkak se ai nuk kishte një famë të mjaftueshme, por gjykata federale në korrik 2008 vendosi se ky vendim ishte i gabuar dhe se ai ishte një njeri me një kontribut të veçantë në fushën e arsimit.

Në verën e vitit 2008 Gyleni doli në krye të klasifikimit të një sondazhi për intelektualët

më me influencë në botë, e organizuar nga revista britanike *Prospect* dhe ajo amerikane *Foreign Policy*. Sipas editorit online të revistës *Prospect* fitorja e tij ishte e papritur dhe ndodhi në një kohë shumë të shkurtër. Gyleni arriti të merrte mbi gjysmë milion vota online. Siç shpjegon ky njeri shkaku ka qenë thirrja që Gazeta Zaman, gazeta më e shitur në Turqi u bëri thirrje ndjekësve të Gylenit të votonin për të në internet. Dihet që kjo gazetë bën pjesë në sferën e rrjetit mediatik të lëvizjes së Gylenit. Përveç kësaj editori në fjalë thotë se ka pasur edhe ndërhyrje abuzive në sistemin informatik të anketimit, gjë që është bërë qëllimisht për të favorizuar Gylenin. Pavarësisht këtij fakti, editori në fjalë thotë se kjo fitore është fryt i organizimit të fuqishëm dhe rrjetit të bindur që Gyleni udhëheq dhe kjo duhet të na bëjë ne për të parë te një shtresë e re intelektualësh, të cilët ndikimin e tyre e ushtrojnë nëpërmjet rrjeteve të tyre të organizimit. Taktika të tilla janë të shpeshta nga xhemati i tij. Ata i japin rëndësi shumë aparencës, edhe nëse kjo aparencë është fiktive, siç është për shembull edhe fakti se gazeta Zaman është më e shitura në Turqi. Shitja e madhe e kësaj gazete nuk vjen për shkak të lexuesve të shumtë, por për shkak se ajo blihet nga simpatizantët dhe ndjekësit e Gylenit me shumicë.

Pas viteve 1990 Fetullah Gyleni është bërë promovues i dialogut ndërfaqetor, nëpërmjet konferencave, seminareve dhe takimeve me liderëve të feve të ndryshme. Kështu në frymën e këtij trendi, ai është takuar me papa

“...Lëvizja e tij me plot gojë mund të thuhet se zotëron një perandori të tërë rrjetesh, njerëzish, aktiviteteve, bizneseve dhe institucioneve...”

Gjon Palin II, me patriarkun ortodoks të Stambollit, me kreun e rabinëve të komunitet hebre në Turqi etj.

Por lëvizja e Gylenit pavarësisht se shtrirjen më të madhe dhe përqendrimin e ka në fushën e arsimit, ajo zotëron edhe një rrjet mediesh, duke filluar që nga gazeta, revista, e deri tek televizione lokale dhe kombëtare. Veç kësaj lëvizja e Gylenit ka ngritur edhe institucione financiare dhe bankare, institucione të shoqërisë civile, institucione bamirëse, spitale etj. Lëvizja e tij me plot gojën mund të thuhet se zotëron një perandori të tërë rrjetesh, njerëzish, aktiviteteve, biznesesh dhe institucioneve. Përmasat financiare, njerëzore dhe institucionale që udhëhiqen nga lëvizja e Gylenit, nuk dihen saktësisht. Ndërkohë diskursi i rrjetit dhe fryma e tij organizative mbahet nën kontroll nga një hierarki e centralizuar, hermetike, në krye të së cilës qëndron hoxha Fetullah Gylen. Sipas një studiuesi, organizimi i tyre është i përbërë nga tre nivele: niveli i parë, që janë simpatizantët dhe që përbëhet nga një numër i madh dhe që kryesisht janë studentë dhe njerëz që marrin pjesë në takimet e tyre javore. Niveli i dytë janë anëtarët, të cilët janë mbështetësit financiar dhe të tjerë. Niveli i tretë më i afërt dhe më i vogël përbëhet nga punëtorët apo nga ata që janë vënë në shërbim (hyzmet për hir të Zotit) dhe që janë mësuesit e shkollave, lobistë, gazetarë etj. E gjithë struktura kontrollohet nga abilerë të niveleve të ndryshme, të cilët janë kryesisht turq nga Anadulli dhe që kanë kohë që kanë hyrë në shërbim dhe janë besnik ndaj lëvizjes së Gylenit.

Përfundimi

Lëvizja e Gylenit është një lëvizje në thelb me karakter islam. Ajo është një degë e moderuar e lëvizjes së Seid Nursit, mësimet e të cilit përbëjnë thelbin e aktivitetit të tyre. Ajo ka kontribuar në islamizimin e laicizmit

“...Islami që ata përhapin është sipërfaqësor dhe kryesisht e vë theksin tek morali konservator dhe tek edukimi shkencor...”

brenda Turqisë dhe në turqizimin e Islamit në vendet e tjera. Islami që ata përhapin është sipërfaqësor dhe kryesisht e vë theksin tek morali konservator dhe tek edukimi shkencor. Mjetet dhe format që kjo lëvizje përdor i janë nënshtruar një realiteti represiv antifetar, çka ka bërë që ata të jenë të fshehtë në shumë prej aktiviteteve të tyre. Ky dualizëm në sjellje i ka bërë ata që shpeshherë qëllimi për ta të justifikoj mjetin dhe pse jo të bëjnë edhe koncesione në drejtim të fesë për të arritur synimet e tyre. Mjafton si fakt të përmendim, se Gyleni thotë që nëse një myslimane vihet në mes të zgjedhjes së hixhabit apo shkollës, ajo le të zgjedhë shkollën. Në ligjërimin e tyre fetar ndjekësit e Gylenit janë konservatorë ndaj parimeve islame, por në praktikë ata janë shumë më tolerantë dhe fleksibël në situata dhe vende të ndryshme. Përgjithësisht ata janë njerëz të qetë dhe me edukatë, dhe nuk hynë në debate me të tjerët, por janë përjashtues dhe mbartin një frymë sektare, ndaj muslimanëve të tjerë që i përkasin shkollave dhe lëvizjeve të tjera. Kanë bindje gati të verbër ndaj të parit dhe i nënshtrohen urdhrave të tij pa kundërshtuar. Ndikimi i lëvizjes së tyre vjen duke u rritur dhe koha do të shpalojë shumë paqartësi dhe pikëpyetje që ngrihen rreth tyre. A do të dinë ata ta ruajnë me kalimin e kohës qëllimin për të cilin punojnë apo ai do të humbasë mbas, në rrugëtimin e tyre të gjatë dualist? Kjo vlen për t'u parë... ■